

Shprehi në praktikën e punës me viktimat e trafikimit

Manual informimi për ofruesit e shërbimeve psiko-sociale

Pikëpamjet e autorit të shprehura në këtë botim nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar ose të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara.

Shprehi në Praktikën e Punës me Viktimat e Trafikimit:
Manual informimi për ofruesit e shërbimeve psiko-sociale.

Ky botim është bërë për shqyrtim nga Agjensia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar. Ai u përgatit nga Instituti Shqiptar i Studimeve Sociale dhe Psikologjike (I3SP) në kuadër të programit KVKTNJ.

Përgatitur nga:
Instituti i Shqiptar i Studimeve Sociale dhe Psikologjike (I3SP)

Nën drejtimin e:
Prof.Dr. Ylli Pango

Suela Kusi
Drejtore Projekti

Cover & Layout:
Igli Koçiu

Shtypur në shtypshkronjën ILAR
Rr. "Muhamet Gjollesha," Nr.17

Tirazhi 1000 kopje
Gusht 2005

F A L E N D E R I M E

Manuali ***"Shprehi në Praktikën e Punës me Viktimat e Trafikimit***" është hartuar që të përdoret si një material trajnimi dhe burim informacioni për të gjithë ofruesit e shërbimeve psiko-sociale në punën me viktimat e trafikimit të qënieve njerëzore.

Ky manual është botuar nga Instituti Shqiptar i Studimeve Sociale dhe Psikologjike (I3SP) në kuadër të programit të financuar nga USAID **"Nisma Shqiptare: Koordinimi i Veprimeve Kundër Trafikimit Njerëzor".** Ky program ka për qëllim të zhvillojë dhe fuqizojë kapacitetet e shoqërisë civile për t'u ofruar shërbime viktimave të trafikimit, si dhe të përkrahë koordinimin e përpjekjeve të pushtetit vendor dhe shoqërisë civile në luftën kundër trafikimit.

Falenderime të veçanta për grupin e ekspertëve të Fakultetit të Shkencave Sociale dhe të I3SP-së drejtuar nga Prof.Dr.Ylli Pango. Ky manual nuk do të ishte botuar pa ekspertizën, energjinë, përkushtimin dhe mendimin e tyre kritik; Prof.Ass.Dr Aleksandër Kocani, Dr.Eglantina Gjermeni, Dr. Majlinda Bregu, Ma. Jorida Rustemi, Znj. Kledia Mazniku, Znj. Nada Kallçiu, Znj. Kozeta Noti si dhe Znj.Gresa Gostivari.

Falenderime Zyrës së USAID në Tiranë që mundësoi dhe mbështeti financiarisht projektin. Znj. Arian Giantris për konsultimin dhe ndjekjen hap pas hapi të projektit.

Falenderime personelit të zyrës së KVKTNJ në Tiranë dhe në veçanti Znj.Sarah Stephens, ajo ka luajtur një rol kyç me eksperiencën e saj të çmuar profesionale, orientimin e vazhdueshëm, angazhimin dhe mbështetjen e saj të pakursyer gjatë gjithë kohës. Ajo ishte aty kurdo që ne kishim nevojë.

Falenderime për të gjithë përfaqësuesit e organizatave partnere, të cilët ndanë me ne përvojat dhe mendimet e tyre. Kontributi i tyre është vështirë të përshkruhet me fjalë. Znj. Diana Hiscock, përfaqësuese e zyrës së ICMC në Tiranë, Znj. Galit Wolfensohn dhe Znj. Alketa Zazo, Zyra e UNICEF, Znj. Ledia Beci nga Zyra e OSBE në Tiranë, Znj.Valbona Lenja dhe Silvana Haxhiaj, nga Zyra e IOM në Tiranë, Znj.Snezhi Bedalli përfaqësuese e zyrës së ILO-IPEC, Znj. Holta Kotherja drejtore e Klinikës Ligjore për të Miturit si dhe Znj.Vera Leskaj drejtore e Qendrës Psiko-Sociale Vatra.

Së fundmi një falenderim të veçantë për Znj. Suela Kusi, për përgatitjen e këtij manuali për botim.

PERMBAJTJA

1 PËRKUFIZIME MBI TRAFIKIMIN E QËNIEVE NJERËZORE 10

1.1 Protokolli për Parandalim të Trafikimit Ndrydhes dhe Ndeshkues tek Personat veçanërisht për Gratë dhe Fëmijët

1.1.1 Trafikimi i fëmijëve

1.1.2 Trafikant

1.1.3 Person i trafikuar

1.1.4 Viktimë e Trafikimit

1.1.5 Shfrytëzim

1.1.6 Mashtrim

1.1.7 Skllavëri

1.1.8 Skllavëri borxhesh

1.1.9 Punë e forcuar apo e detyruar ose kushte të ngjashme me skllavërinë

1.2 Trafikimi dhe Prostitucioni, Prostitucioni "i Lirë" dhe i "Forcuar"

1.3 Pse trafikohet?

1.4 Faktoret që lehtësojnë trafikimin

1.4.1 Varfëria

1.4.2 Migrimi

1.4.3 Pabarazia gjinore

1.5 Fazat e proçesit të trafikimit
Rekrutimi
Tranzit/Udhëtimi.
Mbërritja në vendin e destinacionit

1.6 Profilet e Trafikantëve

2 TRAFIKIMI DHE TË DREJTAT E NJERIUT 19

2.1 Parimet dhe Udhëzimeve të Rekomanduara mbi të Drejtat e Njeriut dhe Trafikimin Qënieve Njerëzore

2.2 Udhëzime mbi mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve viktima të trafikimit në Evropën Juglindore

3 KUADRI LIGJOR NË LIDHJE ME TRAFIKIMIN 21

3.1 Çështje ligjore dhe praktike lidhur me trafikimin e grave, të vajzave dhe fëmijëve

3.1.1 Trafikimi si një formë e krimit të organizuar
3.1.2 Qëndrimi i Bashkimit Europian
3.1.3 Ndalimi me ligj i trafikimit të qënieve njerëzore si një e drejtë themelore: Karta Europiane e të Drejtave të Njeriut
3.1.4 Masa kundër formave të rënda të trafikimit: këshilli i vendimmarrjes së punës për luftën kundër trafikimit të qënieve njerëzore
3.1.5 Konventa Europiane Kundër Trafikimit të Qënieve Njerëzore
3.1.6 Europoli
3.2 Kuadri Ligjor Shqiptar
3.3 Strategjitë Kombëtare në Luftën Kundër Trafikimit të Qënieve Njerëzore.
3.3.1 Strategjia Kombëtare për Luftën Kundër Trafikut të Qënieve Njerëzore, 2001-2004.
3.3.2 Strategjia Kombetare Kundër Trafikimit të Fëmijëve dhe Mbrojtjes së Fëmijëve Viktima të Trafikut

4 ROLI I PROFESIONISTËVE TË SHËRBIMEVE PSIKO-SOCIALE DHE ÇËSHTJE ETIKE NË PUNËN ME GRATË/VAJZAT DHE FËMIJËT VIKTIMA TË TRAFIKIMIT 31
4.1 Roli i profesionistëve të shërbimeve psiko-sociale
4.2 Etika e profesionistëve të shërbimeve psiko-sociale në punën me gratë, vajzat dhe fëmijët viktima të trafikimit
4.2.1 E drejta e klientit për informim
4.2.2 Çështje të konfidencialitetit në këshillim

5 E KALUARA E VIKTIMAVE DHE FAKTORËT PËRCAKTUES 37
5.1 Prejardhja familjare
5.2 Mungesat Social Ekonomike

6 PARANDALIMI I TRAFIKIMIT TË QËNIEVE NJERËZORE 39
6.1 Çdo të thotë "Parandalim"
6.2 Roli i Ndërgjegjsimit në Strategjitë e Parandalimit
6.2.1 Fushatat e informimit publik
6.2.2 Si mund të jepen mesazhe për trafikimin
6.3 Metodat Pjesmarrëse
6.3.1 Edukimi me aftësitë për jetën

6.3.2 Strategjitë e të mësuarit të ndërsjelltë
6.3.3 Masat me bazë komuniteti
6.3.4 Bashkëpunimi në shumë sektorë

7 INTERVISTAT ME GRATË/VAJZAT DHE FËMIJËT VIKTIMA TË TRAFIKIMIT 46

7.1 Grumbullimi i të dhënave për qëllime ligjore (edhe për viktimat e trafikimit)
7.1.1 Qëllimi i intervistave për mbrojtjen e klientit mund të përfshijë:
7.1.2 Grumbullimi i të dhënave për klientët viktima të trafikimit
7.1.3 Më shumë të dhëna për të ndihmuar klientin - Përgatitjet për referim
7.1.4 Përgatitjet për gjykatë
7.2 Përgatitjet për intervistimin e klientëve viktima dhe/ose dëshmimtarë.
7.2.1 Udhëzime të përgjithëshme
7.2.2 Çështjet me ndikim në intervistat me fëmijë, viktima të trafikimit.
7.2.3 Aftësia e të sugjeruarit.
7.2.4 Mashtrimi
7.3 Si ta bëjmë intervistën një përvojë pozitive
7.3.1 Zgjedhja e vendit dhe ambientit të duhur të intervistës.
7.4 Udhëzime për përdorimin e përkthyesve
7.5 Çështje që duhen mbajtur mend
7.6 Faza e parë e intervistës
7.6.1 Prezantimi
7.6.2 Vendosja e raporteve të duhura të besimit
7.6.3 Çështje të mirëbesimit
7.6.4 Krijimi i marrëdhënieve
7.7 Faza e dytë e intervistës
7.7.1 Pyetjet e hapura
7.7.2 Pyetjet e mbyllura
7.7.3 Strukturimi i pyetjeve
7.8 Faza përfundimtare e intervistës
7.9 Intervistë për viktimat e trafikut

8 DËGJIMI AKTIV: KARAKTERISTIKAT E NJË KOMUNIKIMI EFIKAS 62

8.1 Elementët që bëjnë një komunikim efikas:

8.2 Pengesat gjatë komunikimit me klientët
8.2.1 Jini të kujdesshëm për reagimet emocionale kur klientët nuk dëshirojnë të flasin.
8.2.2 Probleme të veçanta të komunikimit
8.2.3 Çështjet që e bëjnë dëgjimin më pak efikas.
8.3 Shkathtësitë dhe cilësitë e një intervistuesi
8.3.1 Dëgjimi dhe komunikimi i mirë
8.3.2 Të kuptuarit e shkalles së zhvillimit të klientit.
8.3.3 Të kuptuarit e natyrës dhe pasojave të trafikimit dhe keqtrajtimit
8.3.4 Sinqeriteti ndaj përvojës së klientit
8.3.5 Krijimi i marëdhënieve
8.3.6 Lehtësimi i komunikimit
8.4 Shkathtësitë e të regjistruarit dhe përmbledhjes së intervistës
8.4.1 Shkathtësitë e komunikimit joverbal

9 KËSHILLIMI PSIKOSOCIAL **70**
9.1 Vështrimi empirik i efekteve të trafikimit dhe vlerësimi psikologjik i rrethanave të tij
9.1.1 Natyra kundërshtuese dhe e pakontrollueshme e trafikimit.
9.2 Problemet shëndetësore
9.3 Pasojat dhe simptomat klinike psikologjike të shkaktuara nga trafikimi
9.3.1 Gjëndja psikologjike e gruas së asistuar
9.3.2 Çrregullimi i stresit pas traumës
9.3.3 Disocimi
9.3.4 Disocimi dhe veprimet e dëmtimit të vetes
9.3.5 Kuptimi mbi çrregullimet e humorit
9.3.6 Çrregullimi i personalitetit kufitar
9.4 Teknikat e këshillimit
9.4.1 Çfarë është këshillimi?
9.4.2 Rolet dhe funksionet e këshilluesit
9.4.3 Faza fillestare / faza parapërgatitore e shërbimeve të këshillimit
9.5 Puna me individin
9.5.1 Ndërhyrja në kriza
9.5.2 Modelet e këshillimit individual
9.6 Puna në grup
9.6.1 Përpilimi dhe mjedisi terapeutik
9.6.2 Puna në grup si art, besim dhe shkencë

10 KRIJIMI I NJË TË ARDHMEJE TË RE. 93
10.1 Vështirësitë
10.2 Integrimi në vendin e destinacionit
10.3 Rikthimi vullnetar i asistuar dhe riintegrimi në vendin e origjinës
10.3.1 Shërbimet e para-nisjes:
10.3.2 Asistenca dhe Shërbimet e Transportit:
10.3.3 Shërbimet pas-mbërritjes dhe të riintegrimit
10.4 Strehimi
10.4.1 Strehëzat
10.4.2 Familjet pritëse
10.4.3 Strehimet afatshkurtra dhe strukturat "gjysmë-të pavarura"
10.5 Ndihma mjekësore dhe mbështetja psikologjike
10.5.1 Ndihma mjekësore
10.5.2 Mbështetja psikologjike
10.6 Kërkimi i familjeve
10.6.1 Vlerësimi i familjes
10.6.2 Përgatitjet për ribashkimin me familjen
10.6.3 Hapat e propozuara për vazhdueshmerinë

REFERENCA 108

BIBLIOGRAFI 111

HYRJE

Trafikimi është një fenomen kompleks e shumë dimensional. E kaluara personale e viktimave me përvoja të përsëritura dhune dhe abuzimi, kufizime sociale dhe ekonomike, si dhe modifikimi i sjelljes së tyre në mënyrë që ato t'i përshtaten traumës së të qënit të detyruar për të punuar e për t'u shfrytëzuar duhet të konsiderohet nga perspektiva multidisiplinare.

Fazat e ndryshme të ndihmës së dhënë për viktimat e trafikimit kërkojnë prioritete të ndryshme. Si nevojat psikologjike ashtu edhe ato fizike të viktimave të trafikimit duhen të adresohen nëpërmjet një proçesi që lëviz që nga ndërhyrjet fillestare në raste krizash e deri në shërbimet afatgjata të mbështetjes..

Kjo literaturë prezanton argumente teorike, të mbështetura në fakte dhe të dhëna specifike, të cilat tregojnë rolin shumë të rëndësishëm që luan këshillimi psikologjik dhe përkujdesja shoqërore në këtë proçesin e parandalimit, trajtimit, rikthimit vullnetar të asistuar dhe riintegrimit të viktimave të trafikimit të qënieve njerëzore. Duke njohur dhe trajtuar problemet e shkaktuara si rrjedhojë e përjetimit të trafikimit, duke ruajtur respektin për anonimitetin dhe individualitetin e çdo personi, profesionistët e shërbimeve psiko-sociale do të mund të sigurojnë përgatitjen e një skeme ndihme gjithëpërfshirëse mbi baza individuale.

Është shumë e rëndësishme që si vendet e origjinës dhe ato pritëse të rrisin nivelin e bashkëpunimit dhe të shkëmbimit të informacionit ndërmjet tyre, në mënyrë që të përballen me nevojat specifike të viktimave.

Fokusimi vetëm në efektet e trafikimit të qënieve njerëzore, pa adresuar shkaqet themelore të tij, nuk mund të eliminojë problemin. Synimi për të reduktuar shkaqet rrënjësore politike, sociale dhe ekonomike të trafikimit, përfshirë këtu; papunësinë, varfërinë, pabarazinë gjinore, qëndrimet sociale dhe kulturore, si dhe kërkesën për krahë të lirë pune, duhet të jenë në krye të përpjekjeve afatgjata për të luftuar në mënyrë efikase trafikimin njërëzor.

Programet e parandalimit dhe të ndërhyrjes duhet të ngrihen me qëllim që të përforcojnë përpjekjet për reduktimin e varfërisë dhe marxhinalizimit të mëtejshëm të shoqërisë, veçanërisht mes grupeve më vulnerabël - si gratë dhe fëmijët - nëpërmjet masave të ndërmarra në drejtim të përmirësimit të qeverisjes, mbështetjes materiale, mbrojtjes shoqërore, punësimit dhe zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik. Për më tepër, legjislacioni dhe politikat për mundësi të barabarta duhet të mbrojnë dhe të forcojnë pozicionin ligjor dhe social të grave dhe fëmijëve si dhe të adresojnë në mënyrë të veçantë të gjitha format e diskriminimit gjinor. Vetëm nëpërmjet angazhimeve të burimeve dhe politikave përcaktuese gjithpërfshirëse do të mund të parandalohet dhe të luftohet kjo formë moderne e skllavërisë.

1 PËRKUFIZIME MBI TRAFIKIMIN E QËNIEVE NJERËZORE

Ndërkohë që koncepti i përgjithshëm i trafikimit, me tw cilin nënkuptohet tregtia e paligjshme e mallrave, duket se është i qartë, koncepti për trafikimin e personave/qënieve njerëzore është interpretuar në mënyra të ndryshme. Rritja e shkallës së trafikimit të qënieve njerëzore në vitet 1990, si dhe përpjekjet për të luftuar trafikimin në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, u shoqërua edhe me nevojën e një koncepti më të qartë, më të gjerë dhe të pranueshëm nga të gjithë. Megjithëse Konventat e herëshme të organizatës së Kombeve të Bashkuara në pjesën e parë të shekullit të 20 kishin dhënë një përkufizim specifik, trafikimi i qënieve njerëzore u përkufizua me referencat mbi "trafikun e mishit të bardhë", "trafikun e grave dhe fëmijëve", "skllavërinë", "punën e fëmijëve" dhe "trafikun e personave", ai shpesh herë ngatërrohej me shfrytëzimin dhe prostitucionin. Si rrjedhojë e kësaj masat kundër trafikimit mungonin apo ishin të paqarta, gjë që më pas u shoqërua me qëndrime të ndryshme lidhur me çështjet e trafikimit, e si rrjedhojë edhe me trajtimin e viktimave të tij.

1.1 PROTOKOLLI PËR PARANDALIM TË TRAFIKIMIT NDRYDHES DHE NDESHKUES TEK PERSONAT VEÇANËRISHT PËR GRATË DHE FËMIJËT[1]

Koncepti i ri ndërkombëtar i trafikimit jepet nga Protokolli i organizatës së Kombeve të Bashkuara mbi parandalimin, pengimin dhe ndëshkimin e trafikut të personave, veçanërisht të grave dhe fëmijëve[2], i njohur edhe si Protokolli i Palermos. Ky Protokoll përbën njëkohësisht edhe një nga tre Protokollët që plotësojnë Konventën e Kombeve të Bashkuara Kundër Krimit Ndërkombëtar[3] të organizuar. Protokolli i Palermos sjell një këndvështrim dhe një qëndrim të kombinuar i cili integron parandalimin efektiv të trafikimit, me ndjekjen penale të trafikantëve dhe me mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe ndihmën ndaj viktimave[4].

Sipas këtij Protokolli me trafikim të qënieve njerëzore do të kuptohet

"Rekrutimi, transportimi, transferimi, strehimi apo marrja e personave me anë të kërcënimeve apo përdorimit të forcës apo burimeve të tjera të detyrimit, fallsifikimit, rrëmbimit, mashtrimit, abuzimit me pushtetin, shfrytëzimit të një pozicioni lehtësisht të cënueshëm apo të marrët a të dhënët e një pagese apo përfitimeve, për të marrë miratimin e një personi që kontrollon një person tjetër për qëllime shfrytëzimi"

Shfrytëzimi do të përfshijë së paku shfrytëzimin e të tjerëve për prostitucion apo forma të tjera të shfrytëzimit seksual për punë apo për shërbime të detyruara, skllavëria apo praktika të ngjashme me të. Pranimi i viktimës për t'u trafikuar në persona për qëllime

shfrytëzimi...nuk përputhet në rastet kur janë përdorur mjetet [e lartpërmendura]...

Rekrutimi, transportimi, transferimi, strehimi apo marrja e fëmijëve për qëllime përfitimi do të konsiderohet "trafikim personash" edhe në rastet kur kjo nuk përfshin...asnjërën nga mjetet e përmendura më sipër.

Me "fëmijë"do të nënkuptohet çdo person nën moshën tetëmbëdhjetë vjeç (Neni 3)

1.1.1 Trafikimi i fëmijëve

Trafikimi i fëmijëve është akti i rekrutimit, transportimit, transferimit, fshehjes ose mbajtjes së fëmijëve, për qëllime shfrytëzimi si brenda shtetit, ashtu edhe jashte tij[5].
Trafikimi i fëmijëve përfshin:

1 Transferimin e fëmijës dhe ndarjen e tij nga komuniteti ku ai bën pjesë.
2 Detyrimin, fallsifikimin, mashtrimin apo abuzimin me pushtetin nga ana e traffikuesit.
3 Synimin shfrytëzues të trafikuesit.

1.1.2 Trafikant

Do të konsiderohet një person apo bashkësi personash, që kanë për qëllim të kryejnë, të bashkëpunojnë apo të japin pëlqimin për çdo një nga aktet që përshkruhen në trafikim[6].

1.1.3 Person i trafikuar

Termi *"person i trafikuar"*, nënkupton një person i cili është rekrutuar, transportuar, shitur, blerë, transferuar, pritur apo strehuar, siç edhe përshkruhet në përkufizimin e trafikimit, dhe në të përfshihet edhe një fëmijë, pavarësisht nëse fëmija ka pranuar ose jo[7].

1.1.4 Viktimë e Trafikimit

Me termin "*viktimë e trafikimit*"[8] do të kuptohet çdo person i thjeshtë, i cili bëhet subjekt i trafikimit të qënieve njerëzore ashtu siç është përcaktuar në Protokollin e Palermos.

1.1.5 Shfrytëzim

Shfrytësimi përfshin, por nuk kufizohet, shfrytëzimin e prostitucionit të të tjerëve ose forma të tjera të shfrytëzimit seksual, shërbimet apo punën e detyruar, skllavërinë apo praktika të ngjashme me skllavërinë, zgjedhën apo heqjen e organeve. Kjo mund të përfshijë gjithashtu abuzimet me pushtetin që nuk konsiderohet zyrtar, të tillë si shtatëzania me detyrim, adoptimi i paligjshëm, martesat me forcë dhe ato të jashtëligjshme, si dhe lidhjet e borxhit. Ai përfshin gjithashtu të gjitha aktet që i shtohen dhe që janë bashkëfajtorë me trafikimin, duke përfshirë korrupsionin, konspiracionin, si dhe prostitucionin vullnetar, vetëm nëse është kthyer në trafikim nëpërmjet mashtrimit, detyrimit me forcë apo abuzimit. Nuk duhet harruar që vulnerabiliteti mund të përfshijë gjithashtu faktin që viktima beson se nuk kishte ndonjë alternativë të arsyeshme përveçse të nënshtrohej[9].

1.1.6 Mashtrim
Dhënia e informacionit të rrem rreth kushteve të punës apo rreth natyrës së punës që do të kryhet.

1.1.7 Skllavëri
Statusi apo gjëndja e një personi mbi të cilin ushtrohen të gjitha apo ndonjë nga kopetencat që kanë të bëjnë me të drejtën e pronësisë. Praktikat skllavëruese përfshijnë skllavërinë me anë të borxhit, punën e detyruar për tjetrin, martesat skllavëruese dhe punën e fëmijëve.

1.1.8 Skllavëri borxhesh
Përdorimi i punës apo i shërbimeve të dikujt si garanci për borxhet, ndërkohë që vlera e punës akoma nuk është nxjerrë nga borxhi, ose gjatësia dhe lloji i punës nuk janë qartësuar. Shumë grave nuk ju thuhen përcaktimet e borxhit-sa kohë që ato duhet të qëndrojnë për ta shpaguar atë. Shpesh herë kostoja e trasportimit, veshjet dhe gjërat personale për gratë i shtohen borxhit dhe interesi i tij rritet. Gruaja që është skllave e borxhit nuk ka alternativë tjetër por duhet të vazhdojë të punojë derisa ta ketë shlyer atë.

1.1.9 Punë e forcuar apo e detyruar ose kushte të ngjashme me skllavërinë
Abuzimi dhe puna në kushte të detyruara në të cilën njerëzit punojnë pa dëshirën e tyre. Puna mund të konsistojë në punë shtëpiake, riprodhuse apo shërbime të tjera, madje dhe këto nuk njihen si punë apo aktivitete të ligjshme.

Puna është e papërcaktuar dhe e palimituar në (kohë). Nëse personi ka qenë *'këmbyer'* për një shumë të caktuar, '*blerësi'*, '*pronari*' mund të ushtrojë pushtet dhe autoritet të plotë mbi të.

1.2 TRAFIKIMI DHE PROSTITUCIONI, PROSTITUCIONI "I LIRË" DHE I "FORCUAR"

"Disa gra hyjnë në prostitucion vullnetarisht. Në rast të kundërt kemi të bëjmë me një shtrëngim...Por asnjë grua e trafikuar nuk ka imagjinuar ndonjëherë që kushtet e punës do të mund të ishin për të ardhur keq..."[10]

Konventa e vitit 1949 e Kombeve të Bashkuara mbi Shtypjen e Personave të Trafikuar i konsideronte të gjitha format prostitucionin si shfrytëzim. Që nga ajo kohë mënyra sesi trajtohen prostitucioni "*i lirë"* dhe ai *"i forcuar"* ka pësuar një ndryshim të dukshëm dhe të rëndësishëm.

Deklarata e vitit 1993 për Eliminimin e Dhunës Kundër Grave[11] dhe Platforma e Pekinit për Veprim kanë njohur vetëm *prostitucionin e forcuar* si një dhunim të të Drejtave të Njeriut. Prirjet aktuale e trajtojnë punën e seksit si një formë pune të përligjur[12] dhe në të njëjtën kohë edhe organizata Ndërkobëtare e Punës (ILo) e klasifikon trafikimin si një formë të punës së forcuar.

Krahas kësaj ka pikëpamje që argumenojnë se të njëjtat kushte degraduese të trafikimit ekzistojnë edhe në prostitucion. Kundër të drejtës individuale për vetvendosje, ato argumentojnë se nuk ekziston diçka e tillë që mund të quhet prostitucion i lirë, asnjë grua nuk mund të punojë në të

vullnetarisht, por nëpërmjet përdorimit të mjeteve mashtruese dhe abuzimit me gjëndjen e vulnerabilitetit. Kontrolli dhe shfrytëzimi ushtrohet nga protektorët. Për më tej pohohet që parandalimi i prostitucionit duhet të konsiderohet si një masë për parandalimin e trafikimit, duke njohur kështu faktin që kërkesa për prostitucionin çon në rritjen e shpejtë të fenomenit të trafikimit.

Prostitucioni është legalizuar në pjesën më të madhe të vëndeve të Europës. Një qëndrim i veçantë në lidhje me prostitucionin ka mbajtur Suedia, ku prostitucioni me vendim të parlamentit dhe të qeverisë konsiderohet si një *"dhunim i grave, një problem i rëndësishëm social që shoqërohet me një sërë rreziqesh sociale dhe individuale."* Si rrjedhojë këtu nuk kemi fare një dallim ndërmjet prostitucionit të lirë dhe atij të forcuar. Sipas legjislacionit suedez gratë që prostituojnë nuk konsiderohen të përgjegjshme, por blerja e shërbimeve të seksit është e ndërshkueshme, duke u fokusuar kështu në blerësin dhe jo në ofruesin e shërbimeve të seksit.
Gjithashtu shtrohet për diskutim edhe çështja nëse legalizimi i prostitucionit mund të luajë një rol edhe në forcimin e masave kundër trafikimit të grave dhe vajzave. Nga një studim është argumentuar se *"legalizimi i prostitucionit nuk është shoqëruar me ndonjë ndikim domethënës në shkallën e përhapjes së trafikimit"*[13]. Për më tepër, numri më i madh i vajzave dhe grave të trafikuara është identifikuar në vendet e Europës Perëndimore në të cilat prostitucioni është i legalizuar.

1.3 PSE TRAFIKOHET?

Trafikimi i heq viktimave të tij të drejtën për një jetë produktive, shpërblyese dhe me dinjitet. Viktimat janë nënshtruar, robëruar, abuzuar nga trafikantët, kriminelët, punëdhënësit dhe klientët. Gratë, vajzat dhe fëmijët e trafikuar janë të rrahura dhe të abuzuara dhe dhuna haset në të gjitha format e saj.

1 Trafikimi i femrave për shfrytëzim për prostitucion

Është nga format më të ashpra të trafikimit, për të përdoren të njëjtat rrugë kalimi si edhe për trafikun e personave që emigrojnë për punësim. Në pjesën më të madhe të rasteve vajzat dhe gratë janë trafikuar për të punuar në shtëpi publike, masazhiere, klube nate ose për të prodhuar materiale pornografike.

2 Trafikimi i qënieve njerëzore për emigrim punësimi e qëndrimi

Format e përdorura nga trafikantët për t'i detyruar femrat për trafikim e për të ushtruar prostitucionin kanë qenë:

- Mashtrimet për t'u martuar dhe për të jetuar jashtë shtetit.
- Mashtrimet për sigurim pune e kushte jetese jashtë shtetit.
- Mashtrimet duke përdorur femra ndërmjetëse e me pagesë.
- Rrëmbimet e përdhunimet si dhe kërcënimet për jetën e familjen e saj.
- Blerjet e femrave nga pjesëtarë të familjeve të tyre.
- Kompromentimet me anën e dhuratave, parave e duke krijuar detyrime të tjera materiale.

Për përdorimin e këtyre formave të detyrimit janë shfrytëzuar shkaqe social-ekonomike, si: varfëria, mungesa e punës, jeta e mbyllur e jo aktive, dëshira për të shkuar jashtë shtetit e për të punuar normalisht, dëshira për t'u martuar e bashkëjetuar jashtë shtetit, rrëmbimi, ekzistenca e opinionit përbuzës për vajzat që gabojnë etj

3 Puna e Forcuar

Kohët e fundit ka pasur një njohje të faktit se trafikimi përfshin jo vetëm trafikimin e detyruar për shfrytëzim seksual, por gjithashtu është i njohur trafikimi i grave, burrave dhe fëmijëve për punë të detyruar. Sipas përkufizimit të organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILo) kemi këtë përkufizim për punën e forcuar *"kryeja e punëve apo shërbimeve si rrjedhojë e një kërcënimi apo ndërshkimi."* Në përgjithësi ekzistojnë gjashtë elementë që dëshmojnë një situatë të punës së detyruar:

1. Dhunë fizike dhe seksuale
2. Kufizimi i lëvizjeve të punonjësit
3. Varësi nga borxhet, punë e detyruar
4. Mosdhënia e shpërblimit apo refuzimi i pagesës për të gjithë
5. Mbajtja e pashaportave apo dokumenteve të tjera të identifikimit, dhe
6. Kërcënimi për denoncim tek autoritetet.

4 Trafikimi i fëmijëve me qëllim abuzimi e përfitimi

Trafikimi i fëmijëve është akti i rekrutimit, transportimit, transferimit, fshehjes ose mbajtjes se fëmijëve, për qëllime shfrytezimi si brenda shtetit, ashtu edhe jashte tij[14].
Trafikimi i fëmijëve, sidomos i vajzave të vogla, shihet si një burim maksimal fitimi për trafikantët të cilët shfrytëzojnë çdo mundësi për ta realizuar atë.

Një faktor shqetësues që ndikon në rritjen e numrit të fëmijëve që trafikohen është edhe rritja e numrit të fëmijëve të pashoqëruar. Më të ekspozuar ndaj fenomenit të trafikimit janë fëmijët që vijnë nga familje me të ardhura të pakta dhe nivel të lartë papunësie.

Abandonimi i shkolles në zonat rurale, dhe lëvizja masive demografike e familjeve, veçanërisht nga zonat veri-lindore, solli që shumë fëmijë të fillojnë të punojnë në rrugët e qyeteve të mëdha, nga ku ata u bënë viktima të rekrutimit në aktivitete kriminale dhe në rrjete trafikimi të organizuara. Në raste të tjera, sidomos në komunitete dhe familje të marxhinalizuara, jo të ndërgjegjësuara për trafikimin dhe pasojat e tij, në shumë raste nxitet dërgimi i fëmijëve jashtë shtetit me besimin se atje do të krjojnë një të ardhme më të mirë duke bërë marrëveshje me të ashtuquajturit "*mbrojtës"* të fëmijëve.

Burimet më të spikatura të rekrutimit të fëmijëve për trafikim janë nga:

1 Familje të divorcuara ku mungon kujdesi familjar.
2 Familje me shumë fëmijë dhe në gjendje të vështirë ekonomike.
3 Familje fshatare me shpresë ndihme nga fëmijët.
4 Fëmijë të mbetur jetimë dhe pa përkujdesje.
5 Fëmijë të cilëve prindërit u janë larguar për punësim jashtë shtetit.
6 Fëmijë të cilët kanë braktisur shkollën dhe janë marrë me lypësi e veprimtari tjetër të

kundërligjshme edhe në Shqipëri.

7 Fëmijë të cilët nuk mund të shkojnë në shkollë.

8 Fëmijë të paregjistruar që në lindje.

9 Familje ku të paktën një fëmijë është trafikuar edhe më parë.

10 Familje ku fëmijët kanë paaftësi mendore, ose janë lindur nga prindër me paaftësi mendore.

11 Fëmijë të dalë nga martesa e prindërve në moshë të madhe.

12 Kushtet e jetesës së të miturve të trafikuar në shumicën e rasteve janë të mjerueshme, punë e rëndë, me orar të zgjatur dhe pagesë minimale. Këta fëmijë janë më të preferuar për trafikantët, sepse u kushtojnë atyre pak dhe përfitimi që marrin nga puna e tyre është gjithnjë e në rritje.

1.4 FAKTORET QË LEHTËSOJNË TRAFIKIMIN

Trafikimi prek të gjitha qëniet njerëzore, gratë, burrat dhe fëmijët. Megjithatë grupi më i madh i prekur nga ky fenomen janë gratë. Trafikimi është simptomë e një sërë arsyesh themelore të cilat identifikohen si:

1 **"Feminizimi i varfërisë**", kushtet ekonomike, sociale dhe kulturore të grave në vendet e origjinës, mundësitë e kufizuara profesionale dhe ekonomike të ofruara për gratë në krahasim me burrat.

2 **Pabarazia gjinore**. Dhuna me bazë gjinore.

3 **"Feminizimi i migrimit"** dhe impakti i politikave kufizuese të migrimit që nxisin zhvillimin e kanaleve ilegale të migrimit.

1.4.1 Varfëria

Varfëria, papunësia, dhuna në familje (përfshirë dhunën seksuale), diskriminimi ndaj grave dhe niveli i ulët i arsimit janë shkaqet kryesore të trafikimit. Pjesa më e madhe e viktimave të asistuara në Shqipëri[15], raportohen të jenë të papuna, me nivel shumë të ulët arsimimi, me aftësi profesionale minimale si dhe vijnë nga familje në të cilat ushtrohet dhunë si dhe raportohen raste të abuzimit seksual. Shumë prej tyre vijnë nga zona rurale apo nga zona me një nivel shumë të lartë papunësie. Nevojat ekonomike kanë qenë faktori kryesor që i ka shtyrë gratë e trafikuara të provojnë mundësitë e ngritjes së të ardhurave të tyre duke shkuar jashtë vendit[16].

Shkaqet e varfërisë përfshijnë konfliktet etnike; rritjen e papunësisë si shkak i transformimeve të sistemeve ekonomike; privatizimit të shërbimeve sociale, etj. Gjithë këto ndryshime ekonomike e shoqërore kanë një ndikim të madh veçanërisht tek femrat; (numri më i madh i personave të papunë përbëhet kryesisht nga gratë dhe vajzat), në këtë mënyrë ato kanë filluar të migrojnë, proçes ky që ka qenë deri më parë tipik për meshkujt.

Në një kohë kur shërbimet sociale janë inekzistente, përgjegjësia kryesore për mbështetjen e familjeve, (të moshuarit, fëmijët, personat me aftësi të kufizuara) ka rënë mbi gratë. Situata e vështirë ekonomike dhe shoqërore është shoqëruar gjithashtu me rritjen e nivelit të mortalitetit, nivel të lartë të vetvrasjeve, përdorimin e alkoolit dhe përhapjen e gjerë të **dhunës në familje.**

Sipas disa studiuesve, ekzistojnë dy fenomene *"kulturore"* të cilat kontribuojnë në përforcimin e pozitave të dobëta që kanë gratë në realitetin e ri shoqëror[17]. Largimi i grave nga sferat e jetës politike, përfshirë këtu edhe ekonominë, si dhe
Reklamimi i industrisë së seksit si shenjë e *"një epoke të re,"* dhe si një mënyrë e re e përfitimit të të ardhurave.

1.4.2 Migrimi

Kohët e fundit raportohen disa tendenca të reja me çështjet që lidhen me problemin e migrimit[18] të cilat mund t'i përmbledhim si më poshtë vijon:

1. Rritje të migrimit me hapa të shpejta.
2. Rritje e numrit të emigranteve femra
3. Rritje e numrit të fëmijëve që janë të pashoqëruar
4. Rritje e kostos për ndërmjetësimin e migrimit
5. Kërkesa për krah të lirë pune e të pasiguruar në vendet e destinacionit
6. Kushte abuzive pune për emigrantët në vendet e destinacionit.

Këto tendenca tregojnë se kërkesa për krah të lirë pune në vëndet e industrializuara e kombinuar me gadishmërinë e njerëzve në vëndet në zhvillim për të emigruar, si dhe rritja e shkallës së vështirësisë për një emigracion të ligjshëm dhe punësim të rregullt në vendet e destinacionit, krijon mundësinë e rritjes së nivelit të trafikimit të qënieve njerëzore. Në përgjithësi feminizimi i emigracionit është shoqëruar me rritjen e nivelit të vulnerabilitetit të grave emigrante përkundrejt diskriminimit, shfrytëzimit, dhe abuzimit të tyre.

Në vendet e destinacionit, gratë emigrante, ndryshe nga burrat, janë më të prirura që të përfshihen në punë të *"pista"*, *"të rrezikshme"* dhe *"të vështira"*. Prostitucioni shoqërohet me kërcënime të shumfishta për gratë të cilat janë trafikuar për të punuar në industrinë e seksit.

Kalimi i kufirit mund të bëhet në mënyrë ligjore nga emigrantët duke përdorur pasaportat nëpërmjet kalimit zyrtar të kufirit, ose në mënyrë ilegale, pa dokumenta personale, duke u paguar rryshfete zyrtarëve të kufirit, si dhe nëpërmjet kalimit të kufirit në mënyrë të fshehtë nëpër lumenj e pyje.

Emigrantët pa dokumenta (të cilët quhen ndryshe emigrantë ilegal apo emigrantë të parregullt) janë ata njerëz që nuk kanë një status ligjor për qëndrimin në atë vend si rezultat i një hyrje të parregullt apo mbiqendrimit në të. Sidoqoftë emigrimi është proçesi ku njerezit zgjedhin në mënyrë të ndërgjegjeshme të lenë një vend për një tjetër, zakonisht në kërkim të punës dhe të një jete më të mirë.

Shumë ligje kanë dështuar në realizimin e dallimit ndërmjet trafikimit të qënieve njerëzore dhe hyrjes ilegale të emigrantëve. Kjo gjë krijon një situatë të vështirë për personat e trafikuar; në vend që të konsiderohen si viktima të një krimi kundër tyre, ata trajtohen si kriminelë, në momentin kur identifikohen dhe ndalohen nga organet e drejtësisë në vendin përkatës.

Zakonisht personat e trafikuar janë të pafuqishëm që të kthehen prapa në vendet e tyre pa një

mbështetje emocionale, psikologjike apo ekonomike. Duke mos pasur asnjë ndihmë të tillë ata janë të paaftë të kundërshtojnë ngarkimet kriminale kundër trafikantëve të tyre.

1.4.3 Pabarazia gjinore

Pabarazia gjinore dhe sociale e grave dhe vajzave është një arsye për rritjen e shkallës së trafikimit të qënieve njerëzore. Një klimë e tillë është krijuar duke i parë gratë/vajzat dhe fëmijët si mallra që mund të blihen dhe shiten.

Shumë shpesh vajzave u është mohuar mundësia për të studiuar në shkollë, ato janë të detyruara të rrinë në shtëpi për të kryer punët e shtëpisë e si rrjedhojë ato mbeten të paafta dhe të pa arsimuara, janë të abuzuara nga familjet e tyre, e kthehen në këtë mënyrë pre e joshjeve të trafikantëve, gjë që në dukje u paraqitet si një ikje prej shfrytëzimit shtëpiak dhe mjedisit dhunues ku jetojnë.

Në ndryshim nga dhuna e rrugës, që konsiderohet si krim, dhuna në familje ndaj grave dhe fëmijëve shihet si legjitime, e pranueshme, ndonjëherë edhe e dëshirueshme, ose injorohet për arsye se është dukuri që ndodh në sferën private të familjes. Termi "*dhunë ndaj grave*"[19] i referohet llojeve të ndryshme të sjelljeve të dëmshme ndaj grave dhe vajzave, për arsye të seksir të tyre.

Për shumicën e vajzave dhe grave migrimi apo kërkimi i punës jashtë komunitetit të tyre nuk është vetëm një zgjidhje ekonomike, por mund të jetë edhe mundësi për të gjetur lirinë personale, kushte më të mira jetese, ose edhe si një rrugëzgjidhje për të mbështetur familjet e tyre[20].

1.5 FAZAT E PROÇESIT TË TRAFIKIMIT

Nga perkufizimi ne mund të vërejmë disa faza apo aspekte të ndryshme të proçesit të trafikimit:

Rekrutimi mund të ndodhë si një veprim dhunues fizik nga rrëmbimi i viktimes, ose nga kërcënimi apo edhe përmes mashtrimit, premtimit të një pune të mirë, apo nga forma të tjera të detyrimit, të tilla si; skllaveria e borxhit, abuzimi me pozicionet e autoritetit kur prindërit bien dakorte të shesin fëmijën e tyre apo edhe ushtrimi i formave të ndryshme të autoritetit mbi viktimat e përfshira në trafikim.

Tranzit/Udhëtimi. Viktimat mund të detyrohen në rastet e rrëmbimit të udhëtojnë nën kërcënim. Trafikantet mund të shtrëngojnë lirinë e lëvizjes së grave/vajzave duke iu marrë atyre pasaportën apo kartat e identitetit, në mënyrë të tillë që të ngushtojnë pavarsinë dhe mundësinë e kthimit të tyre në shtëpi.

Ngacmimet seksuale dhe përdhunimet mund të ndodhin gjatë ose pas fazës së trasportimit. Ngandonjëherë personat e trafikuar shiten disa herë me ndërmjetësim të trafikanteve të tjerë përpara sesa ato të arrijnë në vendin e destinacionit përfundimtar.

Është e rëndësishme që të theksojmë se rekrutimi dhe trasportimi jo gjithmonë mund të jenë

veprime të forcuara. Shumë gra dhe fëmijë rekrutohen dhe lënë vendin e tyre të origjinës me vullnetin e tyre të plotë.

Mbërritja në vendin e destinacionit: Personat e trafikuar të detyruar nga mashtrimi me qëllimin kryesor të shfrytezimit dhe abuzimit të tyre, shpeshherë vendosen në kushte të ngjashme me skllavërinë. Gratë që zgjedhin të emigrojnë për punë, shpesh janë viktima të mashtrimit për kushtet e punës në të cilat ato do të punojnë.

Shumë gra dhe vajza e gjejnë veten duke punuar kundër dëshirës së tyre, në kushte shfrytëzimi e në lloje të ndryshme punësh të tilla si; punëtore shtëpie, në fabrika apo në industrinë e seksit. Ato humbasin kështu të drejtën për të qenë të lira dhe të shndërrohen në objekte të dhunës, abuzimit dhe formave të tjera shtrënguese.

Punët në kushte jo-njerëzore, të paguara shumë pak, minimumi standartit të sigurisë, ngacmimet seksuale, skllavëria e borxheve janë problemet më të hasura të këtij grupi shoqëror.

1.6 PRoFILET E TRAFIKANTËVE

"*Trafikantët*" nuk përbëjnë një grup homogjen. Analizat tregojnë se metodat dhe mënyrat e rekrutimin ndryshojnë në bazë të sërë faktorësh, si; vendi i origjinës së gruas/vajzës (fshati, qyteti), njohuritë mbi qëllimin e udhëtimit, marëdhënia ekzistuese ndërmjet gruas/vajzës dhe rekrutuesit, etj. Ekzistojnë disa tipe "*trafikantësh*" që mund të klasifikohen;

1 Anëtarë të grupeve kriminale të organizuara, shpeshherë ndërkombëtare. Janë të përfshirë në disa lloj aktivitetesh kriminale, si trafikimi dhe kontrabanta e mallrave, si dhe marrin përfitime prej shfrytëzimit seksual të grave dhe vajzave të trafikuara që shpesh ushtrohet në baret apo mjediset që janë pronë e tyre.

2 Protektorët dhe/ose persona lokalë që vijnë nga të njëjtat vënde në të cilat janë rekrutuar viktimat. Njerëz të afërt të viktimave (të njohur, fqinjë, miq apo të dashur) shpeshherë dhe të fejuar të tyre, që u premtojnë një jetë më të mirë së bashku jashtë vendit. Në këtë grup përfshihen gjithashtu edhe gratë të trafikuara më parë por që kanë filluar të bashkëpunojnë me kriminelët dhe të punojnë si ndërmjetëse për ta, duke u kthyer në vendin ku jetojnë për të rekrutuar të tjerë.

Në raste të tjera kryesisht në **trafikimin e fëmijëvve** mund të përfshihen pjestarë të afërt të familjes (dajallarët, xhaxhallarët, vëllezërit madje edhe nënat.) Shumë familje mund të mos e konsiderojnë këtë si trafikim, por e trajtojnë si një strategji që familja të mbijetojë, apo si një strategji për të mbrojtur fëmijën e tyre (dmth duke e dërguar fëmijën në një vend që premton për një të ardhme më të mire.)

3 Bisnesmenë, punonjës policie dhe politikanë të cilët bashkëpunojnë me krimin e organizuar dhe marrin përfitime nga trafikimi. Ata shpeshherë janë vetë pronarë baresh apo kujdesen për manaxhimin e tyre.

2 TRAFIKIMI DHE TË DREJTAT E NJERIUT

Trafikimi është një problem kompleks e me shumë dimensione, ai është trajtuar si:

- Dhunim i të drejtave të njeriut, ai dhunon një sërë të drejtash për personat e trafikuar; si e drejta për respekt dhe dinjitet, e drejta për barazi, e drejta e lirisë, ndalimi i keqtrajtimit ç'njerëzor dhe degradues, respektin për të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore.
- Një formë moderne e skllavërisë
- Një formë e krimit (ndërkombëtar) të organizuar.
- Një krim kundër humanizmit
- Një formë e dhunës seksuale ndaj grave.

2.1 PARIMET DHE UDHËZIMEVE TË REKOMANDUARA MBI TË DREJTAT E NJERIUT DHE TRAFIKIMIN QËNIEVE NJERËZORE

Zyra e Komisariatit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut (UNOHCHR) ka hartuar dokumentin "Parime dhe Udhëzime të Rekomanduara mbi të Drejtat e Njeriut dhe Trafikimin e Qënieve Njerëzore." Këto rekomandime përfshijnë ndërhyrjet drejtuar faktorëve të ndryshëm që rrisin vulnerabilitetin ndaj fenomenit të trafikimit, të tilla si; pabarazia, varfëria dhe të gjitha format e diskriminimit, por gjithashtu ato bëjnë thirrje për aktivitete që u drejtohen shkaktarëve burimorë të trafikimit; si dhe për përfshirjen e sektorit publik në luftën kundër trafikimit.

Strategjitë e propozuara nga UNOHCHR janë:

1 Analizimi i faktorëve që gjenerojnë kërkesën për shfrytëzimin e tregtisë së shërbimeve të seksit, dhe punës së detyruar si dhe marrja e masave të forta ligjore, politikave e masave të tjera që u adresohen këtyre çështjeve.

2 Zhvillimi i programeve që ofrojnë mundësi alternative për mjete jetese, përfshirë këtu arsimin bazë, trajnimin profesional veçanërisht kjo për gratë dhe grupet e tjera tradicionale në disavantazh.

3 Përmirësimi i mundësive të fëmijëve për të pasur akses në arsimim, dhe rritja e nivelit të frekuentimit të shkollës, në veçanti kjo për fëmijët vajza.

4 Krijimi i mundësive për emigrantët potencial, veçanërisht ato femra, që të informohen në mënyrë të mjaftueshme rreth rreziqeve të emigrimit (p.sh. shfrytëzimin; krijimin e borxheve; çështjeve të tjera që lidhen me shëndetin dhe sigurinë personale, përfshirë këtu ekspozimin ndaj virusit HIV), si dhe rrugët e mundshme për emigracion ligjor, të rregullt dhe jo shfrytëzues.

5 Zhvillimi i fushatave të ndërgjegjësimit për opinionin publik për informimin rreth risqeve që lidhen me trafikimin e qënieve njerëzore. Fushata të tilla duhet të informojnë opinionin publik rreth kuptueshmërisë dhe kompleksitetit të fenomeneve që lidhen me trafikimin e grave/vajzave dhe fëmijëve si dhe arsyeve që shtyjnë njerëzit të emigrojnë duke ndërmarrë kështu vendime të cilat paraqesin rrezikshmëri të lartë për ta.

6 Rishikimi dhe modifikimi i politikave që mund të shtrëngojnë njerëzit të emigrojnë në mënyrë jo të ligjshme. Ky proçes duhet të përfshijë shqyrtimin e efekteve shtypëse dhe diskriminuese lidhur me kombësinë, pronën, emigrimin, si dhe ligjet për punën e emigrantëve, veçanërisht për gratë.

7 Shqyrtimi i mënyrave që lejojnë rritjen e mundësive për emigrim ligjor, fitimprurës dhe jo shfrytëzues.

8 Forcimi i kapaciteteve të institucioneve ligjvënëse për të ndaluar dhe dënuar personat e përfshirë në trafikimin e qënieve njerëzore. Kjo gjë ndërmerret në kuadër të masave parandaluese të trafikimit të qënieve njerëzore dhe nënkupton fuqizimin e organeve të drejtësisë në përputhje me detyrimet e tyre ligjore.

9 Marrja e masave që reduktojnë vulnerabilitetin, duke bërë të mundur që dokumentet e nevojshme ligjore lidhur me lindjen, nënshtetësinë dhe martesën të sigurohen dhe jenë në dispozicion për të gjithë.

Ky karakter gjithpërfshirës i "Parimeve dhe Udhëzimeve të Rekomanduara mbi të Drejtat e Njeriut dhe Trafikimin e Qënieve Njerëzor" të UNOHCHR lejon zhvillimin e strategjive të ndryshme me karakter kombëar (në vëndet e origjinës, të tranzitit dhe të destinacionit). Ato në mënyrë të qartë tregojnë faktin që politikat shtrënguese të emigrimit mund të detyrojnë njerëzit të ndërmarrin iniciativa jo ligjore për të emigruar, dhe si rrjedhojë e kësaj e ekspozojnë veten e tyre ndaj rrezikut të trafikimit të qënieve njerëzore, në të njëjtën kohë ky dokument sugjeron gjithashtu edhe rritjen e mundësive për emigrim ligjor, frytdhënës dhe jo shfrytëzues.

Duhet theksuar se, megjithëse dokumenti "*Parimet dhe Udhëzimet e Rekomanduara mbi të Drejtat e Njeriut dhe Trafikimin e Qënieve Njerëzore"* e hartuar nga UNOHCHR-ja është adoptuar nga Këshilli Social Ekonomik i Kombeve të Bashkuara (ECOSOC) në vitin 2002 dhe është bërë pjesë e kuadrit ndërkombëtar të të drejtave të njeriut por në të njëjtën kohë qeveritë e vendeve pjesmarrëse në të nuk kanë detyrim ligjor për zbatimin e këtyre udhëzimeve.

2.2 UDHËZIME MBI MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË FËMIJËVE VIKTIMA TË TRAFIKIMIT NË EVROPËN JUGLINDORE

Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët (UNICEF) punon me qëllim që të promovojë të drejtat e fëmijëve dhe grave për mbijetesë, zhvillim, mbrojtje dhe pjesmarrje në përputhje me kuadrin e krijuar nga Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës (CRC)[21] dhe Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW)[22].

UNICEF e ka përqëndruar vëmendjen dhe ekspertizën e tij për çështjet që lidhen me trafikimin dhe shfrytëzimin seksual të fëmijë në rritjen e ndërgjegjësimit publik, advokacinë për të drejtat e fëmijëve dhe përmirësimin e situatës për fëmijët e riskuar.

Në kuadër të Paktit të Stabilitetit dhe në bashkëpunim me qeveritë dhe OJF-të e vendeve të Europës Juglindore, UNICEF ka hartuar dokumentin **"Udhëzime mbi Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve Viktima të Trafikimit në Evropën Juglindore"[23].** Këto udhëzime përforcojnë faktin që fëmijët viktima të trafikimit kanë të drejtën e mbrojtjes së veçantë për shkak të statusit të tyre të dyfishtë, si fëmijë dhe si viktima të krimit. *Udhëzimet* rekomandojnë, ndër të tjera, edhe qëndrimin pro-aktiv në identifikimin e fëmijëve viktima të trafikimit. Fëmijët "*viktima të trafikimit, gëzojnë të drejtën të marrin kujdesje dhe mbrojtje afat-gjatë duke përfshirë siguri, ushqim, strehim të sigurt, akses në shërbimet shëndetësore dhe arsimore, mbështetje psiko-sociale dhe riintegrim"*.

3 KUADRI LIGJOR NË LIDHJE ME TRAFIKIMIN

3.1 ÇËSHTJE LIGJORE DHE PRAKTIKE LIDHUR ME TRAFIKIMIN E GRAVE, TË VAJZAVE DHE FËMIJËVE

3.1.1 Trafikimi si një formë e krimit të organizuar

Protokolli për Anti-Trafikimin, si një dokument plotësues i Konventës së OKB-së Kundër Krimit të Organizuar Transnacional, është tregues i lidhjeve ekzistuese ndërmjet krimit të organizuar dhe trafikimit të qënieve njerëzore. Sipas kësaj Konvente, **një grup i organizuar kriminal** përcaktohet si "*grup i përbërë prej tre apo më shumë personash, që ekziston për një periudhë kohe të caktuar dhe që* ***vepron nën qëllimin e*** *kryerjes së një apo më shumë krimeve apo shkeljeve serioze apo për të marrë, direkt apo indirekt, përfitime financiare apo të ndonjë lloji tjetër*."

Elementi trasnacional është një **tjetër tipar kryesor** i rrjeteve të trafikimit. Realisht si **të pashtete** dhe shumë të shpejtë, trafikantët mund të veprojnë në vende të ndryshme, duke iu shmangur detyrimeve ligjore kombëtare. Edhe pse ata dhunojnë sovranitetin kombëtar, mund ta perdorin atë për qellime mbrojtëse. Përveç kësaj, **ky fenomen** njeh edhe shumëllojshmërinë e shtetësive të anëtarëve të rrjeteve të trafikimit.

3.1.2 Qëndrimi i Bashkimit Europian

Në përpjekjet e tij për të kthyer lirinë, sigurinë dhe drejtësinë në një realitet për qytetarët e tij, **Bashkimi Europian** ka vendosur si objektiv parandalimin dhe luftën ndaj krimit të organizuar. Kjo është percaktuar në Traktatin e Bashkimit Europian, me një version të konsoliduar në Traktatin e Amsterdam-it. Neni 29 i Titullit VI *"Masat për policinë dhe bashkepunimi me gjyqesorin në ceshtjet e krimit"* e përfshin trafikimin e personave në listën treguese të formave të krimit" *të organizuar apo tjetër*," i cili duhet luftuar përmes një bashkëpunimi më të ngushtë me policinë, pushtetin gjyqësor apo me autoritetet e tjera kompetente të qeverisjes.

Në këtë dokument "*Trafikimi i personave*" përcaktohet i lidhur edhe me "*shkeljet kundër fëmijëve*."Forma të tjera të krimit të përmendura në këtë listë janë gjithashtu: terrorizmi, trafikimi i paligjshëm i drogave, trafikimi i paligjshem i armëve, korrupsioni dhe vjedhja. Pranimi i trafikimit si një formë e krimit të organizuar është mirëpritur si një zhvillim pozitiv në perpjektet për të luftuar problemin.

3.1.3 Ndalimi me ligj i trafikimit të qënieve njerëzore si një e drejtë themelore: Karta Europiane e të Drejtave të Njeriut

Ndalimi me ligj i trafikimit të qënieve njerëzore është përfshirë në Kartën e të Drejtave Themelore të Bashkimit Europian (neni 5, para. 3), menjëherë pas ndalimit me ligj të skllaverisë dhe robërisë (neni 5, paragrafi 1) dhe ndalimit me ligj të punës së detyruar (neni 5, paragrafi 2). Ndalimi me ligj i përcaktuar në këtë paragraf është absolut dhe pa kushte: "*trafikimi i qënieve njerëzore ndalohet me ligj*".

Qëllimi duket se kufizohet tek trafikimi për qëllimin e shfrytëzimit seksual. Sikurse është sqaruar "Trafikimi i qënieve njerëzore... nënkupton format moderne të krimit të organizuar dhe shfrytëzimit të personit: trafikimin e femrave dhe fëmijëve, si dhe veçanërisht zhvillimin dhe veprimin e rrjeteve ndërkombëtare të prostitucionit.

Në kontekstin e bashkëpunimit me drejtësinë dhe punët e brendëshme, shtetet anëtare të Bashkimit Europian kanë ndërmarrë hapa të përbashkëta për të luftuar krimin e organizuar apo, më konkretisht, veprime kundër trafikimit të qënieve njerëzore dhe përdorimit për shfrytëzim seksual të femrave dhe fëmijëve"

3.1.4 Masa kundër formave të rënda të trafikimit: këshilli i vendimmarrjes së punës për luftën kundër trafikimit të qënieve njerëzore

Në këtë institucion të rëndësishem ligjvënës trafikimi i qënieve njerëzore konsiderohet si një krim serioz, dhe jo thjesht si një abuzim me të drejtat e njeriut. Por kjo nuk hedh poshtë faktin se: "*trafikimi i qënieve njerëzore përbën një abuzim serioz të të drejtave dhe lirive thelbesore të njeriut, si dhe abuzim të dinjitetit njerëzor...*"

Trafikimi mund të luftohet nëpërmjet mbajtjes së një qëndrimi të përbashkët nga të gjitha shtetet anëtare të BE, duke vënë në dukje "*përkufizimin e elementëve përbërës të ligjit kundër krimit të organizuar, i cili është i përbashkët për të gjitha shtetet anëtare, dhe që perfshin sanksione efektive, të njëtrajtshme dhe parandaluese*." Me fjalë të tjera, preokupimi më i madh i këtij Këshilli është vënia përpara drejtësisë e përgjegjësisë kriminale të personave natyrorë dhe ligjor, si dhe vendosja e sanksioneve të duhura e "*harmonizimi*" i këtyre sanksioneve në të gjitha shtetet anëtare.

Në këtë dokumet klasifikohen dy forma të trafikimit të qënieve njerëzore; (1) trafikim me qëllim **pune** dhe (2) trafikim me qëllim **abuzimin seksual**. Përkufizimi i trafikimit bazohet në përkufizimin e Protokollit të Palermos së Kombeve të Bashkuara, megjithëse jo i formuluar identikisht. Perkufizimi i Vendimit të Këshillit të Punës[24] përfshin të gjithë elementet përbërës të trafikimit (rekrutimin, transportimin, transferimin, etj) si dhe mënyrat (nënshtrimin, forcën, kërcënimin, etj), ndërkohë që bindja dhe pranimi nga ana e viktimës nuk merren në konsideratë.

Neni 1 i këtij dokumenti thotë:
Çdo shtet anëtar do të marrë masat e nevojshme për të bërë të sigurt që aktet e mëposhtëme të jenë të dënueshme:

Rekrutimi, transportimi, transferimi, mbajtja në ngujim me qëllim përcjelljen përtej kufirit si dhe pritjen pasuese në vendin fqinj të një personi, duke perfshirë shkëmbimin, transferimin apo survejimin e atij personi, ku:

është ushtruar dhunë, forcë apo kërcënim, duke përfshirë rrëmbim me forcë, apo, është ushtruar mashtrim apo gënjim, apo ka pasur një abuzim autoriteti apo përfitim nga të qenit pa përkrahje (pambrojtje) situatë kjo që e ka detyruar viktimën të mos ketë alternativë tjetër të pranueshme përveç asaj të nënshtrimit pa kushte, apo janë dhënë ose marre rryshfete ose pagesa për të rënë dakord për një person (abuzuesin) që të këtë nën kontroll një person tjetër (viktimën) me qëllim keqpërdorimin e punës apo shërbimeve të kryera nga ai person, duke perfshirë të paktën punë apo shërbime të detyruara apo të imponuara, skllavëri apo praktika të ngjashme me skllavërinë dhe punën e forcuar.. apo me qëllim të prostituimin apo të tjera forma të keqtrajtimit seksual, përfshirë këtu edhe pornografinë.

2. *Pranimi nga ana e një viktime të trafikuar për t'u dhunuar - qoftë ky dhunim i kryer apo i mbetur në tentativë - nuk do të merret parasysh në rast se janë përdorur aktet e lartpermendura në paragrafin 1.*
3. *Në rastin kur abuzuesi (që ka kryer të paktën një nga aktet e lartpermendura të paragrafit 1) është një minoren, atëhereë rasti do të klasifikohet si "krim trafikimi" edhe në qoftë se asnjë nga aktet e paragrafit 1 nuk është përdorur.*
4. *Për arsye sqarimi nga ana e këtij Vendimi Pune, me termin "minoren" do të kuptohet çdo "person nën moshën 18 vjeç."*

Një viktime në mënyrë të veçantë "e pambrojtur" - viktimë e abuzimit seksual.

Për raste ekstreme specifikohen dënime të rënda, deri në tetë (8) vjet burgim. Një rast i tillë është kur është ushtruar abuzim në dëm të një "*viktime në mënyrë të veçantë të pambrojtur*" me të cilin nënkuptohet një person që " *është nën moshën e pjekurisë seksuale (sipas ligjit të shtetit përkatës) dhe abuzimi është kryer me qëllim prostituimin me 'klientë', apo të tjera forma abuzimi seksual, përfshirë pornografinë*."

Pra, përkufizimi për një viktimë në mënyrë të veçantë "*të pambrojtur*" nuk i përket pa dallim të gjithë personave të trafikuar, ai vendos një moshë limit. Megjithatë në rastet kur kemi të bëjmë me një formë mjaft të rëndë trafikimi për abuzim seksual, dhe duke marrë parasysh dhe keqtrajtimet e shkaktuara nga një dhunë e rëndë që rezulton me pasoja dhe që e ka dëmtuar jashtë mase viktimën, ose kur dhuna në fjalë është ushtruar nga një organizatë kriminale, atëherë rregulli i moshës limit nuk merret parasysh, kështu që dhe ky rast trajtohet si rast i një viktime të "*pambrojtur.*"

Zgjerimi i 'dimensionit' përgjegjësi kriminale - përgjegjësia e personave ligjor

Termi **persona natyrorë** është term ligjor që do të thotë **individë**. Nuk janë vetëm këta që mbajnë përgjegjësi për vepra të dënueshme që kanë të bëjnë me trafikimin e qënieve njerëzore.

Entitetet legale, dhe pa dyjshim personat natyrorë pas tyre, mund të mbahen gjithashtu përgjegjës për këtë vepër penale. Me **person ligjor** (në terminologjinë e këtij vendimi pune) do të nënkuptohet *"çdo entitet që mban këtë status sipas ligjit përkatës, me përjashtim të shteteve apo të tjera bashkësive publike që ushtrojnë autoritetin e një shteti, dhe me përjashtim të organizatave publike."* Organizatat që veprojnë në fushën e të drejtave të njeriut (Human Rights Watch dhe Amnesty International) i propozuan grupit të punës një plan i cili ka të bëjë me pasjen në qendër të vëmendjes të abuzimit me postin (apo inkriminimin) nga zyrtarët e shtetit, policia dhe shërbimet e inteligjencës, propozim i cili nuk u mor parasysh.

Mbi personat ligjor të përfshirë në veprimtari kriminale parashikohet vendosja e sanksioneve të forta si vendosja e gjobave, mbyllje të aktivitetit (strukturës private) të përdorur si bazë për organizimin e aktit kriminal. Diçka tjetër që duhet përmendur përsa i përket rregullave të këtij Vendimi Pune, është se hetimi apo luftimi kundër aktit kriminal nuk varet thjesht nga një akuzë e një personi që është dëmtuar nga ky akt - me fjalë të tjera, akuza e një viktime nuk nënkupton domosdoshmërisht fillimin e hetimeve.

3.1.5 Konventa Europiane Kundër Trafikimit të Qënieve Njerëzore

Këshilli i Europës[25] si një forcë politike që synon promovimin e të drejtave të njeriut, demokracinë dhe shtetin e së drejtës, ka ndërmarrë një sërë inisiativash kundër trafikimit ndër të cilat në mund të përmendim një sërë rekomandimesh me subjekt specifik trafikimin e qënieve njerëzore për qëllime të shfrytëzimit seksual, një plan rajonal për Europën Jug-Lindore, si dhe një sërë trajnimesh dhe projektesh në këtë fushë.

Këshilli i Euorpës miratoi në 3 Maj 2005 **Konventën Europiane Kundër Trafikimit të Qënieve Njerëzore**, një dokument ligjor detyrues për të gjiha vendet anëtare të tij. Hartimi i Konventës Europiane Kundër Trafikimit të Qënieve Njerëzore iu ngarkua një komiteti Ad-Hoc ekspertësh i ngritur për këtë qëllim nga Komiteti i Ministrave.

Ndryshe nga të gjitha instrumentet e tjera të cilat fokusohen në çështjet që kanë të bëjnë me ndjekjen penale të shkaktarëve të trafikimit. Konventa e Re[26] fokusohet "*drejt mbrojtjes së të drejtave të viktimave dhe respektit për të drejtat e njeriut, si dhe synon në të njëjtën kohë vendosjen e një ekuilibri ndërmjet të drejtave të njeriut dhe veprave penale*".

Vlera e shtuar e dokumentit të ri ligjor do të jetë, *inter alia*, njohja e trafikimit si dhunim i të drejtave të njeriut, dhe vendosja e një kuadri ligjor për mbrojtjen dhe ndihmën e viktimave dhe të dëshmimtarëve; vendosja e një mekanizmi efektiv monitorimi dhe harmonizimi i legjislacionit Europian në këtë fushë.

Konventa Europiane Kundër Trafikimit të Qënieve Njerëzore trajton gjithashtu të gjitha format e trafikimit të qënieve njerëzore, (si ato; kombëtare, transnacionale, të lidhura ose jo me krimin e organizuar,) në të gjithashu përfshihen të gjithë personat e trafikuar, të rritur, të rinj dhe minorenë.

Ky instrument europian do të shërbejë si një mekanizëm rajonal plotësues i inisiativave dhe standarteve të Kombeve të Bashkuara për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të njeriut. Ajo bazohet në përkufizimin e trafikimit të qënieve njerëzore që jepet nga Protokolli i Parandalimit të Shtypjes dhe Ndërshkimit të Personave të Trafikuar të Kombeve të Bashkuara.

3.1.6 Europoli

Kompetenca për të luftuar trafikimin e qënieve njerëzore, si dhe keqtrajtimin seksual dhe pornografinë e fëmijëve, i është dhënë, me anë të Konventes se Europolit në 1995, institucionit të Europolit.

Europoli mbështet vendet anëtare të Bashkimit Europian duke:

1. **Lehtësuar shkëmbimin e të dhënave** (personale dhe jo-personale), në përputhje me ligjet vendase.
2. **Siguruar analiza operative** në mbështetje të operacioneve të shteteve anëtare si dhe raporteve strategjike dhe analizave kriminale, në bazë të informacioneve të shërbimeve të inteligjenës dhënë nga shtetet pjesmarrëse e të përpunuara nga Europoli
3. **Dhënë ekspertizë dhe mbështetje teknike** për hetimin dhe mbarëvajtjen e operacioneve të zhvilluar në mbështetje të ligjit nga agjensitë e shteteve pjesmarrëse dhe nën mbikqyrjen dhe përgjegjësinë ligjore të shtetit palë të interesuar.

3.2 KUADRI LIGJOR SHQIPTAR

Një varg konventash ndërkombetare por edhe aktesh të tjera që lidhen me to janë ratifikuar nga Republika e Shqipërisë, nënshkrimi i këtyre instrumentave ndërkombëtare paraqet gjithashtu detyrimin për hartimin e ligjeve kombëtare penale që ndëshkojnë trafikimin e qënieve njerëzore[27].

Ligji nr. 8733 i 24 Janarit të vitit 2001 thotë se "trafikimi i qënieve njerëzore dhe çdo akt që mendohet se është i ngjashëm me trafikimin e qënieve njerëzore do të luftohet dhe dënohet sipas Kodit Penal". Ky ligj paraqet artikuj specifikë që përmbajnë sanksione strikte për trafikimin dhe rrëmbimin.

Aktualisht, legjislacioni shqiptar e parashikon këtë vepër në rrethana më të rënduara, në rastet kur ajo kryhet në bashkëpunim; më shumë se një herë apo kur shoqërohet me dhunë fizike; kur ka sjellë pasoja të rënda për shëndetin apo vdekjen e të dëmtuarit; dhe që nga viti 2004 ligji parashikon këtë vepër penale edhe kur kryhet nëpërmjet shfrytëzimit të funksionit shtetëror ose shërbimit publik. Në këto raste, konsiderohet vepër penale e cilësuar dhe parashikon masa më të rënda dënimi.

Në përqasje me Protokollin e Palermos "Mbi parandalimin, pengimin dhe ndëshkimin e trafikut të personave, veçanërisht të grave dhe fëmijëve", në plotësim të "Konventëes së Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombetar" , i ratifikuar nga Shqiperia[28], në nenin 2 të tij kishte si qëllim me vehte ***"****të parandalojë dhe të luftojë trafikun ndërkombëtar të personave, duke i kushtuar vëmendje të veçantë grave dhe fëmijëve"*, legjislacioni penal shqiptar evoluoi duke i kushtuar një vëmendje të posaçme mbrojtjes së grave dhe fëmijëve nga trafiku.

Në Ligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në Kodin Penal" me 24 Janar 2001, u bënë disa ndryshime mbi veprën penale dhe dënimet në rastin e trafikimit të qënieve njerëzore, trafikimit të femrave për prostitucion, si dhe të trafikimit të fëmijëve për qëlime shfrytëzimi. Në të gjitha rastet, dënimi është më i madh kur viktima është i mitur, kur shfrytëzimi është bërë nga një grup njerezish, për qëllime fitimi, apo kur është perdorur forca, ose kur vepra është kryer në mënyrë të vazhdueshme apo në bashkëpunim me të tjerët, përmes abuzimit të detyrave shtetërore, apo nga organizata kriminale të armatosura.

Kodi penal shqiptar parashikon sanksione "për vepra penale"[29] që lidhen në mënyrë të drejtëpërdrejtë ose tërthorazi me trafikimin e njerëzve, femrave dhe fëmijëve. Këtu përfshihen vepra penale të përmendura më lart si ndihma për kalim të paligjshëm të kufirit, shfrytezimi, financimi dhe dhënia me qera e lokaleve për prostitucion, rrëmbimi i personit si dhe të fëmijës, rrezikimi i jetës së personit duke u shoqëruar me vuajtje të rënda fizike ose psikologjike, rrahje, marrëdhënie seksuale me dhunë, vjedhjen e dokumenteve të identifikimit, falsifikimin e dokumenteve të identifikimit si pasaporta, viza etj.

Me 12 Shkurt 2004, Parlamenti Shqiptar aprovoi me propozim të Këshillit të Ministrave, një ligj, ku bëhen ndryshime dhe shtesa të mëtejshme të Kodit Penal në të gjitha fushat e përmendura më sipër duke përfshirë dhe trafikimin e fëmijëve.

Ky ligj i ri paraqet një përkufizim të ri për veprat penale të trafikimit, sipas Protokollit të Palermos, ku parashikohen dënime më të renda si dhe gjoba për autorët e trafikut si dhe për kalimin e paligjshem të kufirit, si dhe rritet dënimi me një të katërtën për ata individë që ushtrojnë funksione shtetërore.

Sipas Kodit Penal, personat e arrestuar apo të gjykuar për vepra penale të lidhura me trafikimin e lëndëve narkotike, prostitucion, dhe emigrim klandestin , të cilët bashkëpunojnë dhe ndihmojnë për zhvillimin e hetimeve dhe gjykimit ndaj tyre, nuk mund të dënohen me më shumë se gjysma e dënimit maksimal të parashikuar për veprën penale të kryer prej tyre. Përveç këtyre *masave të përgjithshme mbrojtëse* legjislacioni shqiptar ka adoptuar dhe "*masa ta jashtëzakonshme"* Këto masa mbrotjeje u prezantuan në 15 Mars 2004 me adoptimin nga Parlamenti Shqiptar të ligjit Nr.9205 "Mbi Drejtësinë e Bashkëpunëtorëve dhe Mbrojtjen e Dëshmimtarit"[30]
Detajet mbi legjislacionin e ndryshuar janë paraqitur në tabelen e mëposhtëme:

Neni	Vepra Penale	Sanksioni
110/1	Rekrutimi, transporti dhe mbajtja e personave përmes kërcenimit ose forcës, apo nëpërmjet formave të tjera të presionit, ose dhënia apo marrja e pagesës apo përfitimeve të tjera nga një person, i cili kontrollon një tjetër, për qellime shfrytëzimi për prostitucion, apo forma të tjera shfrytëzimi seksual, pune apo shërbime të tjera të detyruara, për qëllime të transplantit të organeve apo të formave të tjera të shfrytëzimit. Organizimi, manaxhimi dhe financimi i trafikut të qënieve njerëzore Në bashkëpunim me të tjerë, ose më shumë se një herë, ose kur shoqërohet me keqtrajtime duke e detyruar viktimën të veprojë përmes përdorimit të dhunës fizike apo psikologjike, ose kur shkakton dëmtime të rënda të shëndetit. Kur shkakton vdekjen e viktimës së trafikut Abuzim të funksioneve shtetërore ose publike	5-15 vjet burgim dhe gjobë prej 2-5 milion lek. 7-15 vjet burg dhe gjobë nga 4-6 milion lek. Jo më pak se 15 vjet burgim dhe gjobë 6-8 milion lek Burg të përjetshëm Një e katërt shtesë e burgimit dhe gjobës
114/a	Shfrytezimi në rrethana rënduese, përfshirja e të miturve, shtytja, shtrëngimi për t'u marrë me prostitucion jashtë shtetit, kryerja në bashkëpunim ose më shumë se një herë, ose e personave të ngarkuar me funksione shteterore e publike.	7-15 vjet burgim
114/b	Rekrutimi, transporti, mbajtja e femrës përmes kërcënimit ose forcës, apo nëpërmjet formave të tjera të presionit, ose dhënia apo marrja e pagesës apo përfitimeve të tjera nga një person, i cili kontrollon një tjetër, për qellime shfrytëzimi për prostitucion, apo forma të tjera shfrytëzimi seksual, pune apo shërbime të tjera të detyruara, për qellime të transplantit të organeve apo të formave të tjera të shfrytezimit. Organizimi, manaxhimi dhe financimi i trafikut të femrave Kur kjo vepër kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë ose shoqërohet me keqtrajtimin dhe detyrimin me dhunë fizike ose psikike të të demtuarës për të kryer veprime të ndryshme ose sjell pasoja të rënda për shendetin e saj Ka sjelle si pasojë vdekjen e personit të trafikuar Abuzim të funksioneve shtetërore ose publike	7-15 vjet burg dhe gjobe nga 3-5 milion lek Burgim 10-15 vjet dhe gjobë nga 5-7 milion lek Jo më pak se 15 vjet burg dhe gjobë nga 6-8 milion lek Jo më pak se 20 vjet burg Një e katërt shtesë e burgimit dhe gjobës

Neni	Vepra Penale	Sanksioni
128/b	Rekrutimi, transporti, strehimi ose marrja e fëmijës, për qëllime shfrytëzimi për prostitucion apo forma të tjera të shfrytezimit seksual, pune apo shërbime të detyruara, forma skllavëruese apo të tjera të ngjashme me të, transplatimi i organeve, si dhe çdo formë tjetër shfrytëzimi. Organizimi, manaxhimi dhe financimi i trafikut të fëmijëve Në bashkëpunim, ose më shumë se një here, ose shoqërohet me keqtrajtimin ose detyrimin me dhunë fizike ose psikike të të demtuarit si dhe kur ka sjellë pasoja të rënda për shendetin e fëmijës se trafikuar. Ka sjellë si pasojë vdekjen e fëmijës Abuzim të funksioneve shtetërore ose publike	7-15 vjet burg dhe gjobë nga 4-6 milion lek 10-20 vjet burg dhe gjobë nga 6-8 milion lek Jo më pak se 15 vjet burg dhe gjobë nga 6-8 milion lek Jo me pak se 20 vjet burg dhe gjobë nga 8-10 milion lek Një e katërt shtesë e burgimit dhe gjobës
297	Kalimi i paligjshem i kufirit shtetëror	Gjobë ose burgim deri në 2 vjet.
298	Dhënia e ndihmës për kalimin e paligjshem të kufirit nëpërmjet vënies në dispozicion ose përdorimi i mjeteve të lundrimit, të fluturimit apo i mjeteve të tjera për të ndihmuar kalimin e paligjshëm të kufirit Dhënia e ndihmës për kalimin e paligjshem të kufirit me qëllim fitimi. Në bashkëpunim, ose më shumë se një herë duke shkaktuar dëmtime serioze Kur shkakton vdekjen Abuzim të funksioneve shtetërore ose publike	1-4 vjet burg dhe gjobë 3-6 milion lek 3-7 vjet burgim dhe gjobë 3-6 milion lek 5-10 vjet burgim dhe gjobë 6-8 million lek Jo më pak se 15 vjet burg dhe gjobë 8-10 million lek Një e katërt shtesëe e burgimit dhe gjobës
109	Rrëmbimi ose mbajtja peng e personit me qëllim për të fituar pasuri ose çdo lloj perfitimi tjetër, për të pergatitur krijimin e kushteve për kryerjen e një krimi, për të ndihmuar autorët ose bashkëpunëtorët në largimin nga vendi i ngjarjes, për t`iu shmangur dënimit, për të detyruar realizimin e kërkesave a kushteve të caktuara për qellime politike ose çdo qëllim tjetër. Rrëmbimi ose mbajtja peng e fëmijës nën 14 vjeç Rrëmbimi ose mbajtja peng e personit ose e fëmijës nën 14 vjeç i paraprirë ose i shoqëruar me tortura fizike ose psikike, kur është kryer kundër disa personave ose më shumë se një herë. Kur është shkaktuar vdekja e personit	10-20 vjet burgim Jo më pak se 15 vjet burgim . Jo më pak se 20 vjet burgim . Burgim të përjetshëm

3.3 STRATEGJITË KOMBËTARE NË LUFTËN KUNDËR TRAFIKIMIT TË QËNIEVE NJERËZORE.

3.3.1 Strategjia Kombëtare për Luftën Kundër Trafikut të Qënieve Njerëzore, 2001-2004.

Në Dhjetor 2001, Qeveria Shqiptare, duke e konsideruar luftën kundër trafikut të qënieve njerëzore dhe të gjithë formave të tij si një prioritet shqiptar dhe ndërkombëtar, aprovoi Strategjinë Kombëtare për Luftën Kundër Trafikut të Qënieve Njerëzore; 2001-2004, e hartuar nga strukturat qeveritare në bashkëpunim me OJF-të lokale dhe organizatat ndërkombetare që punojnë në fushën e anti-trafikut.

Strategjia Kombëtare përfshin objektiva dhe specifika në programe afatshkurtra dhe afatmesme në fushat e parandalimit dhe mbrojtjes, ndjekjes penale dhe dënimit të trafikanteve (si dhe reformat e duhura ligjore) si dhe fushatat e ndërgjegjesimit dhe masat sociale dhe institucionale për strehimin dhe riintegrimin afatgjatë të viktimave të trafikut.

Strategjia dhe masat e marra në këtë kuadër njohin për herë të parë dimensionin human, social, ligjor dhe kompleksitetin institucional për luftën kundër trafikut të grave, vajzave dhe fëmijëve dhe riintegrimin e tyre, si dhe rëndësinë e zhvillimit social dhe ekonomik, uljen e varferisë dhe dhënien e mundësive të barabarta për të gjithë qytetarët shqiptarë për të bërë të mundur shfarosjen e këtij fenomeni.

Gjithashtu në këtë Strategji konstatohet se lufta kundër trafikut të qënieve njerëzore kërkon një angazhim jo vetëm të institucioneve shtetërore, por edhe të organizatave ndërkombetare dhe OJF-ve, që ofrojnë kapaciete dhe eksperiencë unike në këtë fushë. Një nga arritjet më të fuqishme të Strategjisë është dhe institucionalizimi në një nivel më të lartë të bashkepunimit me OJF-të dhe organizatat ndërkombetare që operojnë në Shqipëri, si dhe përmirësimi i bashkepunimit dhe iniciativave të dyanëshme me institucionet qeveritare dhe jo-qeveritare të vendeve të rajonit.

Misioni i strategjisë është përcaktimi i drejtimeve kryesore të punës për realizimin e parandalimit e ndërprerjes së trafikimit të qenieve njerëzore, për mbrojtjen dhe ndihmën ndaj viktimave të trafikut si dhe për krijimin e kushteve për riintegrimin e tyre në shoqëri.

Objektivat e strategjisë

Objektivat e strategjisë kombëtare të luftës kundër trafikut të qenieve njerëzore janë të lidhura me misionin dhe qëllimin e hartimit të saj. Objektivat kryesore janë:

1. Plotësimi i kuadrit ligjor të nevojshëm.
2. Ndryshimet institucionale, strukturore, organizative, krijimi i komitetit të luftës kundër trafikut të qënieve njerëzore pranë kryeministrit.
3. Përmirësim i kushteve sociale dhe ulja e nivelit të varfërisë.
4. Rritja e kujdesit për viktimat e trafikut dhe programet për riintegrimin e tyre.
5. Forcimi i bashkëpunimit midis institucioneve brenda vendit dhe me policitë e vendeve rajonale e të intëresuara për këtë problem.
6. Rritja e ndërgjegjësimit të publikut.

3.3.2 Strategjia Kombetare Kundër Trafikimit të Fëmijëve dhe Mbrojtjes së Fëmijëve Viktima të Trafikut[31]

Strategjia për Luftën Kundër Trafikut të Fëmijëve ka si qëllim përshpejtimin e iniciativave të ndërmarra për të ulur dhe ndaluar fenomenin e trafikut të fëmijëve në Shqipëri, duke intensifikuar dhe koordinuar aktivitetet e të gjithë institucioneve qeveritare, partnerëve ndërkombetare, OJF-ve vendase dhe huaja përmes përmbushjes së objektivave, detyrave dhe afateve kohore bashkangjitur në Planin e Punës për një periudhë 2 vjeçare (2004-2006)

Në këtë Strategji dhe Plan Pune i është vënë prioritet identifikimit dhe ndjekjes penale të trafikantëve dhe organizatorëve përmes rritjes së përpjekjeve të forcave policore në vend dhe përgjatë kufijve, si dhe masave që do të merren për fëmijët, që janë në rrezik ose që janë trafikuar, për t'i ofruar atyre ndihmë mjeksore, psikologjike, sociale dhe ekonomike.

Në këtë këndvështrim, Strategjia Kombëtare Kundër Trafikimit të Fëmijëve dhe Mbrojtjes së Fëmijëve Viktima të Trafikut, nuk parashikon vetëm masat për një strehim të përkohshëm dhe ngritjes së kapaciteteve për institucionet dhe punonjësit socialë, por edhe rehabilitimin afatgjatë dhe integrimin, si ndihmën familjare, zhvillimin e shërbimeve të përkujdesjes dhe adoptimit, të bazuara në të drejtën që ka çdo fëmijë për të patur dhe për t'u rritur në një familje.

Gjithashtu në këtë Strategji janë parashikuar masa në lidhje me braktisjen e shkollës, punën e paligjshme për fëmijët, uljen e varfërisë dhe nevojat për trajnime profesionale, si alternativa për të ulur emigracionin e paligjshëm, trafikimin dhe ri-trafikimin.

Kjo Strategji parashikon krijimin e një strukture të vecantë në nivel prefekture për të koordinuar dhe monitoruar parandalimin e trafikut të fëmijëve, mbrojtjen dhe rehabilitimin, arsimimin, shërbimin sheëdetësor dhe social, punën policore, ndjekjen penale dhe punonjësit e pushtetit lokal. Në këtë Strategji inkurajohet edhe ngritja e partneritetit në nivel lokal të strukturave qeveritare dhe jo-qeveritare me partnerët lokal për të zbatuar objektivat e parashikuara në planin e punës.

Struktura e Planit të Punës të Luftës Kundër Trafikut të Fëmijëve

Plani i Punës është hartuar sipas një strukture me pesë pika e cila është rënë dakort me partnerët vendas dhe ata ndërkombëtarë:
Parandalimi - përfshihet forcimi i ligjit dhe rritja e kontrollit të kufijve, rritja e ndërgjegjesimit, edukimi dhe informimi, si dhe trajnimi në nivel lokal dhe kombëtar, duke u fokusuar në komunitetet më vulnerabël;
Mbrojtja dhe riintegrimi i fëmijëve viktima të trafikut - ku përfshihet kuadri ligjor, forcat policore, ndjekja penale dhe proçedurat ligjore;
Kthimi vullnetar i asistuar - bazohet mbi praktikat më të mira për identifikimin, mbrojtjen, dhe kthimin e fëmijëve në vendin e origjinës.
Koordinimi i aktorëve- atyre kombëtarë dhe nderkombëtarë, qeveritarë dhe jo-qeveritarë, në nivel qendror dhe lokal.

4 ROLI I PROFESIONISTËVE TË SHËRBIMEVE PSIKO-SOCIALE DHE ÇËSHTJE ETIKE NË PUNËN ME GRATË/VAJZAT DHE FËMIJËT VIKTIMA TË TRAFIKIMIT

4.1 ROLI I PROFESIONISTËVE TË SHËRBIMEVE PSIKO-SOCIALE

Profesionistët e fushave psikologjike dhe sociale mund të luajnë një sërë rolesh në parandalimin e fenomenit të trafikimit, ndërgjegjësimin e opinionit publik, fuqizimin dhe riintegrimin e grave/vajzave dhe fëmijëve viktima të trafikut të qënieve njerëzore.

Asistenca për gratë/vajzat dhe fëmijët viktima të trafikimit duhet të marrë formën e një vazhdimësie shërbimesh që përmirësojnë pavarësinë e tyre ekonomike, psikologjike dhe nxisin riintegrimin dhe fuqizimin e mëtejshëm të tyre.

Strehëzat për gratë/vajzat viktima të trafikimit ofrojnë mbrojtje të përkohshme, ato ofrojnë një mjedis të sigurt ku ato mund të mësojnë se abuzimi dhe shfrytëzimi që ato kanë vuajtur nuk ka qenë i shkaktuar nga dështimet e tyre. Strehëzat gjithshtu i ndihmojnë ato të kenë më shumë besim në aftësitë e tyre dhe kurajo për të jetuar vetëm larg dhunuesve dhe shfrytëzuesve të tyre.

Në këto situata gratë/vajzat viktima të trafikimit kanë nevojë për:

1. këshillim ligjor në lidhje me çështjet e trafikimit (kriminale ose civile)
2. strehim të sigurt të përkohshëm,
3. asistencë psikologjike, mjekësore dhe sociale siç mund të jetë e nevojshme për të siguruar nevojat e tyre.
4. edukim dhe trajnim që të mund të gjejnë punësim të përhershëm.

Gjatë viteve të fundit, në Shqipëri është zhvilluar një rrjet shërbimesh në mjedise private dhe publike për trajtimin e çështjeve dhe problemeve që lidhen me trafikimin e qënieve njerëzore. Koalicionet bazë po luajnë një rol të rëndësishëm në ofrimin e shërbimeve. Këto koalicione janë bërë gjithashtu instrumenta të nxitjes të hartimit dhe përmirësimit të strategjive dhe politikave qeveritare në fushën e parandalimit dhe trajtimit të problemeve lidhur me trafikimin e grave/vajzave dhe fëmijëve. Punonjësit psiko-socialë punojnë në institucionet qeveritare, organizatat ndërkombëtare dhe organizatat jo fitimprurëse për vlerësimin e nevojave, propozimin dhe hartimin e politikave qeveritare dhe ndërmarrjen e inisiativave për mbrojtjen e grave/vajzave dhe fëmijve viktima të trafikut, si dhe për të parandaluar zhvillimin e mëtejshëm të trafikut të qënieve njerëzore.

Si punonjës socialë ata mund të lidhin klientët (gratë/vajzat dhe fëmijët viktima të trafikimit) me burimet e nevojitura, kjo arrihet nëpërmjet vlerësimit dhe identifikimit të nevojave dhe gjetjes së burimeve mbështetëse për to[32].

Si këshillues ata vlerësojnë problemet e klientëve të tyre në marëdhënie me mjedisin, faktorët kulturorë dhe eksperiencën e tyre, dhe së bashku me klientin mund të zhvillojnë dhe zbatojnë një plan të përshtatshëm terapeutik.

Si ndërmjetësues, ata bëjnë të mundur arritjen e marëveshjeve dhe mirëkuptimit ndërmjet klientëve të tyre (viktima të trafikimit) dhe të tjerëve (familjeve të tyre, miqve, insitucioneve, etj...) Si edukatorë ata instruktojnë dhe modelojnë sjellje të përshtatëshme shoqërore dhe si avokatë ata monitorojnë të drejtat e klientëve të tyre.

Ata gjithashtu duhet të zotërojnë shprehi të shkëlqyera të organizimit, administrimit dhe bashkërendimit të punës, duke vendosur marëdhënie me organizata dhe agjensi të tjera, si; shërbime komunitare, qendra të formimit profesional, etj. Punonjësit psikosocilaë duhet të dinë të përdorin funksione të tilla si; referimit, menaxhimi i rastit dhe advokacia.

Megjithëse të gjitha funksionet e punës sociale janë të rëndësishme, advkacia është një fushë në të cilën punonjësit socialë duhet të përfshihen patjetër, veçanërisht në drejtim të fenomenti të trafikimit të grave/vajzave dhe fëmijëve. Me trajnimin e tyre të veçantë dhe fokusimin tek personi-në-mjedis, punonjësit social janë në gjëndje të pozicionojnë fenomenin e trafikimit të qënieve njerëzore brenda kontekstit të madh social dhe të bëjnë advokaci në nivel kombëtar për politikat që fuqizojnë në të vërtetë të gjithë gratë/vajzat dhe fëmijët viktima të trafikut.

4.2 ETIKA E PROFESIONISTËVE TË SHËRBIMEVE PSIKO-SOCIALE NË PUNËN ME GRATË, VAJZAT DHE FËMIJËT VIKTIMA TË TRAFIKIMIT[33]

Etika në thelb është një tërësi parimesh morale të përvetësuara nga profesionistët e fushës psikosociale me qëllimin e vetëm që të garantojnë dhënien e shërbimeve të drejta dhe të sakta. Termat *"etikë", "moral", "ligj", "vlerë" "standarte të sjelljes profesionale", "profesionalizëm"* hasen shpesh në shërbimet për personat e mbijetuar nga trafikimi i qënieve njerëzore. Qartësia e këshilluesit mbi domethënien e tyre në praktikën e punës me personat e mbijetuar nga trafikimi i qënieve njerëzore është e domosdoshme. Fjalët që përqasen më shumë dhe përdoren më dendur në vend të njëra tjetrës janë "*vlerë*" dhe "*etikë*". "*Vlera*" shpesh nënkupton një sjellje të mirë, të dëshirueshme, ndërsa "*etika*" diçka rë drejtë dhe të saktë. Çështjet etike në profesionet e ndihmës për njerëzit rregullohen si me ligje ashtu edhe me kode etike.Ato janë udhërrëfyes për punën e këshilluesit, por asnjë prej tyre asnjëherë nuk mund të japë një përgjigje të prerë se çfarë është më e mira për klientët.

Praktikat etike dhe kërkesat ligjore në shërbimet sociale në Shqipëri janë përvijuar tashmë. Kodi Etik i Shërbimeve Sociale të Shoqatës Kombëtare të Punonjësve Socialë është një dokument që po përkrahet gjithnjë e më shumë prej punonjësve të shërbimeve sociale.

Shërbimet sociale e psikologjike për personat që u kanë mbijetuar pasojave të trafikimit të qënieve njerëzore synojnë të plotësojnë nevojat imediate të tyre. Sjellja etike, në thelb, është siguri në të qenurit i drejtë me klientin, siguri e cila buron nga aftësia për të kombinuar cilësitë personale dhe profesionale ngjatë dhënies së ndihmës për këtë grup në nevojë. Kjo arrihet kur këshilluesi ka:

1 Njohuri të mjaftueshme, aftësi për të gjykuar dhe shprehitë e domosdoshme që mundësojnë ndërhyrjen në sjelljen e klientit vulnerabël.

2 Qytetarinë dhe humanizmin për të respektuar dinjitetin njerëzor dhe lirinë e klientit.
3 Fuqinë e duhur për të ndërhyrë dhe është në gjëndje të mbajë përgjegjësinë e përdorimit të fuqisë së tij në mënyrë të drejtë.
4 Aftësinë të respektojë veten dhe të tjerët në profesion në mënyrë të atillë që të inkurajojë besimin e komunitetit në shërbimet psikologjike dhe sociale.

Të këshillosh, të ndryshosh mënyrën e të menduarit, konceptin për veten, tërësinë e shprehive të vetëvlerësimit dhe të vetëefikasitetit, të lartosh sjelljen njerëzore të klientëve, do të thotë të mbështesh fort në njohuritë mbi natyrën dhe karakteristikat tipologjike të sjelljes. Të këshillosh do të thotë të respektosh karakteristikat psikologjike, gjinore, moshore, karakteristikat kulturore të klientëve. Nëse në këshillim injorohet nevoja për të respektuar karakteristikat e zhvillimit të klientit, gjasat për ta indoktrinuar klientin janë shumë të mëdha. Këshillimi që nuk njeh moshën dhe dinamikën e zhvillimit ka të ngjarë të jetë predikues, moralizues dhe i padrejtë.

Një profesionist në fushën sociale dhe psikologjike në punën e tij me gratë/vajzat dhe fëmijët viktima të trafikut të qënieve njerëzore duhet të:

- Marrë në konsideratë faktin që gratë/vajzat dhe fëmijët viktima të trafikut të qënieve njerëzore gëzojnë të drejtën e respektit (respektin për mirqënie fizike, intelektuale, sociale dhe emocionale).
- Respektojë kulturën, besimin fetar dhe përkatësinë etnike të të gjithë njerëzve me të cilët ai punon, pavarsisht sesa të ndryshëm janë ata nga ai vetë.
- Të bëhet shembull i mirësjelljes për të tjerët.
- Në rastin kur punon me fëmijë, të sigurohet që gjatë zhvillimit të aktiviteteve me fëmijët dhe të rinjtë të jenë të pranishëm më shumë sesa një i rritur, apo të sigurojë që aktivitetet e organizuara të mund shihen dhe të dëgjohen edhe nga ndonjë kënd tjetër.
- Respektojë të drejtën e klientit për jetë private.
- Krijojë një mjedis mirëbesimi, ku klienti të mund të kundërshtojë pikpamjet dhe sjelljet me të cilat nuk pajtohet.
- Kundërshtojë sjelljet e papërshtatëshme të klientit.
- Respektojë dyshimet apo deklarimet për abuzime.
- Të ketë parasysh faktin që disa veprime mund të keqinterpretohen sado mirë që të jenë të menduara ato.
- Të veprojë në përputhje me kodin e etikës të organizatës për të cilën ai punon.
- Të kërkojë këshilla për shqetësimet që ai mund të ketë lidhur me sjelljen e ndonjë të rrituri ndaj fëmijëve viktima të trafikimit.
- Të sigurohet që klienti ka njohuri për personat kujdestarë (shembull këshilluesit, punonjësit social, ofruesit e shërbimeve sociale) me të cilët ai mund të ndajë shqetësimet e tij si dhe mund t'u drejtohet atyre për të biseduar për çështjet që i mundojnë.

Një profesionist në fushën sociale dhe psikologjike në puën e tij me gratë/vajzat dhe fëmijët viktima të trafikut të qënieve njerëzore nuk duhet të:

- Zhvillojë komunikim të papërshtatshëm me gratë, vajzat dhe fëmijët viktima të trafikimit.
- Zhvillojë afrueshmëri fizike të papërshtatshme me klientin.
- Lejojë që të gjendet në situatë të papërshtatëshme apo të zhvillojë sjellje të tilla që tërheqin vëmendjen.
- Japë vërejtje apo shfaq veprime përçmuese ndaj klientit.
- Japë konkluzione për të tjerët para verifikimit të provave.
- Ekzagjerojë apo të marrë si të parëndësishme çështjet që kanë të bëjnë me keqtrajtimin e klientëve.
- Tregojë parapëlqimet personale ndaj individëve të caktuar.
- Mbështetet në emrin (në faktin që njihet për punë të mirë) apo në punën personale për t'u mbrojtur.
- Mendojë "kjo nuk mund të më ndodhë mua."
- Përfitojë nga rasti, kur mendimi i përgjithshëm, linja e veprimit apo praktika i sugjeron një veprim më të matur.

4.2.1 E drejta e klientit për informim

Këshilluesi që kërkon të japë një shërbim të drejtë, etik dhe ligjor, duhet ta mbështesë punën e tij në një njohje të mirë të të drejtave të klientëve. Kjo është veçanërisht e rëndësishme kur punohet me fëmijët dhe të rinjtë[34].

E drejta primare që reflektohet në këshillim është e drejta për t'u informuar për atë që do të ndodhë në këshillim. Vetëm pasi të jetë informuar klienti do të jetë në gjëndje të marrë vendime. Gabimet më të rëndomta që mund të bëhen gjatë informimit të klientit janë:

1. Këshilluesi nuk e informon klientin duke besuar se ai ka aftësinë ta përpunojë informacionin dhe të marrë vendimet më të mira për veten mbi bazën e tij.

2. Këshilluesi mund të komunikojë vëtëm një pjesë të informacionit gjë që shpeshherë çon në manipulimin e klientit. Manipulimi përmes keqinformimi apo mosinformimit është etikisht i dëmshëm dhe mund të sjellë pasoja varësie të përherëshme tek klienti.

3. Këshilluesi mendon se detyra e tij qëndron vetëm tek informimi pa u kujdesur për fatin e informacionit. Ndaj para se të vendosë përzgjedhjen e informacionit që do t'i jepet klientit, këshilluesi duhet të gjykojë mbi kapacitetin e klientit për të përpunuar informacionin, mbi aftësinë e tij për ta kuptuar informacionin, mbi aftësinë e tij për të marrë vendime të pavaruar me informacionin e marrë.

4. Në praktika të korrekte pune këshilluesi duhet të dokumentojë informacionin e dhënë.

4.2.2 Çështje të konfidencialitetit në këshillim

Konfidencialiteti është një nga çështjet etike më të rëndësishme në këshillim. Kur ai është i pranishëm mund të çojë në një ndryshim të shpejtë dhe të sigurtë të klientit; kur ai është i dyshimtë klienti mund të hermetizohet dhe të fosilizojë përjetë problemin e tij për shkak të gjëndjeve të reja të varësisë apo disfunksioneve të tjera. Në dukje, konfidencialiteti mund të perifrazohet shumë thjeshtë, gjithshka që thuhet në mjediset e këshillimit është tërësisht konfidenciale dhe këshilluesi nuk ka të drejtën për ta thyer konfidencialitetin, për të nxjerrë tek të tretët të vërtetën e mësuar në këshillim.

Që në fillim të këshillimit klientit duhet t'i bëhet e qartë se cilat janë kushtet e konfidencialitetit. Përgjithësisht këshilluesi garanton klientin se do të ruajë konfidencialitetin pavarsisht nga rrethanat imponuese, jo shtrënguese të thyerjes së tij. Kjo do të thotë se kur klienti rrëfen informacionin privat, këshilluesi e ruan atë për qëllimin që u rrëfye. Megjithatë ekzistojnë disa situata në të cilat këshilluesi duhet ta thyejë konfidencialitetin, sidomos kur duhet të paralajmërojë dhe të mbrojë persona të tretë. Gjithsesi, sa herë që këshilluesi mendon se duhet thyer konfidencialiteti, ai ia bën të qartë këtë qëllim klientit dhe e inkurajon atë të marrë pjesë në rrëfimin e së vërtetës.

Konfidencialiteti thyhet kur:

1 Vihet në rrezik jeta e vetë klientit apo e të tretëve.
2 Klienti lejon vetë që informacioni i mbledhur gjatë këshillimit t'u jepet të tretëve.
3 Në rastet kur gjyqi i kërkon këshilluesit të paraqesë të dhëna që të mbrojë veten e tij në gjyq në rast padie nga klienti për çështje të lidhura me këshillimi.

Kjo është një tablo e detyrimit të këshilluesit për të respektuar konfidencialitetin e klientit. Megjithatë shpeshherë tek këshilluesit vihet re nevoja e diskutimit të rasteve të veçanta me pjestarë të familjeve të tyre apo kolegë të punës. Këshilluesi ka nevojë të reflektjë e të rrëfehet, kjo vjen si pasojë e ngarkesave emocionale dhe psikologjike që ai mund të mbart nga diskutimi me klientin e tij. Këshilluesi e ndjen shumë nevojën të nxjerrë nga vetja atë çka ka akumuluar gjatë këshilimit, ndaj supervizorët e qendrave të këshillimit mendojnë për skema të asistencës profesionale për këshilluesit. Ajo që këshillohet është që supervizorët të ngrenë skema të realizimit të "*debrifing*" seanca të shkurtra gjatë të cilave këshilluesi nuk rrëfen raste, por atë çka ndodhi me të, me veten e tij, gjatë punës me rastet. Seanca të tilla ndihmojnë në spastrimin e rëndesave të ditës dhe në minimizimin e stresit, mënjanimin e konsumimit profesional dhe ngritjen e protokolleve etike të këshillimit.

Me qëllim ruajtjen e konfidencialitetit dhe sigurimin e cilësisë në shërbim, këshilluesi nuk duhet të harrojë:

1 Përgjegjësitë profesionale,
2 Detyrimin për të parandaluar dhe mbrojtur jetën e të gjithë aktorëve të përfshirë në skemën e këshillimit,
3 Rrezikun e keqtrajtimit të fëmijëve, të abuzimit fizik, emocional, psikik,
4 Rrezikun e inkurajimit të varfërisë,

Rrezikun e dyzimit të marëdhënieve me fëmijët, të plotësimit të nevojave personale me sjelljet e tyre.

Çështje të shërbimit konfidencial bëhen edhe më të vështira nëse do të kemi parasysh se shpeshherë këshilluesit promovojnë punën dhe këshillimin në grup.

Risku etik buron nga situatat kur ai nënvlerëson aspekte të tilla si:

1 Dinamikën e formimit të grupit,
2 Konfidencialitetin në grup,
3 Marëdhëniet personale brenda grupit,
4 Mundësinë e abuzimit me teknikat e këshillimit në grup,
5 Mundësinë e abuzimit me pavarsinë e anëtarëve të grupit.

5 E KALUARA E VIKTIMAVE DHE FAKTORËT PËRCAKTUES

5.1 PREJARDHJA FAMILJARE

Jeta emocionale e një individi ka themelet dhe rrënjët e veta në marrëdhëniet që ai\ajo ka pasur me prindërit e tij\saj dhe anëtarët e tjerë të familjes, si gjatë fëmijërisë ashtu edhe gjatë jetës si i rritur.

Background-i i familjes përsa i përket fëmijërisë dhe adoleshencës që shpesh kalohet në mjedise frustruese dhe refuzuese, ndikon në mirëqënien bio-psikologjike të një personi. Kështu që për të kuptuar më mirë perspektivën psikologjike të viktimave të trafikimit ne nuk duhet t'i drejtohemi vetëm traumës që ata kanë kaluar në duart e trafikuesve, por gjithashtu duhet të marrim parasysh marrëdhëniet e tyre në të shkuarën dhe të tashmen me anëtarët e familjes.

Duke u bazuar në studimet mbi "teorinë e atashimit të zhvillimit", eksperienca e humbjes, deprivimit, neglizhimit, apo abuzimit ndikon në zhvillimin emocional të fëmijës dhe ka efekte afatgjata në kapacitetin e individit për të ndërtuar marrëdhënie të sigurta dhe të kënaqshme, dhe gjithashtu në vetëvlerësimin dhe vetëbesimin e tij\saj. Kur një prind, që përfaqëson personin më të rëndësishëm për një fëmijë, tregon kujdes për individualitetin dhe dinjitetin e fëmijës, fëmija ndjehet i vlerësuar dhe respektuar. Ai\ajo zhvillon vetëvlerësimin, autonominë dhe mëson të kontrollojë veprimet e veta dhe të shprehë këndvështrimin e tij. Në anën tjetër, cdo paqëndrueshmëri domethënëse në marrëdhëniet kujdes-dhënëse: qoftë kjo distancë fizike, modele të gabuara të sjelljes prindërore, apo abuzim fizik ose emocional mund të ndërhyjë në ndjenjat e besimit dhe sigurisë së individit, duke rritur potencialisht ankthin dhe\ose probleme të tjera psikologjike gjatë fëmijërisë së vonë ose dekada më vonë në jetë.

Zbulimet tregojnë se shumica e viktimave të trafikimit vijnë nga familje me marrëdhënie të vështira dhe abuzuese mes anëtarëve të familjes. Të rritesh në një ambient abuziv, me dhunë dhe konflikte mes pjesëtarëve të familjes, i bën viktimat e ardhshme të trafikimit vulnerabël dhe të paqëndrueshëm emocionalisht. Me kalimin e viteve, ata kanë akumuluar frustracion dhe tension brenda vetes dhe nuk kanë mësuar mënyra se si t'i shprehin këto ndjenja. Një background i tillë i vështirë gjithashtu i bën viktimat e trafikimit më të lehta për tu kontrolluar dhe mashtruar, dhe kjo i bën ata më të prirur për të qënë të detyruar apo joshur drejt trafikimit. Trafikuesit duket sikur i'u japin atyre një "*mundësi*", dhe në këtë situatë, viktimat e ardhshme të trafikimit dorëzohen, të gatshëm pranojnë këtë "shpëtim" dhe e gjejnë të lehtë të arratisen nga familja e tyre.

Nga intervistat me klientët viktima të trafikimit mësohet se për shumicën momenti i "*rekruitimit*" për trafikim koinçidonte me një krizë të asaj kohe në familje. Skenarët më të zakonshëm të këtyre krizave

familjare janë ato ku viktimat e trafikimit kanë hapur armiqësira: si një zënkë, apo grindje me prindërit e tyre (në rastet kur ato jetojnë akoma në familjen e origjinës) apo kanë qenë të mashtruara, abuzuara dhe të keqtrajtuara nga bashkëshortët e tyre (në rastet kur janë të martuara). Momenti i rënies apo dorëzimit, kur vendimi për të shkuar jashtë është duke u marrë-koinçidon me situatat në të cilat nivelet e mashtrimit, zemërimit, dhe pasigurisë janë më të lartat.

5.2 MUNGESAT SOCIAL EKONOMIKE

Përveç faktorëve familjarë, shumica e gjërë e grave dhe fëmijëve të trafikuar gjithashtu kanë një background vështirësish financiare, duke qënë se ata vijnë nga zona me standarte të varfra ekonomike dhe sociale. Statistikat tregojnë se gratë të cilat përfundojnë të përfshira në trafikim ishin të pakënaqura me statusin e tyre ekonomik dhe dëshironin ta përmirësonin atë, shpesh pa menduar për mjetet.

Për shkak të situatës së tyre të vështirë ekonomike në shtëpi, pa një vend pune të stabilizuar dhe vetëm me të ardhura rastësore, niveli i pasigurisë për të ardhmen bëhet shumë i lartë. Mungesa e zgjidheve të parashikueshme për problemet e tyre financiare i shtyn viktimat e trafikimit të marrin vendime impulsive me qëllimin e vetëm që të arratisen nga një situatë e tillë. Nën këto rrethana, vendimet që merr gruaja nuk janë menduar mirë dhe pozita e tyre vulnerabël I bën ato më lehtë të influencuesme dhe të manipulueshme.

Kur viktimat e trafikimit kthehen në vendin e tyre të origjinës, është kritike që të veprohet për të parandaluar situata të tilla të ngjashme me ato që i shtyjnë të largohen. Për këtë arsye trainimet e punësimit dhe asisteca për gjetjen e një pune është një tjetër komponent kyç i programeve të mbrojtjes dhe integrimit për këtë grup shoqëror ulnerabël.

Pas pakësimit të tmerreve të përvojës së trafikimit, viktimat e trafikimit kanë detyrën e vështirë për të mësuar se si t'i bëjnë ballë traumës së tyre. Nëse ato detyrohen që kësaj t'i shtojnë stresin financiar dhe pasigurinë financiare, presioni (dhe\ose motivimi) për tu përpjekur për të kërkuar punë jashtë shtetit mund t'i çojë ato drejt të qënit të ri-trafikuara. Kjo është një nga mënyrat në të cilat trafikimi mund të bëhet një cikël vetë - ripërjetimi, dhe kjo nënvizon rëndësinë për ndryshime sociale, politike dhe ekonomike.

Eksperienca e punës me viktimat e trafikimit ka treguar se pak prej tyre kanë qenë të ndërgjegjshme për rrezikun e të qënit të ngaterruara me një rrjet trafikimi si pasojë e migrimit të jashtëligjshëm. Ky fenomen është dokumentuar saktë vecanërisht me viktimat që janë trafikuar tashmë të paktën një herë.

Kjo kthen vëmëndjen tonë në çështjen e mekanizmave të riintegrimit të disponueshëm nga viktimat e trafikimit sapo ato kthehen në vendin e tyre. Suksesi i programeve të riintegrimit është përqëndrimi total në krijimin dhe ofrimin e mbështetjes më të mirë sociale dhe ekonomike në mjediset e tyre. Nëse viktimat e trafikimit nuk besojnë në mundësitë e një jete më të mirë kur të kthehen në shtëpi, ka pak arsye që ato të dëshirojnë të kthehen dhe pra, të pranojnë asistencën e kthimit dhe rintegrimit.

6 PARANDALIMI I TRAFIKIMIT TË QËNIEVE NJERËZORE

Tashmë është e rëndësishme të pranojmë që ndërrmarja e një aksioni efektiv kundër trafikimit të qënieve njerëzore kërkon mbajtjen e qëndrimeve të integruara dhe gjithëpërfshirëse si në vendet e origjinës, ato të tranzitit dhe të destinacionit. Ndërhyrjet duhet t'i adresohen faktorëve shkaktarë të fenomenit, të rrisin ndërgjegjsimin për risqet ekzistuese si dhe të zhvillojnë masa të përshtatshme asistence dhe mbrojtjeje për viktimat e trafikimit, monitorimin e sistemit të rekrutimit dhe transportit si dhe në të njëjtën kohë monitorimin e kushteve në vendet e destinacionit.

6.1 ÇDO TË THOTË "PARANDALIM"

"*Trafikimi i qënieve njerëzore ka shkaktarët e tij në kushtet social ekonomike të vendeve të origjinës. Për parandalimin, theksi nevojitet të jetë në rigjenerimin ekonomik dhe në nevojën e reduktimit të numrit të njerëzve anëtarë të grupeve vulnerabël nëpërmjet fuqizimit ekonomik*."

Kjo gjë kërkon një analizë të investimeve strategjike dhe marrveshje ristrukturuese, vlerësimin e disponueshmërisë, dhe llojet e punësimit veçanërisht për femrat, si dhe shkallën e diskriminimit. Këta faktorë mund të adresohen, ndër të tjera, duke vendosur dhe zbatuar ligje jo diskriminuese në lidhje me arsimimin, punësimin, aksesin në mundësitë e kreditimit, etj. Grupet vulnerabël duhet të identifikohen dhe të prioritizohen për përfitimin e asistencës ekonomike, në veçanti për minorenët e pambrojtur dhe gratë nga zona me zhvillim të ulët ekonomik"[35].

Termi "*parandalim*" përdoret për të shprehur një varg ndërhyrjesh kundër trafikimit, të cilat mund të ndryshojnë jashtëzakonisht shumë përsa nga përmbajtja, grupet e synuara dhe diapazoni.

Nuk ka formulë për një parandalim efektiv. Kjo është e kuptueshme pasi faktorët e riskut për gratë/vajzat dhe fëmijët e rrezikuar nga trafikimi janë të shumtë dhe dinamikat e trafikimit që çojnë në shfrytëzim janë komplekse. Përcaktimi i grupeve të popullatës më të rrezikuar dhe identifikimi i ndërhyrjeve më efikase janë disa nga vështirësitë kryesore me të cilat përballen specialistët e fushës së trafikimit të qënieve njerëzore. Kërkohet që të kuptohen më mirë faktorët e riskut, dinamika e trafikimit, proçeset e vendim-marrjes së grupeve me shkallë të lartë rrezikshmërie dhe mundësitë që mund t'u jepen atyre si dhe kërkohet një vlerësim sistematik dhe kritik i ndërhyrjeve të bëra deri më sot, me qëllim që të merren masa efektive.

6.2 ROLI I NDËRGJEGJSIMIT NË STRATEGJITË E PARANDALIMIT

Ndërgjegjësimi lidhur me problemin e trafikimit të qënieve njerëzore (grave/vajzave/fëmijëve), i personave përgjegjës për këtë çështje, i të gjithë publikut dhe/ose sektorit që ka kërkesa për të, mund të jetë i rëndësishëm për një strategji të gjithanshme për parandalimin e tij.
Metodat për ndërgjegjësim ndryshojnë në varësi të grupeve për të cilat punohet, për ndikimin që dëshërohet dhe burimet ekzistuese. Ato mund të nisin nga diskutimet në grup, me grupe të vogla individësh e deri tek mjetet e informimit publik me të gjithë publikun e këdo tjetër i përfshirë në të.

Strategji të ndryshme ndërgjegjsimi mund të kenë objektiva të ndryshme të cilat përfshijnë.

1 Pajisjen e grupeve të rriskuar me informacion me qëllim që ata të ndihmohen për të marrë vendime të bazuara në fakte reale (p.sh. lidhur me praktikat e emigracionit të sigurt me qëllim uljen e mundësive për trafikimin e tyre.)
2 Ndërgjegjësimin më të mirë të personave përgjegjës lidhur me përgjegjësitë që kanë ata ndaj grave/vajzave dhe fëmijëve si dhe mekanizmave ligjore dhe institucionale për mbrojtjen e tyre.
3 Ndikimin për të çrrënjosur konceptin e gabuar që ekziston në opinionin publik lidhur me trafikimin dhe nxitjen e njerëzve që të mbështesin dhe pranojnë viktimat e trafikimit.
4 Ndërgjegjësimin e sektorit të industrisë së seksit për kushtet në të cilat mbahen viktimat e trafikimit dhe pasojat kriminale që çojnë në shfrytëzimin e tyre..

6.2.1 Fushatat e informimit publik

Mjetet e komunikimit masiv që përfshijnë televizionin, radion, internetin dhe pllakatet mund të jenë një mjet i dobishëm për shpërndarjen e informacionit mbi trafikimin e qënieve njerëzore në publikun e gjerë. Fushata për informimin e publikut mund të sensiblizojë publikun lidhur me këtë problem, së pari duke e inkurajuar atë që të marrë përgjegjësi për trafikimin e grave/vajzave, fëmijëve, ose duke kërkuar mbrojtje më të madhe të tyre nga komunitetet ku ata bëjnë pjesë dhe/ose duke luftuar heshtjen e tij ndaj shfrytëzimit të qënieve njerëzore. Fushata të tilla duhet të fokusohen në anë të veçanta të problemit dhe ta shikojnë atë nga këndvështrime të ndryshme si; parandalimi i migrimit; parandalimi i dhunës në familje; promovimi i barazisë gjinore; parandalimi i HIV/AIDS, etj.

6.2.2 Si mund të jepen mesazhe për trafikimin[36]

Krijimi i mesazheve lidhur me trafikimin e grave/vajzave dhe fëmijëve lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me kompleksitetin e problemit dhe shkallën e ndjeshmërisë së tij. Të arrish që grupet e rrezikuara të kuptojnë sa duhet faktorët e riskut që nxisin trafikimin e grave/vajzave dhe fëmijëve, dhe nëpërmjet disa këshillave praktike lidhur me atë që mund të bëjnë ata për mbrojtjen e tyre, mund të ndihmojë që ata të njohin problemin dhe të ndjehen më të mbrojtur e të sigurt. Materialet informative duhet të jenë në përshtatje me moshën, gjininë dhe nivelit kulturor të komunitetit ku ata bëjnë pjesë. Është shumë e rëndësishme që:

1 Mesazhet të jenë të qarta dhe të lehta për t'u kuptuar dhe të ndërtohen në vartësi të nivelit kulturor të grupit të synuar.
2 Mesazhet duhet të përmbajnë disa këshilla praktike lidhur me atë se ç'mund të bëjnë grupet e riskuara për t'u vetëmbrojtur.
3 Mesazhet duhet të përmbajnë histori të jetuara.

Materiali i informacionit që përfshin videot, posterat, fletëpalosjet dhe sportet në radio mund të përdoret si pjesë e fushatës për informim dhe/ ose t'i shpërndahet grupeve të interesuara nëpërmjet aktiviteteve, trajnimeve dhe takimeve të ndryshme të drejtpërdrejta me to.

Përfshirja e grave/vajzave dhe fëmijëve në krijimin e mesazheve.

Përfshirja e përfaqësuesve të grupeve të riskuara (gra/vajza dhe fëmijë) në krijimin e mesazheve për trafikimin e qënieve njerëzore përbën në vetvete një veprimtari konkrete ndërgjegjësimi, e cila u jep mundësi atyre të mendojnë për problemet me qëllim që t'i transmetojnë grupeve të tjera të popullatës mesazhe të rëndësishme. Ata mund të përfshihen në hartimin e materialeve informative në mënyra të ndryshme, të cilat përfshijnë:

1 Grupet pilot, duke bërë vërejtje dhe sugjerime si të përpunojet drafti i materialit informativ.
2 Si pjesë e grupit të punës për hartimin dhe prodhimin e materialeve informative.
3 Në pjesmarrjen në konkurset e pikturës apo aktiviteteve të tjera krijuese për të prodhuar materiale informative në mënyrë të pavarur.

Përshirja e përfaqësuesve të grupeve të synuara në hartimin e materialeve informative, kërkon planifikim paraprak, përcaktimin e kohës, burimeve dhe lehtësues me përvojë për këtë proçes.

6.3 METODAT PJESMARRËSE

Përdorimi i metodave pjesmarrëse[37] në kuadër të aktiviteteve edukuese të ndërgjegjësimit nxit të mësuarit aktiv dhe ndihmon në aftësimin e grave/vajzave dhe fëmijëve. Angazhimi i tyre në mënyrë aktive në këtë temë nxit mendimin e tyre kritik lidhur me problemin e trafikimit të qënieve njerëzore si dhe për rolin që mund të luajnë ata për mbrojtjen e tyre dhe komuniteteve ku bëjnë pjesë.

Metodat pjesmarrëse përfshijnë:

1 Metodat verbale: diskutimet, brainstorming, debatet
2 Metodat vizuale: vizatimi, piktura, modelimi, kolazhet, etj.
3 Metodat e performancës: drama/teatri, kërcimi, pantonimat, simulimi i lojës me role, imitimi, loja me role.
4 Metodat e shkruara: të shkruarit krijues, poezia, tregimet kolektive, artikujt.

PROGRAMI "SCREAM Stop Punës së Fëmijëve"

IPEC ka lançuar një nisëm të re për mobilizimin social - edukativ të të rinjve dhe fëmijëve, "SCREAM Stop Punës së Fëmijëve", për të promovuar të kuptuarin dhe sensibilizimin e tyre në lidhje me dukurinë e punës së fëmijëve, në mjediset e të rinjve dhe komunitetit ku ata jetojnë.

SCREAM mbështet mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve nëpërmjet edukimit, artit dhe medias por njëkohësisht pasqyron dhe gjendjen e dhimbshme të fëmijëve që punojnë si dhe nevojën që këta fëmijë të përfaqësohen.

Duke përdorur metoda të reja krijuese, programi SCREAM synon ti informojë të rinjtë për shoqërinë ku jetojnë, t'i informojë për padrejtësitë që ekzistojnë duke përqëndruar vëmendjen e tyre në punën e fëmijëve në botë. Qëllimi është që t'i kthej ata në zëdhënës të fëmijëve që punojnë. Programi synon t'i pajisi të rinjtë me njohuri dhe t'i bëjë të përgjegjshëm duke i ndihmuar të reragojnë në mënyrë të përshtatshme.

Zhvillimi i SCREAM mbështetet shumë në artin pamor, në artin e shkruar dhe artin dramatik. Dramatizimi është një instument veçanërisht i fuqishëm që ndikon tek të rinjtë. Teatri flet me një gjuhë universale që kapërcen kufijt gjeografik dhe pengesat kulturore. Madje në rrjedhën e historisë është përdorur si mjet i kohezionit social. Pra ky program promovon deklamimin, recitimin dhe dramatizimin si mjete të cilat mund t'i përdoren nga të rinjtë për të zbuluar dhe shprehur ndjenjat e tyre si dhe për ti përcjellë mesazhet e tyre komunitetit. Me ndihmën e instrumentave të përshtatshëm për ta, të rinjtë mund të fitojnë besimin për të krijuar dhe vënë në skenë idetë dhe mendimet e tyre në përshtatje me kushtet sociale dhe kulturore të mjedisit ku ata jetojnë.

SCREAM fokusohet në tre fusha veprimi:

1. Krijimi i raporteve të rëndësishme me mjetet e komunikimit kombëtar dhe ndërkombëtar;
2. Zhvillimi i të rinjve nëpërmjet promovimit mbështetjes së pjesëmarrjes së tyre në këtë fushatë;
3. Konsolidimi i bashkëveprimit midis organizatave dhe agjensive të ndryshme.

Të treja këto fusha lidhen midis tyre dhe ndihmojnë njëra tjetrën dhe përbëjnë padyshim një forcë të rëndësishme ndryshimi pasi veprimtaria e tyre e përbashkët gjeneron ndryshime të rëndësishme në sjelljen sociale, pranon përfshirjen aktive të organizatave kombëtare dhe ndërkombëtare, të OJF-ve, të instiucioneve akademike dhe arsimore, për të krijuar një kohezion forcash që sjellin rezultate të qëndrueshme në planin diplomatik dhe politik.

Një element shumë i rëndësishëm është realizimi i të gjithë programit duke nisur nga veprimtaritë sensibilizuese, duke krijuar një përfshirje të fortë emocionale, duke krijuar gjithashtu dëshirën e fortë për të bërë ndryshime dhe për të kaluar më pas në veprim.

Në module të ndryshme trajtohen edhe probleme të abuzimit seksual të fëmijëve. Grupi do të kuptojë se fëmijët që punojnë janë ata që kanë më tepër mundësi të abuzohen seksualisht dhe që shfrytëzimi seksual i fëmijëve është një nga format më të këqija dhe më të dëmshme të punës së fëmijëve.

Disa nga ushtrimet e moduleve që kanë të bëjnë me dramatizimin, shkrimin krijues, vizatimin mund të japin rezultate më pozitive dhe ndihmojnë më mirë të rinjtë të përpunojnë traumat e tyre të kaluara apo të tashme.

Konventat dhe Ligjet ndërkombëtare ndalojnë dhunën seksuale, por jo rrallë janë vetë shoqëritë që mbyllin sytë para këtij krimi. Keqtrajtimi seksual ndodh pas dyerve të mbyllura, në disa raste në shtëpitë e vetë fëmijëve. Duhet të ndryshojë sjellja me qëllim që të këputen vargonjt e rrethit vicioz të keqtrajtimit seksual. Të rinjtë duhet ta dinë se ligji i mbron.

Është shumë e rëndësishme që të gjitha këto veprimtari të pasohen nga diskutime ku të bëhet e qartë ajo çka pjesmarrësit bënë dhe mënyra sesi e realizuan atë kishte për qëllim t'i inkurajonte ata që të reflektonin më thellë dhe të nxiste më tej diskutimin për problemet lidhur me trafikimin.

6.3.1 Edukimi me aftësitë për jetën

Në disa raste dhënia e informacionit rreth faktorëve të riskut të trafikimit, mund të mos mjaftojë për të mbrojtur grupet e riskuara nga trafikimi. Ndihma dhënë grupeve të riskuara forcon mekanizmat e vetëmbrojtjes dhe mund të ndikojë në uljen e masës së rrezikshmërisë për ta. Edukimi me aftësitë për jetën mund të përdoret si strategji vetëmbrojtëse nëpërmjet trajtimit të çështjeve të tilla si:

1 Ndërgjegjësimi për sjellje të rrezikshme
2 Ndërgjegjësimi sesi mund të vlerësohen rreziqet më mirë
3 Ndërgjegjësimi sesi mund të shmangen situatat të cilat mund të të shfrytëzojnë.
4 Ndërgjegjësimi sesi t'i trajtosh marëdhëniet abuzive.
5 Vetëbesimi për të përballuar presionin dhe kërcënimin
6 Ndërgjegjësimi sesi të arrish të vlerësosh veten
7 Ndërgjegjësimi se kujt mund t'i drejtohesh për ndihmë

6.3.2 Strategjitë e të mësuarit të ndërsjelltë

Forumet për ndërgjegjësimin ku shkëmbehen mendimet si workshopet, debatet publike, ekspozitat lëvizëse, dramat dhe mbështetja e komunitetit për trafikimin e grave/vajzave dhe fëmijëve, mund të jenë mënyra efektive për përfshirjen e komunitetit, ku anëtarë të tij kanë mundësi të bëjnë pyetje dhe të diskutojnë më thellë për problemet.

Specialistët mund të përdorin mjedisin e forumeve të tilla për të theksuar idetë që lidhen me tolerancën dhe respektin e ndërsjelltë, për të ndihmuar të rinjtë dhe fëmijët të zhvillojnë aftësitë për jetën dhe të inkurajojnë të menduarit kritik dhe të mësuarit nëpërmjet medias. Specialistët mund të përdorin këto forume edhe për të ndrequr koncepte të gabuara të komunitetit për trafikimin dhe për të gjetur tema që lidhen me shfrytëzimin, çështjet gjinore, pabarazitë ekonomike dhe sociale si dhe të drejtat e njeriut.

6.3.3 Masat me bazë komuniteti

Masat me bazë komuniteti mund të luajnë një rol shumë të rëndësishëm për sugjerimin e strategjive në shumë nivele për trafikimin e qënieve njerëzore. Ato mund të aktivizojnë mekanizma mbrojtëse pikërisht në komunitetet ku jetojnë, shkollohen apo gjejnë strehim gratë/vajzat dhe fëmijët.

Masat specifike me bazë komuniteti mund të dallohen shumë përsa i përket diapazonit dhe përkrahjes dhe mund të fillojnë nga projekte që sjellin të ardhura të vogla e deri në ngritjen e qëndrave komunitare që ofrojnë këshillime, trajnim profesional dhe mundësi për argëtim. Një nga avantazhet e mundshme të metodës me bazë komuniteti është se ajo përfshin komunitetin për identifikimin dhe sugjerimin e masave që ju përgjigjen faktorëve të riskut. Kjo gjë ndihmon gjithashtu që puna të ndërtohet mbi

burimet ekzistuese të komunitetit duke siguruar në këtë mënyrë që këto masa të përputhen dhe të jenë qëndrueshme duke forcuar kështu edhe kapacitetin e komunitetit për të mbrojtur veten.

Veprimtaritë parandaluese me bazë komuniteti mund të shërbejnë që të trajtojnë një ose më shumë faktorë risku tek grupet vulnerabël dhe familjet e tyre.

6.3.4 Bashkëpunimi në shumë sektorë

Kompleksiteti i fenomenit të trafikimit të qënieve njerëzore nuk kërkon vetëm hartimin dhe zbatimin e strategjive për të luftuar, parandaluar trafikimin apo për të ndihmuar viktimat. Gjerësisht është rënë dakort se një qëndrim multidisiplinar ndaj këtij fenomeni është mundësia e vetme për të pasur sukses.

Puna në ekipe nga shumë sektorë brenda të njëjtit program (p.sh. psikologë, punonjës socialë, edukatorë, juristë) mund të ndihmojë për të trajtuar më mirë faktorët e shumfishtë që kontribuojnë në rritjen e fenomenit të trafikut të qënieve njerëzore si dhe të sigurojë një ndërhyrje më të plotë.

Nga ana tjetër një program i vetëm nuk mund të trajtojë të gjitha problemet me të cilat përballen grupet e rrezikuara. Ndërhyrjet mund të jenë më efektive nëse një numër i madh grupesh të interesuara përfshirë këtu prefekturën, bashkinë, autoritetet lokale, shkollat, shërbimet shëndetësore, policinë, gjykatën dhe prokurorinë për të mbështetur gratë/vajzat dhe fëmijët viktima të trafikimit, familjet apo komunitetet e tyre me qëllim që të trajtohen një varg faktorësh risku. Një koordinim i tillë mund të arrihet nëpërmjet:

1. Një marrëveshjeje mirëkuptimi me policinë, punonjësit sociale dhe aktorët e shërbimeve të tjera si dhe ministritë e linjës.
2. Koordinimin midis grupeve në nivel lokal dhe mekanizmave të tyre përkatëse.
3. Rrjeteve të mbrojtjes sociale në nivel lokal.

Vendosja e partneriteteve zyrtare me aktorë të tjerë, për të realizuar veprimtari të projekteve, mund të bëjë që ndërhyrjet të kuptohen më mirë dhe të jenë më të bashkërenduara. Përfshirja e autoriteteve lokale dhe qëndrore si partnerë, ka një rëndësi të veçantë pasi siguron vazhdimësinë dhe qëndrueshmërinë e projektit. Koordinimi i punës me aktorë të shoqërisë civile, për t'i lidhur veprimtaritë në mënyrë të ndërsjelltë mund të fuqizojë ndërhyrjet. Partneriteti me OJF-të lokale duke përfshirë ato që kanë vendosur lidhje me komunitete më të izoluara dhe/ose më të mbyllura, mund të ndihmojë për t'u shtrirë në komunitete të reja.

Bashkëpunimi mund të forcohet nëpërmjet komunikimit të vazhdueshëm dhe mbledhjeve të rregullta me partnerët dhe komunitetet. Mund të ftohen specialistë të organizatave partnere për të marrë pjesë në mbledhje dhe trajnime dhe anasjelltas, personeli i organizatës mund të marrë pjesë në trajnime që organizohen nga partnerë dhe mund të përdoret mundësia për t'u lidhur me rrjetin e aktorëve të tjerë. Krijimi i lidhjeve të mira me median mund të ndihmojë gjithashtu që puna të mbështetet më mirë.

7 INTERVISTAT ME GRATË/VAJZAT DHE FËMIJËT VIKTIMA TË TRAFIKIMIT

7.1 GRUMBULLIMI I TË DHËNAVE PËR QËLLIME LIGJORE (EDHE PËR VIKTIMAT E TRAFIKIMIT)

Intervista me klientin për qëllime ligjore dallon nga të dhënat që merren për qëllime terapeutike apo të llojeve të tjera të ndihmës. Intervista ligjore ka për qëllim grumbullimin e të dhënave dhe provave për të zhvilluar ndjekje penale ndaj autorit të veprës, për qëllime të imigrimit apo për mbrojtjen e klientit.

Institucionet gjyqësore kërkojnë provat më të mira të mundshme, prandaj saktësia e kujtesës së klientit dhe kujtimi për ngjarjet është shumë i rëndësishëm.

Përshkrimi i klientit për ngjarjen duhet të jepet lirshëm. Shpjegimi duhet të jetë i qartë, i regjistruar saktë, dhe gjërat për të cilat flet klienti nuk duhet të ndikohen në asnjë mënyrë nga intervistuesi.

Në intervistat ligjore, është shumë e rëndësishme mënyra se si zhvillohet intervista me klientin në rastet kur shpjegimet e klientit lidhur me ngjarjen do të përdoren si prova në proçesin gjyqësor.

Në rastet kur klienti shpreh acarime për të dëshmuar në çështjet gjyqësore, sipas mundësive klienti duhet të intervistohet bashkarisht nga polici i aftësuar për të zhvilluar intervista me klientin dhe nga punonjësi social. Intervista duhet të regjistrohet më mjete elektronike, audio dhe vizive. Kjo i siguron gjyqit që të drejtat dhe mbrojtja e klientit janë respektuar.

7.1.1 Qëllimi i intervistave për mbrojtjen e klientit mund të përfshijë:

1. Të dhëna për identifikimin dhe të kaluarën e klientit dhe familjes së tij/saj.
2. Të dhëna për referimin e drejtë të klientit, p.sh terapia që duhet t'i ofrohet klientit.
3. Të dhëna që kanë të bëjnë më ngjarjen që i ka ndodhur klientit.
4. Prova zyrtare për qëllime gjyqësore

7.1.2 Grumbullimi i të dhënave për klientët viktima të trafikimit

- Veprimet dhe hetimet që mund të ndihmojnë në identifikimin e grave dhe fëmijëve të keqtrajtuar.
- Nëse identiteti i klientit është verifikuar me dokumentacion të duhur dhe të

saktë?

- Nëse është i mbijetuar, a ka familje që është përgjegjëse për kujdesin e tij/të saj?
- Nëse klienti nuk ka familje, a është ai/ajo nën kujdesin e një organizate?
- Duke pasur parasysh moshën dhe aftësitë e klientit a mund të flasë klienti në fjale, në vendin ku gjendet, në përputhje me moshën dhe nivelin zhvillimor?
- Nëse klienti është fëmijë që i përket moshës shkollore, a i vijon mësimet në shkollë?
- Nëse shërbimet sociale kanë njohuri për klientin?
- A ka klienti dëmtime trupore apo prova të tjera keqtrajtimi?
- A ka klienti ndonjë sëmundje që nuk mund të trajtohet?
- A shfaq klienti frikë që nuk mund të shpjegohet, depresion apo shqetësime?
- Nëse klienti mbahet i ndarë nga mjedisi ku ai/ajo jeton?

7.1.3 Më shumë të dhëna për të ndihmuar klientin - Përgatitjet për referim

Klientët që u kanë shpëtuar trafikantëve apo atyre që i kanë keqtrajtuar ballafaqohen me probleme të shumta. Ndoshta paraqitet nevoja që punonjësi social dhe policia të drejtojnë klientin në ndonjë organizatë më të specializuar për kujdes më të veçantë.

Klienti mund të ketë nevojë për ndihmë mjekësore, psikologjike, edukative, sociale, strehim dhe nevoja të tjera që kërkojnë ndihmën e specialistëve apo familjarëve të komunitetit.

Është i rëndësishëm proçesi i parashtrimit të pyetjeve që do të sigurojnë të dhëna të nevojëshme para referimit të klientit.

Pyetjet mund të përfshijnë:

1 Emrat e anëtarëve të familjes.
2 Të dhëna për vendbanimin e klientit.
3 Të dhëna për historinë familjare.
4 Të dhëna dhe hollësira për familjen: prindërit, motrat/ vëllezërit dhe për rrethin familjar të klientit.
5 Historia shëndetësore.
6 Çështjet familiare
7 Përkatësia etnike.
8 Niveli arsimor.
9 Nevojat e veçanta.
10 Hollësira që mund të ndihmojnë në identifikimin e personave të tjerë të keqtrajtuar.
11 Shpjegimet e klientit që kanë të bëjnë me kohën gjatë së cilës ai/ajo ka qenë larg familjes.

Intervisa ligjore me nje klient të keqtrajtuar mund të përfshijë të dhënat në vijim:

- Identifikimin e keqtrajtuesit/trafikantit të supozuar, prindërit e klientit,

vendodhjen e tyre aktuale dhe marrëdhëniet me të intervistuarin.
- Kohëzgjatja dhe niveli i keqtrajtimit.
- Çfarë ka ndodhur, hollësira që kanë të bëjnë me ngjarjen, kur ka ndodhur ngjarja ku dhe sa shpesh.
- Emrat e njerëzve që mund të kenë njohuri për keqtrajtimin.
- Emrat e njerëzve të përfshirë në ngjarje apo të atyre që e kanë vëzhguar ngjarjen.
- Në raste të keqtrajtimit (të supozuar) seksual, nëse i intervistuari ka qenë i korruptuar apo i kërcënuar të marrë pjesë dhe ta ruajë sekretin.
- Emrat e njerëzve që i intervistuari ka përmendur në të kaluarën dhe çfarë ka ndodhur si rrjedhojë e kësaj.
- Nëse i intervistuari nuk ka folur me prindërit apo me familjen (që nuk kanë të bëjnë me keqtrajtimin) për gjërat që i kanë ndodhur, a ndjehet i gatshëm që të flasë tani.
- Si ndjehet i intervistuari në gjëndjen aktuale dhe çfarë do të kishte dëshëruar që të ndodhte tani.

7.1.4 Përgatitjet për gjykatë

Nëse klienti pranon që të marrë pjesë në procesin gjyqësor, në rolin e dëshmimtarit, atëherë duhet punuar në parapërgatitjen e klientit për deklarimin (deponimin) ose për proçesin gjyqësor.

Koha e përgatitjes së klientit për proçesin gjyqësor është një element shumë i rëndësishëm.

Nëse punohet me klientin shumë më herët sesa dhënia e dëshmive, shqetësimet e klientit mund të rriten. Në anën tjetër, nëse me klientin punohet pak çaste para dhënies së dëshmive klienti mund të ndjehet i nxituar dhe të mos i përvetësojë informacionet e dhëna.

7.2 PËRGATITJET PËR INTERVISTIMIN E KLIENTËVE VIKTIMA DHE/OSE DËSHMIMTARË.

Ky udhëzues është përpiluar për punonjësit socialë që zhvillojnë intervista me gratë, vajzat dhe fëmijët të cilët mendohet se janë viktima të keqtrajtimit dhe trafikimit apo dëshmimtarë.

7.2.1 Udhëzime të përgjithëshme

Udhëzimet e përgjithëshme për intervistimin e grave dhe fëmijëve viktima të keqtrajtimit apo trafikimit janë:

- Intervista duhet të zhvillohet sa më parë që të jetë e mundur, menjëherë pas shfaqjes së supozimeve apo dyshimeve për keqtrajtime.

- I intervistuari duhet të ndjehet i përkrahur dhe i mbrojtur gjatë intervistës.
- Intervista duhet të zhvillohet në një mjedis jo zyrtar dhe intervistuesi duhet të jetë i aftë për të zhvilluar bisedë me klientin.
- Sipas mundësive, intervista nuk duhet të zhvillohet për kohë të gjatë, për të shmangur lodhjen e të intervistuarit.
- Nevojat e të intervistuarit duhet të merren parasysh gjatë planifikimit të intervistës.
- Karakteristikat e klientit, prejardhja familjare dhe personi që do të zhvillojë intervistën duhet të merren parasysh gjatë planifikimit të intervistës.
- Klientëve duhet t'u jipet rasti të përshkruajnë ngjarjen në mënyrën e tyre, para se të fillohet me parashtrimin e pyetjeve të caktuara.
- Në fillim pyetjet duhet të jenë të hapura, kurse pyetjet e drejtpërdrejta apo kryesore duhet të parashtrohen në pjesën përfundimtare të intervistës.
- Përkrahja dhe sugjerimet mund të përdoren, por me shumë kujdes dhe maturi.
- Klienti duhet të përgatitet për dhënien e dëshmive në gjyq, dhe t'i shpjegohen pasojat si rrjedhojë e dhënies së dëshmive.
- Klienti duhet të përkrahet dhe të mbështetet gjatë gjithë kohës së hetimit dhe gjykimit të krimit.

7.2.2 Çështjet me ndikim në intervistat me fëmijë, viktima të trafikimit.

Çështjet që duhen pasur parasysh në rastet e intervistave me fëmijë, viktima të keqtrajtimit apo të trafikimit.

- Faza e zhvillimit të fëmijës
- Niveli i të kuptuarit të fëmijës
- Kujtesa e fëmijës, dhe aftësia e të sugjeruarit
- Njohuritë e fëmijës për përdorimin e gjuhës së folur
- Kultura dhe besimi fetar i fëmijës
- Niveli arsimor i fëmijës
- Aftësia e fëmijës për të shqyrtuar ngjarjen që i ka ndodhur në një kontekst më të gjerë
- Gjëndja psikologjike e fëmijës
- Niveli i mjeteve dhe i përkrahjes që mund t'u ofrohet fëmijëve
- Nëse fëmijës i është mësuar tregimi që duhet thënë para policëve apo nënpunësve të tjerë hetues, apo është i ndikuar nga frika dhe detyrimi me forcë.

Kujtesa

Kujtimi i lirë i fëmijëve mund të shprehet me më shumë mangësi sesa i të rriturve. Ndonjëherë fëmijët mund të shtojnë elemente të trilluara në përshkrimin e ngjarjes, por kjo ndodh në raste të jashtëzakonshme dhe nuk e zhvlerëson pjesën tjetër të shpjeguar për ngjarjen.

Me parashtrimin e pyetjeve për të ndihmuar thirrjen e informacioneve nga kujtesa, shumica e dëshmimtarëve hasin më shumë të dhëna në krahasim me ato që kanë qenë në gjëndje t'u rikujtojnë klientëve, por pyetjet mund të ndikojnë që kujtesa të jetë më pak e saktë. Pyetjet e hapura-të përfunduara nxjerrin përgjigjet më të sakta. Pyetjet e veçanta marrin përgjigje më të sakta sesa pyetjet kryesore.

7.2.3 Aftësia e të sugjeruarit.

Kjo ndodh kur kujtesa e një dëshmimtari ndikohet nga idetë, qëndrimet dhe dëshirat e një personi tjetër. Fëmijët (në veçanti fëmijët më të vegjël se gjashtë vjeç) dhe dëshmimtarët e ndjeshëm mund të ndikohen nga pyetjet e parashtruara apo nga rrethanat e intervistës, si p.sh. në rastet kur fëmija percepton që intervistuesi apo të tjerët e vlerësojnë një veprim negativ, si veprim të dyshimtë apo të gabuar.
Përsëritja e shpeshtë e elementeve sugjeruese nëpër intervista, nëpërmjet përdorimit të pyetjeve kryesore që kanalizohen në një drejtim të gabuar të ngjarjes, mund të nxisin fëmijën që të pajtohet me pyetësin dhe me këtë rast dëmtojnë kujtimin e lirë dhe të shpejtë në lidhje me ngjarjen.

7.2.4 Mashtrimi

Si rregull i përgjithshëm, është e vështirë të thuhet nëse klienti që ju intervistoni thotë të vërtetën.

Mbani mënd që:

Gjestet dhe sjellja nuk mund të konsiderohen si tregues të saktë të deklarimeve të vërteta dhe jo të vërteta. P.sh. disa njerëz besojnë që shikimi në sy gjatë bisedës do të thotë që personi që flet thotë të vërtetën, por për një mashtrues të mirë ky gjest është një përparësi që mund të përdoret qëllimisht.
Nuk ka sjellje apo fjalë të caktuar që mund ta zbulojë mashtrimin, p.sh, mbulimi i gojës, prekja e fytyrës, mbajtja e shikimit nga toka gjatë bisedës, nuk janë gjithmonë tregues të gënjeshtrës.
Disa sjellje si pasojë e stresit mund të ngatërohen me sjelljet e ndërlidhura me mashtrimin, p.sh. djersitja, fërkimi i duarve, apo shkarravitja me laps mund të jenë rrjedhojë e shqetësimit, por nuk janë gjithmonë tregues i gënjeshtrës.
Mbani mend, është shumë e vështirë edhe për policët e trajnuar, të tregojnë kur dikush gënjen.

7.3 SI TA BËJMË INTERVISTËN NJË PËRVOJË POZITIVE

Në përgjithësi, klientët duhet të intervistohen vetëm, por në rastin kur kemi të bëjmë me një fëmijë të vogël ai mund të përfitojë nga shoqërimi i një personi të rritur dhe të besueshëm.

Kushdo person, i dyshuar për keqtrajtime asnjëherë nuk duhet të jetë i pranishëm gjatë intervistës me fëmijë. Personi i rritur, shoqëruesi i fëmijës është i pranishëm për t'i dhënë përkrahje në çastet e vështira: Ata, (shoqëruesi i fëmijës dhe intervistuesi) mund dhe duhet t'i ofrojnë fëmijës komoditet fizik dhe përkrahje verbale, por mos të ndërpresin apo shpejtojnë përgjigjet e tyre. Ata nuk duhet të shfaqin shenja të tronditjes, mosbesimit apo zemërimit dhe të ruajnë konfidencialitetin e përmbajtjes së intervistës.

Intervista duhet të zhvillohet në dhomë të qetë, pa zhurma që mund të tërheqin vëmendjen (televizor apo radio) dhe të mos pengohet nga hyrjet-daljet e njerëzve të tjerë.

7.3.1 Zgjedhja e vendit dhe ambientit të duhur të intervistës.

Vendi

Lejoni që edhe klienti të ndikojë në vendimin se ku dhe kur do të zhvillohet intervista.
Sigurohuni që klienti ndjehet plotësisht i qetë dhe rehat në mjedisin ku do të zhvillohet intervista.
Siguroni të paktën ndenjëse të rehatëshme për klientin, tualet në afërsi të dhomës dhe ujë. Mund të siguroni edhe letër apo mjete të tjera për të shkruar. Ujë dhe pije freskuese mund të ofrohen gjatë dhe në përfundim të intervistës.

Mjediset e intervistimit duhet të jenë sa më private. Personat e tjerë që nuk marrin pjesë në proçese intervistimit, nuk duhet të kenë mundësinë e vështrimit nga dritarja, apo të mund të dëgjojnë bisedën.

Intervista nuk duhet të ndërpritet, njerëz të tjerë nuk duhet të hyjnë dhe të dalin në dhomën ku zhvillohet intervista.

7.4 UDHËZIME PËR PËRDORIMIN E PËRKTHYESVE

Nëse keni nevojë për përkthyes, atëherë sigurohuni që të keni disa elementë të caktuara sigurie. Përpiquni që të merrni në shërbim përkthyes të pavarur, të cilët njihen nga agjensitë për përkthime dhe që janë të aftë dhe të besueshëm.

Në mungesë të agjensive të përkthimit, sigurohuni që kushdo tjetër që ofrohet për të përkthyer, nuk është i njohur me klientin në rrethana të rrezikshme (p.sh. sigurohuni që çdo person që ofrohet për

të përkthyer, nuk ka të bëjë me përvojën e trafikimit të klientit dhe që përpiqet të ndikojë tek klienti dhe ta bëjë atë të mos flasë.)
Sigurohuni që përkthyesi nuk ushtron kontroll mbi klientin dhe nuk ka ndikim tek ai/ajo.

Përkthyesit duhet të kuptojnë që ata duhet të përkthejnë patjetër vetëm atë që thotë klienti në të vërtetë, duke mos shtuar apo anashkaluar asgjë.

Përkthyesit nuk duhet t'i ndryshojnë përgjigjet e klientit gjatë interpretimit, p.sh. për përmirësime gramatikore apo për të shtuar hollësira plotësuese.

Nuk duhet lejuar që përkthyesi të marrë përsipër intervistën dhe të parashtrojë pyetje: Përkthyesit duhet të kenë rol neutral.

Përkthyesve iu duhet shpjeguar që të mos tregojnë tronditje, frikë apo reagime të tjera emocionale, të tilla që mund të ndikojnë tek klienti.

Përkthyesit duhet të jenë të qartë dhe profesionalë. Ata duhet të jenë të afërt, të mos gjykojnë dhe të jenë të çiltër ndaj klientit.

7.5 ÇËSHTJE QË DUHEN MBAJTUR MEND

Klientët nuk i zbulojnë përvojat e tyre të keqtrajtimit (flasin hapur për ngjarjet) në mënyrë të njëjtë. Disa klientë do të flasin në mënyrë të ndërgjegjshme për ngjarjet traumatike që iu kanë ndodhur, ndërkohë që të tjerët do i zbulojnë rastësisht, nëpërmjet sjelljeve të tyre.Zbulimi i keqtrajtimit mund të bëhet nëpërmjet mënyrave/kontrolleve mjekësore apo edhe në mënyra të tjera.

- Klientët mund të mos i thonë të gjitha gjërat që iu kanë ndodhur përnjëherë.
- Mund të ketë vonesa deri sa një klient të shpjegojë, ndonjëherë për një kohë të gjatë. Klientët duhet të ndjehen të sigurt para se të fillojnë të flasin se çfarë ju ka ndodhur.
- Ndonjëherë klienti mund të mohojë keqtrajtimin apo do të tërhiqet nga zbulimi i përvojës (për shumë arsye, duke përfshirë edhe frikën) edhe nëse ngjarja është e vërtetë dhe e mbështetur nga prova të tjera.

- Mosha, kultura dhe natyra e keqtrajtimit mund të ndikojnë në vullnetin e klientit për ta zbuluar të vërtetën e asaj që ka ndodhur.
- Nëse klienti flet për keqtrajtimin, ai/ajo nuk e di se çfarë mund të ndodhë si rezultat i zbulimit të përvojës.

Kini parasysh se rrethanat që kanë të bëjnë me keqtrajtimin e klientit, mund të kenë shkaktuar pasoja traumatike tek fëmija dhe reaksionet psikologjike të traumës mund të ndikojnë në përgjigjet për pyetjet e bëra. Kujtimi i ngjarjeve traumatike mund të ndikojë gjithashtu në psikologjinë e fëmijës.

7.6 FAZA E PARË E INTERVISTËS

7.6.1 Prezantimi

Në mënyrë që klienti të ndjehet i qetë dhe rehat sigurohuni që ai/ajo të ketë njohuri se kush do të jetë i pranishëm gjatë intervistës, dhe arsyen pse janë ata aty. Nëse klienti shpreh ndjenja të forta, që lidhen me refuzimin e pranisë së një personi të caktuar, shqyrtoni arsyet pse, dhe respektoni dëshirat dhe ndjenjat e klientit.

7.6.2 Vendosja e raporteve të duhura të besimit

Pas prezantimit të të gjithë personave të pranishëm shpjegojini klientit se çfarë do të bëni gjatë intervistës. Shpjegojini qëllimin e intervistës dhe sigurohuni që klienti e ka kuptuar atë.

Konfirmoni që klienti e miraton intervistën. Nëse ai/ajo refuzon të marrë pjesë në intervistë, vendimi i tij/saj duhet të respektohet. Asnjë njeri nuk duhet të detyrohet që t'i përgjigjet pyetjeve. Gjatë intervistës duhet të sigurohen ndërprerje për të pushuar dhe për t'u freskuar. Pijet freskuese nuk duhen përdorur si shpërblime për zbulimin e përvojës apo të bashkëpunimit, apo të ndalohen në mungesë të bashkëpunimit.
Siguria emocionale krijohet nëpërmjet besimit, sinqeritetit, qartësisë dhe çiltërsisë.
Besimi: klienti ka nevojë që të ketë besim tek intervistuesi. Asnjëherë mos e gënjeni, mos e drejtoni klientin në mënyrë të gabuar dhe mos i jepni premtime që nuk mund t'i mbani.
Sinqeriteti: thuajini klientit të vërtetën p.sh. kur ai dëshëron të dijë pse ju po e intervistoni atë, se çfarë do të bëni me të dhënat e grumbulluara.
Qartësia: nëse klienti bën pyetje, (p.sh rrethanat që kanë të bëjnë me intervistën) jipini përgjigje të kuptueshme dhe të qarta.
Çiltërsia; jini të sinqertë ndaj përjetimit të klientit. Përvoja e çdo klienti është e ndryshme nga përvoja e një klienti tjetër.

Çdo klient do të shpjegojë përvojën e vet sipas tipareve të veta, kulturës dhe nivelit të njohurive.

1. Mos jepni supozime se çfarë mund të nënkuptojë klienti.
2. Përpiquni të jeni të hapur ndaj mënyrës së përshkrimit të klientit, se çfarë ka ndodhur dhe të kuptoni se çfarë do të thotë ai/ajo.
3. Klientët që kanë vuajtur trauma për një kohë të gjatë mund ta kenë të vështirë që të përshkruajnë ngjarjen në mënyrë kronologjike . Ata mund t'i ngatërrojnë ngjarjet dhe t'i përshkruajnë ato si një e vetme.
4. Klientit mund t'i kenë ndodhur gjëra të tmerrëshme, gjëra që ju mund t'ju duken të pabesueshme, por fatkeqësisht, ato janë ngjarje normale për një person të keqtrajtuar. Mos gjykoni, por bëhuni të hapur dhe të sinqertë ndaj konceptit që klienti përpiqet të përshkruajë, apo përvojës së tij, në mënyrën më të mirë të mundur.

7.6.3 Çështje të mirëbesimit

Shpjegojini klientit arsyet e intervistës dhe çfarë do të bëni me të dhënat e grumbulluara. Asnjëherë mos j'u shmangni të vërtetës: Nëse të dhënat e intervistës tuaj mund të përfundojnë në veprime ligjore kundër autorit të krimit, kështu që klienti duhet të jetë i informuar se në ç'mënyrë do të përdoren të dhënat e intervistës.

7.6.4 Krijimi i marrëdhënieve

Koha e shpenzuar për krijimin e marrëdhënieve gjatë një interviste shoqërohet nga një sërë veprimesh të dobishme.

1. Krijimi i marrëdhënieve të ndjeshmërisë dhe besimit në mes të klientit dhe intervistuesit.
2. Shpjegimi i qëllimit të intervistës dhe prezantimin e personave të dobishëm.
3. Bisedë rreth temave neutrale dhe qartësimi i klientit që ai/ajo nuk ka bërë asgjë të keqe.
4. Vërtetimi i njohurive gjuhësore (nëse klienti është i/e huaj apo është fëmijë), nivelit dhe metodave të komunikimit.
5. Të kuptuarit e personalitetit të klientit dhe rrethanave të jetës së tij/ të saj.
6. Vënia e rregullave, shmangia e supozimeve dhe e sugjerimeve.

Është çështje themelore që ju të siguroheni nëse klienti e kupton rëndësinë e të treguarit plotësisht të së vërtetës

Shembull:
Ju mund të thoni diçka të ngjashme me:
- Është shumë e rëndësishme që ju të më tregoni të vërtetën, se çfarë ju ka ndodhur. E vërteta do të thotë që ju të më tregoni për të gjitha gjërat që ju kanë ndodhur. Ju lutem të mos shtoni ose të mos mënjanoni asgjë.

Nëse ju mendoni se klienti nuk thotë të vëtetën, mos u zemëroni, por me butësi parashtroni pyetje për të mësuar pse ai/ajo ndoshta mundohet që t'i shmanget së vërtetës:

1. Ai, ndoshta, ka frikë
2. Ai, ndoshta, nuk është në gjëndje të kujtojë qartë të gjitha detajet.
3. Ai, ndoshta, do të shmangë futjen e dikujt tjetër në telashe.

Pyetje plotësuese që ndihmojnë në krijimin e marrëdhënieve:

Përpiquni që të mënjanoni pyetjet që kërkojnë përgjigjen e klientëve me "po" dhe "jo". Përdorimi i pyetjeve të hapura ndihmon më shumë në krijimin e një marrëdhënieje efektive.

Pyetje inkurajuese

"Si jeni sot?"
"Si shkoi ushëtimi?"
"Si kaloi java juaj"?"

Pyetje prezantuese

"A mund të më tregoni rreth…?"
"A mbani mend ndonjë rast kur…?"
"Çfarë ndodhi në episodin që ju përmendët ?"
"A mund të përshkruani një situatë në të cilën ju…?"

7.7 FAZA E DYTË E INTERVISTËS

7.7.1 Pyetjet e hapura

Intervistuesi duhet që të kalojë gradualisht nga biseda për krijimin e marëdhënieve, në formën e lirë të tregimit dhe në pyetjet e hapura duke lëvizur drejt çështjeve që kanë krijuar shqetësime. Është e rëndësishme që të punohet me hap të kënaqshëm për klientin . Detyra kryesore është që gradualisht të krijohet një pasqyrë se çfarë mund t'i ketë ndodhur klientit.

1 Ndihmo klientin të përpunojë prespektivën e tij të brendëshme
2 Lejo klientin të ndajë eksperiencën e tij me ju.

Në vijim keni shembuj të pyetjeve të mundshme që të shpien drejt ngjarjeve specifike:

Pyetje shpjeguese

"A mund të më thoni diçka më tepër mbi …?"
"A mund të jepni një përshkrim më të detajuar për atë çka ndodhi?"
"A keni shembuj të tjerë si ky ?"

Pyetje sqaruese ("çfarë", "kur", "ku ", "si")

Janë pyetjet që nxjerrin më tepër hollësira. Një pyetje sqaruese në mes të pyetjes së hapur dhe të veçantë është që ne të bëjmë më shumë pyetje rreth një teme të zgjedhur, p.sh "A mund të më thoni më shumë për…." Kjo i jep klientit lirinë që të flasë më shumë për një ngjarje sipas mënyrës së tij.

Shembuj të tjerë mund të jenë:

"Çfarë bëtë ju në momentin kur …?"
"Çfarë menduat në atë moment?"
" Si reagoi organizmi juaj?"
"Ju lutem përshkruani, ku ndodhi kjo ?"

Kini parasysh se pyetjet *"Pse"* janë shumë të vështira. Shumë shpesh kur ju e pyesni një person: "*Pse veprove ashtu*", ai mendon se ju po e kritikoni e jo, se thjesht ju po kërkoni arsyen e veprimit të tij. Nëse klienti fillon te jusifikohet, parashtroni pyetjet me zë më të butë dhe në mënyrë më neutrale...Çfarë mendoni, pse vepruat ashtu? Çfarë ju shtyu që të veproni ashtu?

Pyetje direkte

"Kur folët për depresionin, çfarë nënkuptonit..?'

Pyetje indirekte
"Për mendimin tuaj, cili do të jetë reagimi i një gruaje në një situatë të tillë?"

Pyetje të strukturuara
"Unë do të doja të diskutonim një çështje tjetër"

Pyetje përcaktuese
"Kur ju thatë se morët …si u ndjetë ekzaktësisht?"

Në kohën kur klienti fillon të përshkruajë historinë e tij/saj, dëgjojeni me kujdes dhe tregojini atij/asaj që ju e kuptoni dhe jeni të hapur ndaj gjërave që thonë ata.

Përpiquni që të mos e ndërprisni kur ai/ajo flet, por mundohuni që të krijoni një pasqyrë të saktë për përvojat e klientit/es.

Në një moment, kur klienti ndalet (ndalet natyrshëm), dhe nuk flet, ju mund të parashtroni pyetje të veçanta për të nxjerrë më shumë hollësira.

7.7.2 Pyetjet e mbyllura

Janë më pak produktive, por mund të përdoren me kujdes në pjesën përfundimtare të intervistës për të sqaruar çështjet e diskutuara më herët. Pyetjet e këtij lloji kanë alternativa të caktuara apo marrin përgjigje "po" ose "jo"

Shembuj:
-Ju ishit në dhomën e fjetjes?
-A ju ka parë dikush?
-A ju goditi ai me dorë?
Shënim: Intervistuesi nuk duhet të fusë ide në kokën e klientit.

Pyetjet kryesore (të cilat sugjerojnë përgjigje) duhet të mënjanohen, p.sh. "*…ishte e kaltër, apo jo?"*Nëse klienti ka dëshirë të kënaq intervistuesin, ai ajo mund thjeshtë të pajtohet me intervistuesin dhe të përgjigjet "*po".* Ky lloj i pyetjeve nuk do të nxjerrë prova të mira dhe të besueshme.

7.7.3 Strukturimi i pyetjeve

Përdorini teknikat "rrjedhëse": Filloni me pyetje të përgjithshme dhe zhvendosuni më pas në çështje më specifike ("Ju lutem më tregoni mbi eksperiencat tuaja lidhur me dhunën", dhe "A mund të më tregoni se ç'bëtë ju atë natë?")

Pyetjet duhet të jenë neutrale kjo është më e rëndësishme se sa përpjekja për të drejtuar pyetje kuptimplota, ose pyetje drejtuese (p.sh. Gabim: "A bini edhe ju dakord që administratori ynë po bën një punë të keqe?". *Më mirë:* "Ç'mund të më thoni për rezultatet e punës së administratorit, deri tani, në zyrë?")

Përdorni pyetje të hapura dhe jo të mbylluara (p.sh. Gabim: "A duhet presidenti të japë dorëheqjen?" *më mirë*: "Si mendoni çfarë duhet të bëjë presidenti tani?).

Një pyetje duhet të përmbajë vetëm një ide (p.sh. Gabim: "A jeni i kënaqur me shërbimin, dhe si ju kanë shërbyer juve?*; Më mirë*: "A jeni i kënaqur me shërbimin?" "Si ju kanë shërbyer ju?"

1 Përdorni fjalë dhe shprehje të qarta dhe familjare
2 Shmangni zhargonin;
3 Shmangni termat shkencorë
4 Gjithmonë sigurohu, kërko (Çfarë nënkuptoni..? Në cilën mënyrë…*?)*
5 Shmangni kontekstet imponuese (A është e vërtetë se …?, Nuk e pëlqeni këtë…?, Po e neglizhoni…?, Doni të thoni?, A po thoni se …?, Është kjo e vetmja gjë që ju po mendoni…?, Ju nuk nënkuptoni…?)
6 Shmangi pyetjet me përgjigje të shkurtra "PO" & "JO"
7 Shmangni pyetjet "PSE"
8 Përdorni heshtjen (Nuk ka asnjë nxitim; merrni një çast të mendoni për këtë gjë dhe më trego se çfarë vjen në mendjen tënde?)

7.8 FAZA PËRFUNDIMTARE E INTERVISTËS

Pjesa që përmbyll intervistën është po aq e rëndësishme sa edhe hapja e intervistës. Nëse klienti ka pasur besim dhe ka folur për shumë gjëra, ndoshta për herë të parë ndjen se ai është dëgjuar dhe kuptuar nga dikush.

Nëse gjërat për të cilat ka folur klienti kanë qenë të dhimbshme dhe të vështira, ai/ajo mund të ndjehet më i lehtësuar pas i ka treguar dikujt, ndoshta për herë të parë; por klienti mund të ndihet edhe më i prekur nga ato kujtime.

Është me shumë rëndësi që klienti të ketë një person që do ta shoqërojë pas intervistës (punonjësi social që kujdeset për të, specialisti për terapi, apo person tjetër i besueshëm) i cili do t'i ofrojë klientit përkrahjen e duhur dhe ta ndihmojë nëse ai/ajo është i mallëngjyer dhe i zemëruar.

Përmbyllja e intervistës është gjithashtu një pjesë e rëndësishme e intervistës, e cila siguron mundësinë që intervistuesi të falenderojë klientin si dhe t'i përgjigjet pyetjeve të mundëshme që mund t'i parashtrojë ai/ajo.

Klienti duhet të pyetet nëse ka ndonjë gjë për të shtuar apo korrigjuar lidhur me gjërat që ka thënë gjatë intervistës.
Intervistuesi mund të japë këshilla nëse do të ketë nevojë për ndihmë, si dhe emrin dhe numrin e telefonit për ta kontaktuar.

Intervista nuk duhet të jetë e gjatë dhe e lodhëshme për klientin, por në të njëjtën kohë ajo nuk duhet të jetë as e përshpejtuar.

Përmbyllja e intervistës duhet të sigurojë që klienti dëshmimtar kur del nga dhoma e intervistimit të ndjehet i sigurt, i mbrojtur dhe i përkrahur gjatë proçesit të hetimit.

7.9 INTERVISTË PËR VIKTIMAT E TRAFIKUT

TË DHËNAT BAZË

1. Nr. _____
2. Referuar nga: (OJF, Rajon Policie, institucione të tjera, individë etj.)
3. Data e hyrjes në qendër: ……datë.muaj.vit
4. Kohëqëndrimi: ____ dite
5. Data e intervistimit: ……..
6. Emri i intervistuesit: …….

TË DHËNAT PERSONALE

7. Emri
8. Mbiemri
9. Kombësia
10. Datëlindja
11. Vendlindja
12. Gjinia F M
13. Statusi Martesor
14. Fëmijë
15. Emri i nënës
16. Emri i babait
17. Adresa e përherëshme (qytet/fshat) fshat
18. Me kë është larguar nga familja: (familjen, shokë, vetëm, agjenci turistike, të tjerë)
19. Përbërja familjare: (nukleare, e gjerë, të tjera)
20. Marrëdheniet familjare (të mira, normale, të vështira, të këqija, të tjera)
21. Statusi ekonomik i familjes (i lartë, standard, i ulët, shumë të varfër)
22. Niveli i edukimit: (analfabet, fillor, 8-vjecar, i mesëm, profesional, i lartë)
23. Gjuhët e huaja:

BRENDA VENDIT

24. Ka patur eksperienca pune të mëparshme? PO / JO
25. Nëse po ku: (vetë punësuar, punë shteti, sektor privat, mësuese, shitëse, kamariere, striptiste, prostitutë, të tjera)
26. Kohëzgjatja e punës (sezonale / rregullisht)

JASHTË VENDIT

27. Ka dalë viktima herë tjetër jashtë shtetit? PO / JO
28. Ka pasur eksperienca pune? PO / JO
29. Nëse po ku: (Vetë punësuar, punë shteti, sektor privat, mësuese, shitese, kamariere, striptiste,
    prostitutë, të tjera)
30. Kohëzgjatja e punës (sezonale / rregullisht)

PROCESI I TRAFIKIMIT DHE REKRUTIMIT

31. Në ç'datë është larguar nga vendi i origjinës?
32. Pse u largua nga vendi i origjinës?
    (studime, turizëm, me punë, e detyruar, vizitë tek të afërmit, të tjera)
33. Mënyra e rekrutimit.
    (premtim i rremë, agjenci punësimi, premtim martese falso, e rrëmbyer, të tjera)
34. A ishte në dijeni viktima që mund të shfrytëzohej për aktivitete seksuale PO / JO
35. Gjinia e rekrutuesit: F / M
36. Kombësia e rekrutuesit:
37. Lidhja e rekrutuesit me viktimën: (të panjohur/ shokë/ i afërm/ prindërore / asnjë / i dashuri /
    burri/ të tjera) - i njohur rastësisht
38. Çfare ndodhi me viktimën që nga momenti i largimit nga shtëpia?
    (këtu shkruhet e gjithë historia e treguar nga viktima)
39. Lëvizjet e viktimës (nga vendi i origjinës deri në vend-ndodhjen e fundit)

Intenerari Shteti + Vendi (emri i vendit ose thjesht qytet/ fshat)	Kohë qëndrimi Ditë / muaj / vite	Mjetet e transportit Makinë/ autobus/ Tren/ avion/ anije/ Të tjera	A ka udhëtuar me të tjerë ? (përshkrimi)	Arsyeja Transit/ Punë/ Destinacioni

40. Kalimi i kufijve u bë në mënyrë të ligjshme apo të paligjshme ? (Asnjë / disa / të gjitha)

41. Cili ishte destinacioni përfundimtar ? _____

KUSHTET E JETESËS DHE PUNËS GJATË KOHËS SË TRAFIKIMIT

Llojet e punës : Striptiste / kamariere/ të tjera + prostitutë

Vendet e punës : rrugë / bar / klub nate / shtëpi / të tjera

A është abuzuar gjatë trafikimit ? - PO
MENDORE : PO / JO FIZIKE : PO / JO SEKSUALE: PO / JO

A është abuzuar para se të trafikohej ? - PO
MENDORE : PO / JO FIZIKE : PO / JO SEKSUALE: PO / JO

Nëse po nga kush? (i panjohur / babai / shokë / i afërm/ burri/ të tjera)

A ka përdorur viktima mjete mbrojtëse (prezarvativ): gjithmonë / jo rregullisht / asnjëhere.

Pagesa e dhëne: (rregullisht / asnjëhere / ndonjëhere); e shpërblyer në ushqime + veshmbathje

A ishte e lirë viktima për të lëvizur? (e mohuar totalisht / vetëm e shoqëruar/ totalisht / të tjera).

SHËNDETI

A ka patur viktima ndonjëherë shqetësime lidhur me shëndetin?

MENDOR: PO / JO HIV-AIDS: PO / JO FIZIK: PO / JO

Shqetësime renale

A ka patur viktima mundësi trajtimi shëndetësor ? (i mohuar / rregullisht / me raste)

A është shtatëzanë viktima në momentin e intervistes? PO / JO / NUK E DI

RIKTHIMI NË VENDIN E ORIGJINËS DHE ASISTENCA

Cilat janë nevojat më imediate që prezanton viktima?

Çfarë dëshiron të bëjë viktima?

A pranon viktima asistencën e ofruar PO / JO

KOMENTE DHE VLERËSIME NGA INTERVISTUESI

Çfarë ndryshimesh dhe kontradiktash shfaq viktima gjatë intervistes?

Niveli i sigurisë/ vetvlerësimit që paraqet rasti është i ulët apo i larte, dhe pse?

Te tjera

8 DËGJIMI AKTIV: KARAKTERISTIKAT E NJË KOMUNIKIMI EFIKAS

Më poshtë do diskutojmë mbi elementët që e bëjnë një komunikim efikas bazuar në eksperiencën e specialistëve që kanë pasur përvoja në intervistimin e viktimave të trafikimit.

8.1 ELEMENTËT QË BËJNË NJË KOMUNIKIM EFIKAS:

- Niveli i barabartë fizik
- Sjelljet e qeta
- Siguria fizike
- Rrethana të këndëshme
- Qetësia (pa zhurma që të tërheqin vëmendjen)
- Intimiteti
- Kufizime të qarta kohore (p.sh. koha, vendi, kohëzgjatja dhe shpeshtësia e mbledhjeve; mirëbesimi, pritjet e ndërsjellta dhe përgjegjësitë)
- Afërsia e mirë psikologjike
- Vërtetësia
- Pranimi pa gjykime
- Respekti dhe vlerësimi për personin tjetër
- Paraqitja e interesimit dhe vigjilencës
- Mendjehapur
- Një kontakt i mirë dhe i vëmendshëm me shikim
- Pranimi i personit tjetër dhe gjërat që thuhen nga ai/ajo (p.sh. pasqyrimi i të dhënave plotësuese)
- Gjestikulacione të lira
- Mirëbesimi
- Besimi
- Shfaqja e vëmendjes së plotë

- Pa ndërprerje
- Pasqyrimi i të dhënave plotësuese
- Pasqyrimi
- Qartësia
- Qartësia, shmangia e ngatërresave dhe keqkuptimeve
- Vërtetimi i nivelit të të kuptuarit
- Jo justifikues
- Kohë të mjaftueshme
- Durimi
- Nxitja
- Përkrahja
- Komente lidhur me ndjenjën kur të dëgjojnë
- Lehtësim
- Jo i/e klientimuar
- I/e njohur
- I dashur, i vlerësuar, nën përkujdesje
- Pjesmarrës
- Pohues
- I/e respektuar
- I/e rëndësishme
- I/e besuar
- I/e vlefshëm
- Pa probleme
- Këndvështrim më të gjërë
- Perspektiva të ndryshme
- Kuptime të qarta
- Sfida
- E kam zgjedhur për klienten time, me ndihmën tuaj
- E vërtetë
- I ekspozuar
- Eksplorimi

8.2 PENGESAT GJATË KOMUNIKIMIT ME KLIENTËT

8.2.1 Jini të kujdesshëm për reagimet emocionale kur klientët nuk dëshërojnë të flasin.

Në rastin kur klienti nuk dëshëron të flasë më, intervistuesi mund të ndjehet i mërzitur dhe i refuzuar apo të ndiejë mungesën e përkrahjes. Intervistuesi duhet të jetë i kujdesshëm për ndjenjat e tij dhe nuk duhet të zemërohet apo të jetë ndëshkues ndaj klientit që nuk dëshiron të flasë lehtësisht.
Klienti mund ta ndiejë shqetësimin e intervistuesit në këtë rast dhe mund të frikësohet: Nëse është e mundur, intervistuesi duhet të përpiqet të gjejë mënyrat për të qetësuar klientin dhe t'i tregojë atij që e kupton arsyen pse ai/ajo e ka të vështirë të flasë.

Bëjini klientit disa pyetje, që mund t'ju ndihmojnë:

1. A është klienti i frikësuar? Nëse po, nga se? Si mund ta ndihmoni?
2. A e kupton klienti që mund t'u besojë juve? Nëse jo, çfarë mund të bëni për ta krijuar besimin?
3. Nëse vëndi ku gjendeni është vend i mirë dhe nxit komunikimin?
4. A janë të pranishëm njerëz para të cilëve klienti nuk ka dëshirë të flasë?
5. A e dëgjoni ju me vëmendje klientin? Shqyrtoni nëse ju jeni duke i përdorur të gjitha aftësitë e duhura të dëgjimit?
6. A ka klienti emocione të forta që e pengojnë të flasë për ngjarjet që ka përjetuar?

8.2.2 Probleme të veçanta të komunikimit

Emocionet:

Në shumicën e rasteve edhe për të rriturit është e vështirë shprehja e emocioneve nëpërmjet fjalëve. Për një njeri (veçanërisht për një fëmijë) të vuajtur dhe të shqetësuar është me të vërtetë shumë e vështirë të flasë për ndjenjat e veta. Nëse klienti ka qenë i privuar nga dashuria dhe kujdesi familjar, apo ndoshta i privuar edhe nga komunikimi, ai mund të mos jetë në gjëndje që të dallojë ndjenjat e tij dhe ndoshta nuk ka shprehje për t'i përshkruar ato, apo për t'i pasqyruar ato në tregimin e tyre. Në këtë rast mund të përdorni vizatime apo forma të tjera të të shprehurit p.sh. arte kreative, dramë, këngë apo muzikë, lojra të ndryshme sipas moshës për fëmijët. Në këtë mënyrë intervistuesi mund të nxisë komunikimin me pyetje të hapura.

Në rastet kur intervistat zhvillohen me fëmijë duhet të kemi parasysh se fëmijët janë të gatshëm që të përshkruajnë tregimin e tyre nëpërmjet kukullave (teatër i kukullave) në formë loje, më mirë sesa ta përshkruajnë tregimin drejtpërsëdrejti para një të rrituri.

Vallëzimi dhe instrumentat muzikore ndihmojnë klientët të shprehin ndjenjat e tyre, p.sh. përplasja e këmbëve gjatë një vallëzimi, apo të rënit e lodrës (daulles) ndihmon për t'u lehtësuar nga zemërimi.

Imagjinimi i mikrofonit mund të përdoret për të kënduar, për ta thënë tregimin apo për t'i shprehur ndjenjat.

Kultura, besimi fetar apo tabu të tjera shoqërore:

Në disa kultura, vajzat në veçanti e kanë të vështirë të flasin dhe pranojnë se ato janë keqtrajtuar seksualisht, sepse kjo dëmton pozitën dhe imazhin e tyre në shoqëri dhe po ashtu ndikon negativisht në rastet për martesë.

Djemtë gjithashtu e kanë të vështirë të pranojnë se kanë qenë të përdhunuar apo të keqtrajtuar. Ata mund të ndjehen sikur nuk janë aq të fortë siç duhet të jenë meshkujt sipas kulturës së tyre.

Personi që zhvillon intervistën mund të jetë i gjinisë së njëjtë me klientin , nëse klienti e ka më të lehtë të flas me personin e gjinisë së njëjtë për gjërat që kanë ndodhur.

Intervistuesi nuk duhet të japë gjykime për klientin.

Zemërimi:

Një grua apo fëmijë viktimë e trafikimit mund të jetë shumë i zemëruar me personat që e kanë lënduar apo me ata që kanë dështuar në mbrojtjen e tij/saj. Intervistuesi duhet të jetë i gatshëm për ta dëgjuar dhe pranuar zemërimin e klientit, duke mos marrë asgjë si personale.

Intervistuesi nuk duhet të lejojë që zemërimi i klientit të shoqërohet me dhunë ndaj tij, apo të tjerëve, dhe duhet të jetë i përmbajtur gjatë tërë dëgjimit. Nëse zemërimi shprehet dhe dëgjohet, më pas vjen lehtësimi.

Aftësitë kryesore janë:

1. Dëgjoni zemërimin e klientit pa gjykime
2. Tregojini klientit që ju e kuptoni pse ai është i zemëruar
3. Mos u justifikoni, jipni prova
4. Mos u përgjigjni me hidhërim apo në mënyrë ndëshkuese
5. Jipini klientit mundësi që ta shprehë zemërimin me fjalë, nëpërmjet lojës apo mënyra të tjera, p.sh. lejoni që të godasin me grushta jastëkun apo t'i bien me këmbë koshit të letrave dhe në të njëjtën kohë të thonë me zë të lartë arsyen pse janë të zemëruar.

8.2.3 Çështjet që e bëjnë dëgjimin më pak efikas.

- Tensionimet,
- Mungesa e besimit
- Mjedisi i zhurmshëm, ndërprerja, prania e gjërave që tërheqin vëmendjen
- Parehatia fizike
- Emocionet e forta të intervistuesit e pengojnë dëgjimin e mirë
- Folësi i tronditur nga emocionet, vetë-ndërgjegja, shqetësimet
- Intervistuesi i preokupuar me gjëra të tjera
- Largimi, kthimi prapa
- Prekja e flokëve dhe loja me laps
- Marrja e shënimeve
- Mungesa e kontaktit me sy
- Ndryshimi i temës
- Ulja apo qëndrimi në nivele të ndryshme
- Probleme gjuhësore apo dallime kulturore
- Xhestet apo qëndrimi jo i duhur
- Padurimi
- Nënvleftësimi apo përbuzja
- Qëndrimi dogmatik apo marrja nën mbrojtje
- Sarkazëma
- Parashtrimi i shumë pyetjeve
- Dhënia e sugjerimeve
- Gjykimi dhe vlerësimi
- Fajësimi
- Konflikti i personaliteteve në mes intervistuesit dhe folësit
- Provokimi
- Humori
- Qartësimi dhe bindja
- Emërtimi dhe diagnostifikimi
- Moralizimi
- Këshillimi, mësimi apo predikimi
- Biseda e papërshtatëshme
- Përdorimi i fjalëve "*që nxisin*" ndryshime të bisedës
- Marrja e fjalës para se folësi të ketë përfunduar fjalinë
- Shpjegimi dhe interpretimi i gabuar
- Dukja profesionale
- Vëmendja e shtirë
- Rënia në gjumë, hapja e gojës
- Mungesa e interesimit, mërzitja
- Reagime në mënyrë automatike, apo më shumë përsëritje
- Mungesa e ndërlidhjes emocionale dhe psikologjike
- Përmbledhja e përshpejtuar e intervistës.

8.3 SHKATHTËSITË DHE CILËSITË E NJË INTERVISTUESI

8.3.1 Dëgjimi dhe komunikimi i mirë

Ata të cilët zhvillojnë intervista me gra dhe fëmijë viktima të trafikimit duhet të jenë të pajisur me durim dhe aftësi për komunikim efikas.

8.3.2 Të kuptuarit e shkalles së zhvillimit të klientit.

Intervistuesit duhet të zhvillojë një komunikim efikas me klientët e të gjitha moshave. Për ta arritur këtë, ata duhet të kuptojnë zhvillimin dhe të folurit e klientit sipas moshës.

8.3.3 Të kuptuarit e natyrës dhe pasojave të trafikimit dhe keqtrajtimit

Ata të cilët zhvillojnë intervista me gra, vajza dhe fëmijë viktima të trafikimit duhet të njohin dhe të kuptojnë llojet e mundëshme të keqtrajtimit të viktimave të trafikimit të qënieve njerëzore dhe pasojat e mundshme tek ata dhe familjet e tyre.

8.3.4 Sinqeriteti ndaj përvojës së klientit

Intervistuesi nuk duhet të jetë gjykues e të japë vlerësime për klientin, ai duhet të jetë i hapur dhe i sinqertë ndaj ndjenjave dhe përvojës së klientit

8.3.5 Krijimi i marëdhënieve

Krijimi i përshypjes tek klienti që mendimet dhe ndjenjat e tij janë kuptuar, dhënia e rastit për të marrë vendime për vetveten, sipas mënyrës së tyre, dhe demonstrimi i interesimit të vërtetë për të ndihmuar klientin.

8.3.6 Lehtësimi i komunikimit

Intervistuesi duhet të jetë në gjëndje për të ndihmuar klientin të komunikojë, dëgjojë dhe të shprehë emocionet dhe problemet e tij.

8.4 SHKATHTËSITË E TË REGJISTRUARIT DHE PËRMBLEDHJES SË INTERVISTËS.

Intervistuesi mund të ketë nevojë që t'i regjistrojë provat dhe ndjenjat e fëmijës, të bëjë një përmbledhje si dhe të dokumentojë intervistën.

8.4.1 Shkathtësitë e komunikimit joverbal

Realizimi i efektshëm i të shprehurit verbal, të veprimeve dhe xhestikulacioneve në komunikim me klientin dhe të tjerë, dhe përdorimi i tyre në mënyrë të përshtatëshme.

Udhëheqja e proçesit të intervistës
I/e aftë për t'i ndërlidhur shkathtësitë e ndryshme, për strukturimin dhe mbikqyrjen e proçesit të intervistës.

Mirëkuptimi dhe ndjeshmëria me fëmijët dhe adoleshentët
Ata që zhvillojnë intervista me fëmijë viktima të trafikimit duhet të jenë të qartë dhe të lirshëm me fëmijët me të cilët punojnë. Ata duhet të kuptojnë sesi mund të mendojnë fëmijët e moshave të ndryshme, si mund të tregojnë dhe të shprehin mendimet e veta.

Të kuptuarit e dallimeve kulturore dhe fetare
Intervistimi i grave dhe fëmijëve të trafikuar kërkon domosdoshmërisht njohjen dhe hapjen ndaj kulturave, besimeve fetare të tjera dhe dallimeve etnike, intervista mund të ndikohet nga tabutë kulturore që kanë të bëjnë me gjininë, vendin dhe përdorimin e pajisjeve.

Të kuptuarit e gjëndjes dhe njerëzve
Të ketë përvojë me njerëz, dhe njohuri për sjellje dhe çështje të ndryshme, si dhe njohuri për rregullore apo udhëzues të mundshëm.

Aftësi për të mësuar
I/e gatshëm për ngritjen e njohurive, i ndërgjegjshëm dhe me mirëkuptim për të tjerët.

Vërtetësia
Ndershmëria, njohja e dobësive dhe e vlerave të veçanta që zotëron

Sinqeriteti ndaj njerëzve të tjerë
Respektimi, mirëkuptimi për dallimet dhe qënia i ndërgjegjshëm për paragjykimet.

Paanësia
I shqetësuar për rezultatet e të dy anëve dhe i aftë për t'ia demostruar të dy palëve.

Vetëndërgjegjësimi
I kushton vëmendje ndjenjave dhe sjelljeve të veta, në mënyrë që të mos i trajtojë palët jo drejtë, pa e vënë re këtë gjë.

Shkathtësia
Aftësia për përmbushjen e normave profesionale, por gjithashtu për t'iu përgjigjur nevojave të çdo individi dhe në gjëndje për ta ndryshuar proçesin e intervistës në mënyrë që të plotësojë nevojat dhe kërkesat e çdo situate.
Balancimi apo ruajtja e raporteve
Intervistuesi duhet të jetë i ndërgjegjshëm për ndjenjat e veta dhe t'i baraspeshojë ato me nevojat e situatës. Atij mund t'i lindë domosdoshmëria të balancojë nevojën për mbështetje dhe argëtim të klientit me nevojën për të mbajtur kufinjtë e duhur që e bëjnë klientin të sigurtë; ai duhet të balancojë autoritetin dhe kontrollin me shqetësimet që ka për klientin.

Zotimi për mundësi të barabarta
I gatshëm për të ndërtuar një mirëkuptim për raca, gjini, kultura dhe besime fetare të tjera si çështje që luajnë rol në përvojën e klientit. Të ketë njohuri për dallimet kulturore dhe të punojë me një shumëllojshmëri të fëmijëve dhe bashkëpunëtorëve në mënyrë jo diskriminuese.

Kreativiteti
Intervistuesi duhet të këtë aftësi në shprehjen e ideve. Sipas nevojave ai duhet të përpiqet që të punojë në mënyra të ndryshme me klientin, si dhe të jetë fleksibël për të përmbushur nevojat e situatave të ndryshme.

Profesionalizmi
Ta marrë punën me seriozitet, të jetë i përgatitur dhe ti realizojë detyrat në kohë. Të jetë i respektuar nga klientët dhe të ruajë marrëdhënie të mira me ta gjatë gjithë kohës.

9 KËSHILLIMI PSIKOSOCIAL

Kapitulli i mëposhtëm ka për qëllim të fokusohet në dimensionin psikologjik të fenomenit të trafikimit dhe të sigurojë një vështrim të plotë te skemës së asistencës në dispozicion të viktimave të trafikimit. Sigurimi i një mbështetjeje psikologjike dhe shërbimeve të këshillimit për viktimat e trafikimit, që nga momenti i pranimit të tyre në programe të rikthimit dhe rehabilitimit e deri në përfundimin e tyre, është një element i rëndësishëm në riintegrimin e sukseshëm të tyre në shoqëri. Pa këshillim efektiv viktimat e trafikimit vështirë se do të arrinin një shërim të plotë nga efektet e traumës psikologjike që ato kanë përjetuar.

Për më tepër, viktimat e trafikimit kthehen shpesh në të njëjtin mjedis familjar, social dhe ekonomik, që në të shumtën e rasteve përfaqësonin faktorët vendimtarë në vendimin e tyre për të lënë vendin e tyre dhe për të kërkuar punë në vendet e huaja. Ne rrethana të tilla, nëse traumat dhe frikërat e tyre nuk janë të adresuara siç duhet dhe mjaftueshëm, ato mund të mos gjejnë forcën e duhur për të përballuar të njëjtin ambient nga i cili donin të arratiseshin. Kështu që, një skemë riintegrimi pa një komponent të fortë psikologjik mund t'i vendosë viktimat e trafikimit në një pozicion të tillë vulnerabël ku ato mund të përfundojnë duke patur herë pas here të njëjtat experienca.

Sesionet e këshillimit të cilat ju sigurohen viktimave të trafikimit gjatë kohës që ato janë rezidente në strehëza duke pritur ri-atdhetesimin, apo riintegrimin, kanë për qëllim të:

1. Kuptojnë dhe vlerësojnë background-in (të shkuarën) e viktimave dhe faktorët përcaktues socio-ekonomikë që krijuan mjedisin mbështetës për shfrytëzimin e tyre të mëtejshëm;
2. Të analizojnë dhe dokumentojnë pasojat psikologjike të përvojës së trafikimit, duke përfshirë një analizë të detajuar të traumës që lidhet me të;
3. Të sigurojnë shërbime këshillimi duke përdorur metoda të dizenjuara për t'i dhënë viktimave mjete për t'u përballur me traumën e tyre dhe t'i përgatisë ato për aktivitete të mëvonëshme ri-integruese.

9.1 VËSHTRIMI EMPIRIK I EFEKTEVE TË TRAFIKIMIT DHE VLERËSIMI PSIKOLOGJIK I RRETHANAVE TË TIJ

9.1.1 Natyra kundërshtuese dhe e pakontrollueshme e trafikimit.

Metodat e përdorura nga qëniet njerëzore për të skllavëruar një tjetër janë mizore dhe shpesh shokuese. Trafikantët ushtrojnë kontroll ekstremisht brutal dhe manipulativ mbi viktimat e tyre, si nga pikpamja psikologjike ashtu edhe nga ajo fizike. Ata përdorin përdhunim, rrahje, torturë, mos-ushqim, rraskapitje fizike, izolim, shfrytëzim dhe kërcënime për vdekje, në mënyrë që të detyrojnë *viktimat e trafikimit* t'iu binden rregullave dhe urdhërave të tyre. Ky nivel i tmerrshëm dhe i vazhdueshëm dhune dhe presioni

emocional i vendos viktimat në një situatë ku ato mësojnë të pranojnë çdo gjë. Të gjitha mjetet dhe aftësitë e tyre për t'iu përgjigjur dhe për të përballuar rrezikun asgjesohen dhe trafikantët përdorin këto teknika për të futur gratë në prostitucion.

Si pasojë direkte e një ambienti të tillë abuzues, viktimat shtyhen për të marrë sjellje konformuese; ato bëhen të bindura vetëm për të shmangur dhunën ndaj tyre. Ato shpesh përdorin modele të sjelljes shmangëse, si komplianca *(pajtueshmëria)* dhe bindja, si një përgjigje ndaj vështirësive dhe rrezikut. Akoma më tej, viktimat e trafikimit jetojnë në një mjedis vazhdimisht shfytëzues ku trafikuesit i ushqejnë ato me informacione false, gjë që parandalon vajtjen e viktimave në polici dhe përpjekjet e tyre për t'u larguar.

Efektet dobësuese të ngjarjeve të pakontrollueshme dhe aversive janë treguar në eksperimente të ndryshme mbi kafshët dhe qëniet njërëzore. Dr. Martin Seligman, nga Universiteti i Pensilvanisë, studioi efektet e veprimeve të detyrueshme konstante tek kafshët. Subjektet normalisht filluan të humbin peshë, të bëheshin të ishin në tension dhe depresion, dhe kur ato lejoheshin të arratiseshin, përgjigjet e tyre varionin nga paaftesi për të lëvizur, në sjellje shmangëse. Seligman e përkufizoi këtë fenomen të pranimit pasivisht nga ana e dikujt të rrethanave, si "*paaftësi e mësuar për të ndihmuar veten*".

Rothbaum sugjeroi që, kur përpiqen të kontrollojnë ngjarjet, njërëzit po ashtu përpiqen të plotësojnë dëshirat e tyre *(kontroll primar*) ose të ndryshojnë veten e tyre për t'iu përshtatur mjedisit *(kontroll sekondar)*. Kur njerëzit mendojnë se janë të paaftë për të ushtruar kontrollin primar mbi ngjarjet, ata mund të bëhen pasivë dhe të tërhequr në mënyrë që të shmangin zhgënjimin dhe humbjen e mundshme të vetë-vlerësimit që do të rezultonte nga përpjekje të vazhdueshme të dështuara për të kontrolluar ngjarje të ngjashme të pakontrollueshme.

Për viktimat e trafikimit, "*kontrolli primar*" manifestohet nga përpjekje për të kundërshtuar rregullat dhe urdhrat e trafikantëve. Shumica e viktimave kanë raportuar se ato janë përpjekur të paktën një herë të kundërshtojnë në mënyrë direkte trafikantët apo të arratisen. Kur një kontroll i "t*illë primar*" nuk mund të fitohet, viktimat i drejtohen "*kontrollit sekondar",* në kuptimin që ato bëhen pasive dhe të shtypura drejt vetë besimeve dhe ndjenjave të tyre. Viktima ka vetëvlerësim të ulët si pasojë e abuzimit të përsëritur që ajo ka pësuar dhe arrin të besojë se nuk ka alternativa "*më të mira*" ndaj situatës abuzive.

Eksperienca e trafikimit dhunon autonominë e një personi në nivelin e integritetit minimal fizik. Viktima e trafikimit, nuk lejohet të vendosi kur apo nëse do të hajë; ajo nuk lejohet të vendosi kur apo nëse do të pushojë, dhe vazhdimisht, trupi i saj dëmtohet dhe dhunohet. Kjo humbje e kontrollit shpesh rrëfehet në aspektet më poshtëruese të traumës. Në shumë raste, ky proçes çnjerëzor mbahet në nivelin e mbajtjes së dokumentave të viktimës dhe dhënia e një identiteti të ri asaj si kthim. Nuk mund të theksohet mjaftueshëm që në kontekstin e trafikimit, si përkufizim, këndvështrimi i viktimës nuk merret parasysh fare. Në këtë mënyrë eksperienca e trafikimit shkatërron besimin e dikujt që mund të ketë kontroll mbi veprimet apo vendimet e tij dhe mund të jetë **vetëvetja** karshi të tjerëve.

Kjo më tej shpjegon arsyet pse shumica e viktimave tw trafikimit, bëhen të mpirë, pasivë dhe dyshues, dhe duken të paaftë për të luftuar situatën e tmerrshme në të cilën përfundojnë. Realiteti është se shumica e njerëzve fajësojnë ose kritikojnë viktimën për këtë pasivitet, në vend që ta kuptojnë atë si një rezultat të trajtimit kriminal që vuan ajo.

9.2 PROBLEMET SHËNDETËSORE

Efektet e drejtpërdrejta të trafikimit në viktimat e tij janë pasojat shëndetësore. Gratë e trafikuara vujanë të njëjtat dhe ndoshta më keq: plagosje, infeksione dhe trauma si ato që vuajnë gratë e dhunuara fizikisht, të sulmuara seksualisht apo të përdhunuara. Për viktimat e trafikimit ndryshe nga rrethanat e zakonshme të dhunës seksuale, incidentet e përsëritura të papritura, izolimi, kërcënimet, dhe keqtrajtimet e vazhdueshme nga ana e trafikuesve kontribuojnë në intensifikimin e pasojave të ashpra të trafikimit.

Shpesh, studime mjekësore, të drejtuara për të karakterizuar dhe dokumentuar pasojat shëndetësore tek gratë e trafikuara forcërisht, janë fokusuar në përhapjen e sëmundjeve infektuese seksualisht të transmetueshme, dhe kanë dokumentuar, por në mënyrë të pamjaftueshme, llojet e tjera të dëmtimeve dhe sëmundjeve nga të cilat këto gra mund të preken dhe vuajnë. Pak studime të tjera janë fokusuar në traumat psikologjike që pësojnë këto gra kur janë në duart e trafikuesve, tutorëve, klientëve dhe të "të dashurve". Kjo konfirmon faktin që profesionistët e shëndetit nuk kanë dokumentuar në mënyrë të përshtatshme shkallën e plotë të dëmtimeve që përvoja e trafikimit shkakton tek viktimat e tij.

RREZIQET SHËNDETËSORE

Faza e para nisjes
histori personale,
dhune nderpersonale
pervoje me sherbimin
shendetesor vendas dhe edukimin
promocion mbi shendetin
kushtet epidemiologjike dhe
socio-ekonomike te vendit

Faza e tranzitit dhe udhetimit
Risk i larte,
kushtet e renda te udhetimit
Dhune, abuzim seksual, kercenime,
"Fillimi i traumes" skllaveri e plote,
te qenit te blere dhe te shitur
konfiskim dokumentash
mungese informacioni dhe kujdesi

Faza e ndalimit dhe evidencave kriminale

mungesa e kujdesit per shendetin

imigrimi dhe zyrat e drejtesise

mungesa e procedurave zyrtare te lidhura me shendetin

Faza e destinacionit
Rrisqet dhe abuzimet e mundshme
shendeti fizik
shendeti seksual
substancat abuzive dhe keqpërdorimi
shendeti social
izolimi, perjashtimi
gjendje e mire ekonomike

Faza e integrimit, ri-trafikimit, dhe ri-integrimit
risqet personale te sigurise
risqet e lidhura me te qenit nje refugjat
apo nje i kthyer mbrapsht
pengesa praktike, sociale,
ekonomike, kulturore dhe gjuhesore
izolim dhe perjashtim

Skema 1 prezanton një prespektivë të gjithëanëshme të nevojave shëndetësore të gruas përmes pesë fazave primare të proçesit të trafikimit. Këto janë:

Faza e para-nisjes
Faza e tranzitit dhe udhëtimit;
Faza e destinacionit;
Faza e ndalimit dhe evidencave kriminale;
Faza e integrimit dhe riintegrimit.

Kjo kornizë prezanton fazat e ndryshme të proçesit të trafikimit në mënyrë që të nxjerrë në pah rreziqet e shëndetit, shërbimet e nevojitura, dhe mundësitë e sfidat për ndërhyrje në secilën fazë.
Për më tepër, duke vendosur proçeset e trafikimit në faza kronologjike, korniza ndihmon në theksimin e nevojës për të mbajtur parasysh risqet dhe abuzimet që lidhen me secilën fazë, që nga rekrutimi, e deri tek integrimi dhe riintegrimi, me qëllim që t'u japë zgjidhje nevojave shëndetesore të grave. Faza e para-nisjes për shembull, mund të përfshijë përvoja specifike të dhunës dhe abuzimit që mund të ndikojnë në shëndetin e një gruaje, aftësinë për të shmangur rreziqet e mëvonëshme, dhe aftësitë potenciale ripërtëritëse për të ardhmen.

Në mënyrë të ngjashme, secila fazë e proçesit të trafikimit ofron mundësi të ndryshme dhe sfida për ndërhyrje shëndetësore. Për shembull, është e mundëshme të përmiresosh njohuritë e grave për shëndetin dhe shpërndarjen e shërbimeve shëndetesore ndërkohe që një grua është akoma në vendlindjen e saj, duke rritur fushatat promovuese të shëndetit dhe duke ofruar informacion të targetuar (me symin, të drejtuar) mbi shëndetin dhe migracionin. Ky tip informacioni mund të aftësojë gratë të mbrojnë me mire shëndetin e tyre kur është nevoja për këtë.

Kjo perspektivë kronologjike gjithashtu, i korrenspondon modeleve publike të shëndetit, për parandalim e sëmundjeve, që paraqesin nivele primare, sekondare dhe terciare të ndërhyrjes:

ndërhyrja primare: ka për qëllim të adresojë (fokusojë, ngrejë) problemin para se të fillojë
ndërhyrja sekondare: ka për qëllim t'i përgjigjet shenjave të herëshme të problemit
ndërhyrja terciare: ka për qëllim t'i përgjigjet atëherë kur problemi është evident dhe tashmë duke shkaktuar dëm.

Në rastin e trafikimit, *ndërhyrja primare* kompromenton ato ndërhyrje të zbatuara gjatë fazave të herëshme të udhëtimit të një gruaje, në fazat e para-nisjes dhe tranzitimit. Këto ndërhyrje mund të përfshijnë, për shembull, strategjitë e promocionit të shëndetit publik që kanë për qellim të sigurojnë informacion në shëndetin riprodhues dhe seksual, simptomat e lidhura me sëmundjet infektuese, shëndetin mendor dhe simptomat e lidhura me të, ose rreziqet shëndetesore të lidhura me migrimin, duke përfshirë të drejtat ligjore mbi trafikimin në vende të tjera. *Ndërhyrja sekondare* zë vend më vonë gjatë fazës së destinacionit ku grave mund t'iu ofrohet ekzaminim për infeksione, trajtim për probleme të reja emergjente shëndetësore, dhe referim për asistim ose informacion që mund të parandalojë dëme të mëtejshme. Së fundmi, *ndërhyrja terciare* përfaqeson ndërhyrjet e zbatuara gjatë fazës së integrimit dhe riintegrimit, kur, për shumicën e grave, problemet
psikologjike, fizike dhe seksuale janë manifestuar dhe ato kërkojnë përkujdesje dhe mbështetje të madhe.

Skema 2: Sferat e marxhinalizimit dhe vulnerabilitetit:

Modeli i dytë konceptual (më sipër) vë në dukje që gratë e trafikuara në punën e seksit mbajnë vulnerabilitetin e një sërë popullatash të marxhinalizuara apo të përjashtuara nga shoqëria:

1 gra të migruara
2 gra që përjetojnë abuzim seksual, dhunë familjare, torturë
3 viktimat e prostitucionit
4 gra të shfrytëzuara

Gratë e trafikuara janë të rrezikuara të vuajnë lloje të ndryshme abuzimi, stres, depresion dhe pasoja somatike të ngjashme me ato të përjetuara nga gratë viktima të dhunës. Vendosja e grave të trafikuara në qender të katër sferave të mbivendosura që përfaqesojnë këto popullata vulnerabile shërben për të theksuar kompleksitetin dhe multiplicitetin e nevojave të tyre.

Literatura për masat e shërbimit për këto grupe gjithashtu nënvizon pengesat e hasura për kujdesin shëndetësor dhe sugjeron leksione potenciale për shpërndarjen e shërbimeve. Pengesa për shpërndarjen e shërbimeve për këtë kategori përfshijnë ndryshueshmeri të lartë, diferenca kulturore dhe linguistike, ekzistencë klandestine apo shumë të marxhinalizuar, pabarazi sociale dhe ekonomike, frenime ligjore, frenime në para, stigmatizim, dhe diskriminim politik dhe social (përfshirë dhe nga siguruesit e kujdesit shëndetësor). Mësimet e nxjerra tregojnë që për grupet e marxhinalizuara dhe vulnerable, siguruesit e shërbimeve shëndetësore duhet të zhvillojnë strategji që kanë brenda aktivitete në komunitet që nuk varen nga aftësitë e individëve për të patur akses në klinika apo shërbime spitalore. Zbatimi dhe planifikimi i plotë i programit të shërbimeve merr parasysh shkallën e risqeve, abuzimet potenciale, dhe nevojat shëndetesore multidimensionale të këtyre popullatave.

Rreziqet dhe abuzimet e përballuara nga gratë e trafikuara janë rrallë të vetme si natyrë. Ato janë shpesh të kombinuara në një mënyrë të përllogaritur për të rrënjosur frikën dhe për të siguruar kompliancen (pajtueshmerinë) me kërkesat e trafikuesve, klientëve dhe punëdhënësve. Gratë janë të dhunuara fizikisht, për t'i detyruar të kenë marrëdhënie seksuale; të përdhunuara, si një metodë psikologjike për t'i shtyrë ato drejt nënshtrimeve në të ardhmen; të izoluara, për t'i bërë ato të paafta psikologjikisht dhe ekonomikisht; të deprivuara, për t'i bërë të varura nga trafikuesit.

Gratë që tentojnë të rebelohen apo që kërkojnë pjesën e tyre rrihen ose penalizohen financiarisht - ose të dyja këto së bashku. Në vazhdim të komplikacioneve shëndetesore të shkaktuara direkt nga dhuna dhe kanosja, gratë e trafikuara gjithashtu përballen me rreziqet shëndetesore të lidhura me marxhinalizimin e tyre social, ligjor dhe gjinor, siç janë puna në sektorët e rrezikut të lartë, pengesa ndaj shërbimeve, diskriminimi. Këto rreziqe qëndrojnë paralel me ato të prezantuara në skemën konceptuale nr.2.

Format e rrezikut dhe abuzimit dhe pasojat korrensponduese të shëndetit të lidhura me trafikimin përfshijnë:

abuzim fizik - shëndet fizik;
abuzim seksual - shëndet seksual dhe riprodhues;
abuzim psikologjik - shëndet mendor;
përdorim i detyruar, shtrëngues i drogës dhe alkoolit - keqpërdorim dhe abuzim me substancat
kufizime sociale dhe manipulime - mirëqënie sociale
shfrytëzim ekonomik dhe skllavëri - mirëqënie ekonomike
pasiguri ligjore - siguri ligjore
punë dhe kushte jetese abusive - mirëqënie mjedisore dhe okupacionale (marrëdhënie pune); dhe
rreziqe të lidhura me marxhinalizimin-akses në shërbimet shëndetesore dhe shpërndarjen e tyre

Është githashtu e rëndësishme të vëmë në dukje faktin që rreziqet shëndetësore janë multiple, dhe pasojat të mbivendosura dhe shpesh me natyrë reciproke. Për shembull, risqet fizike shkaktojnë përgjigje negative psikologjike, të cilat si kthim mund të rezultojnë në probleme shtesë fizike (p.sh. dhimbje koke të shpeshta, ç'rregullime të sistemit të tretjes).

Ndikimet në shëndet shpesh varen nga shkalla dhe frekuenca e kanosjes, dhe aftësia përballuese e individit (që është shpesh e influencuar nga cilësia e mbështetjes së disponueshme).

Format e ndryshme të abuzimit dhe kanosjes, kërcënimit, kryqëzohen shumë herë në mënyra të ndryshme duke krijuar një labirint të pazgjidhshëm të rrezikut psikologjik dhe fizik. Të ngecur në një rrëmujë të tillë, shumë nga të shpëtuarit zhvillojnë mekanizma përballjeje që i ndihmojnë ata për të parandaluar dhe shmangur rrezikun më kërcënues, të menaxhojnë rreziqet e pashmangshme, dhe të pakësojnë pasojat negative. Sidoqofte, në terma afatgjatë, me të dalë nga ambienti kërcënues, këto përgjigje të të shpëtuarve mund të pengojnë aftesitë ripërshtatëse dhe funksionimin normal të individit.

9.3 PASOJAT DHE SIMPTOMAT KLINIKE PSIKOLOGJIKE TË SHKAKTUARA NGA TRAFIKIMI

Ngjarjet traumatike zakonisht përfshijnë kërcënimet ndaj jetës ose integritetit fizik apo një përballje personale e afërt me dhunën ose vdekjen. Përgjijgjia e zakonshme njërëzore ndaj vdekjes përfshin si aspektet biologjike ashtu edhe ato psikologjike. Kur një person percepton rrezikun, trupi reagon duke rritur shkarkimin e adrenalinës dhe duke qënë në një gjëndje alerti. Kjo shpjegon pse njërëzit, të cilët janë në kushte\situata të kërcënuese, janë shpesh të aftë të shpërfillin urinë, lodhjen apo dhimbjen. Rreziku fokuson vëmendjen e personit në situatën imediate. Të gjitha këto reagime janë të shoqëruara nga emocione intensive apo frikë dhe\ose zemërim që mund të mobilizojë apo edhe paralizojë një person. Me fjalë të tjera, në një situatë krize një person zgjedh të luftojë apo t'ia mbathi.

Reagimet traumatike ndodhin kur ri-veprimi (arratisja) dështon ose kur rezistenca është e pamundur, dhe sistemi njerëzor i vetëmbrojtjes tronditet dhe çorganizohet. Në këtë pikë, ngjarja traumatike prodhon ndryshime (dëmtime) të thella dhe afatgjata në procesin psikologjik, ndjenja dhe njohje. Ngjarja traumatike jo vetëm që prek këto funksione individulaisht, por gjithashtu shndërron mënyrën nëpërmjet të cilës ato bashkëpunojnë dhe ndërlidhen me njëra-tjetrën.

Eksperienca e trafikimit përfshin çaste të përsëritura të abuzimit të ashpër, pa pushim mendor apo periudha "*normaliteti dhe paqeje*", sepse VeT[38] asnjëherë nuk e dinë çfarë do të ndodhi më pas, kur do të ndodhi shpërthimi apo episodi tjetër i dhunës.

Cilat janë reagimet normale njerëzore ndaj ngjarjeve jonormale, si traumat e eksperiencave të trafikimit?

Reagime fizike:

1 Dhimbje si dhimbje koke, kurrizi dhe stomaku
2 Djerësitje e papritur dhe\ose rrahje të shpejta të zemrës
3 Ndryshime në regjimin e gjumit apo ushqimit
4 Më të prekshëm nga sëmundjet dhe ftohja (system imunitar i dobësuar)
5 Mbipërdorim I alkoolit ose drogërave, dhe\ose mbingrënie

Reagime psikologjike:

1 Shokim dhe frikë
2 Disorientim dhe konfuzion konjitiv
3 Irritueshmëri, mungesë qetësie
4 Shqetësim apo ripërtypje: mendime intrusive të traumës
5 Makthe dhe flash-back të ngjarjes
6 Përpjekje për të shmangur cdo gjë të lidhur me traumën
7 Minimizimi i eksperiencës
8 Një tendencë për izoluar veten apo ndjenja deatashimi
9 Vështirësi për të besuar dhe\ose ndjenja tradhëtie
10 Ndjenja pashpresshërie, panik dhe humbje kontrolli
11 Pakësim i interesit në aktivitetet e përditshme
12 Humbje e ndjenjës së rregullit dhe drejtësisë në botë; frikë për të ardhmen.

Gjatë takimit të parë me viktimën, ajo është zakonisht në një gjëndje të rraskapitur fizike, konfuzion, disorientim dhe e mbushur me frikë. Ajo gjithashtu mund të ketë vështirësi në kujtimin e asgjëje nga eksperienca e saj e trafikimit dhe, edhe kur ajo kujton ndonjë gjë, kjo zakonisht shoqërohet me emocione të forta distresi inkoherence.

9.3.1 Gjëndja psikologjike e gruas së asistuar

Ndjenjat e vulnerabilitetit dhe dhimbja emocionale që provohen nga VeT, të kombinuara shpesh me një background të abuzimit dhe keqtrajtimit në fëmijëri, lujanë një rol të rëndësishëm në ndodhjen dhe ashpërsinë e përgjigjeve (reagimeve) akute.

Viktimat e trafikimit shfaqin një sërë reagimesh si pasojë e traumës që ato kanë përjetuar:

1. Reagime të stresit akut
2. Çrregullime të stresit post-traumatik dhe disosacion
3. Depresion
4. Çrregullim të personalitetit kufitar

Veprime të paramenduara për të dëmtuar veten (zakonisht prerje me brisk dhe shenja të djegies së vetes me cigare në krahë).

Si përfundim, ka një rrezik ekstrem të vetëvrasjes mes grave që kanë qënë të trafikuara. Disa nga ato thonë se ato vendosin të kryejnë një akt vetëvrasës (si marrja e qetësuesve, prerja e venave, ose intoksikim vullnetar me substanca të ndryshme) në mënyrë që të mund të hospitalizohen dhe të arratisen nga mjedisi abuziv ku ato mbahen të robëruara.

9.3.2 Çrregullimi i stresit pas traumës[39]

ÇSPT shfaqet si një përgjigje e vonuar dhe\ose e zgjatur ndaj një ngjarjeje apo situate të një natyre vecanërisht kërcënuese apo katastrofike, e cila është e ngjashme për të shkaktuar distress pervaziv tek pothuajse çdokush. DSM IV shton: *"Çrregullimi mund të jetë veçanërisht i ashpër apo i zgjatur kur stresori është njerëzor"*.

Çrregullimi i stresit pas traumës (ÇSPT) apo ndryshe stresi posttraumatik, është një ndër çrregullimet më të njohura dhe më të studiuara të ankthit. Ai paraqet në vetvete një stres të një lloji të veçantë, me elementë specifikë e të shfaqur në kohë e mënyrë disi të papritur e të pakuptueshme për klientin që e mbart këtë lloj çrregullimi. Për më shumë ai mund të shfaqet në kohra tepër të qeta e të lumtura, në mes të një harmonie e lumturie bashkëshortore, apo të një suksesi financiar, atëhere kur klienti mendon se jeta e tij është tërësisht në rregull, dhe kujtimet apo problemet e hidhura të së kaluarës janë fashitur krejt. Stresi pas traumës, nga vetë emri mund të shfaqet pas saj, por koha e kësaj vijimësie varion nga më të shkurtrat e deri në periudha të gjata që shtrihen edhe deri në 10 vjet. Është kjo që e bën këtë lloj stresi disi më të mistershëm për momentin kur shfaqet dhe më të vështirë diagnostikimin apo gjetjen e shkaqeve të tij nga vetë klienti.

Për ÇSPT janë përdorur një sërë emërtimesh si për shembull: *"zemër e irrituar"*, *"zemra e ushtarit"*, *"sindroma e lodhjes"*,*"neuroza e luftës"* etj.. Disa nga emërtimet e mësipërme lidhen me luftën sepse

ÇSPT fillimisht u studjua në këtë kuadër. Mjekët i shpjegonin disa nga reagimet emocionale disi të çuditshme të ushtarëve me lodhjen fizike dhe nostalgjinë për fëmijët. Në të vërtetë shkaku kryesor i këtyre reagimeve e elementeve stresorë ishte çrregullimi I stresit pas traumës. Ai shfaqej jo vetëm në periudhën kur lufta ende s'kishte mbaruar, por edhe i largët e në distancë nga koha e vendi i përjetimit të tmerreve të luftës, dhe si çdo sëmumndje e patrajtuar jepte influencat e shpërthimet e veta të mëvonshme në shëndetin psikik të të çrregulluarit.

Pasi i janë ekspozuar një mjedisi dhune, keqtrajtimi dhe abuzimi të tmerrshëm, shumica e VeT kanë raportuar ri-përjetimin e momenteve të procesit të trafikimit në makthe apo kujtime të papritura të ngjarjeve. Megjithëse VeT mund të tentojnë të provojnë shmangjen e kujtimeve të tilla vuajtëse, shpesh herë ato do të zbulojnë në mënyrë spontane traumat që kanë kaluar. Emocionalisht VeT mbeten të alternuara mes ndjenjave të paqetësisë dhe ankthit, në të qënit apatike dhe të trishtuara në mnëyrë të vazhdueshme.

Falë natyrës së fenomenit të trafikimit, tipi i traumës kronike të përjetuar nga VeT nuk është i limituar nga një ngjarje e vetme përçarëse; në vend të kësaj trauma është e përhapur në një periudhë kohe shumë më të gjatë. Sipas kësaj, sa më gjatë që VeT rrinë nën kontrollin e trafikantëve, aq më të gjata dhe të ashpra do të jenë efektet e traumës së tyre.

Simptomat Kyçe Të ÇSPT:

1 Kujtime të vazhdueshme stresuese rreth ngjarjes

Klientët vazhdojnë të kujtojnë episodet traumatike. Në disa raste klientët mund t'i imponojnë vetes të menduarin rreth ngjarjes. Kjo ndodh më shumë në rastet kur klientët mendojnë se mundësia për shmangien e ngjarjes është e madhe.

2 Episode flash-back-u:

Karakterizohen nga nxitje ekstreme emocionale dhe fiziologjike gjatë së cilës personi mund të ndihet sikur e kanë mbërthyer në vend. Ai nuk është i ndërgjegjshem për situatën në të cilën ndodhet. Pothuaj çdo stimul i lidhur me traumën mund të shkaktojë flashback. Madje kjo mund të ndodhë edhe nëse subjekti nuk është i ndërgjegjshëm për lidhjen midis stimulit dhe traumës. Për shembull një kliente e përdhunuar nuk e kuptonte, përse nuk e duronte dot aromën e trandafilave derisa u kujtua se në dhomën ku u sulmua kishte pasur një vazo me trëndafila.

Emocioni shoqërues është në nivele shumë të larta dhe klienti mund të përjetojë të njëjtin nivel tmerri dhe zemërimi si dikur. Flash back-u konsiderohet i rrezikshëm për disa arsye:

1. zhvillon vuajtjen.
2. mund të rëndohet më tej.
3. dëmton mirëqënien e unit sepse manipulon ndjenjën e kontrollit.

3. Paaftësi për të rikujtuar aspekte të rëndësishme të traumës. Kjo paaftësi mund të konstatohet edhe menjëherë pas ndodhjes së episodit traumatik. Klientit i duhet kohë që të risjelljë plotësisht në kujtesë të gjithë ngjarjen.

4 Mungesë interesi për aktivitetet

Klienti i prekur nga ÇSPT tërhiqet nga aktivitete të cilat në të shkuarën i kanë dhënë kënaqësi: këto mund të kenë qenë aktivitete të lidhura me punën ose marrëdhëniet sociale. Shkalla e përjetimit të traumës mund të jetë e tillë që mund ta detyrojë individin të shkëputet nga puna. Nuk janë të pakta raste kur trauma pasohet nga konflikte në marrëdhëniet bashkëshortore të cilat mund të shkaktojnë deri edhe divorc.

5 Disocim (shkëputja nga realiteti)

Disocimi konsiderohet si një mekanizëm që parandalon mbistimulimin e vetëdijes. Trauma shkakon ndarje të sjelljes, ndjenjës, ndijimit dhe njohjes. Reagimet e klientit nuk përputhen me stimujt realë.

6 Simptomat shmangëse

Simptomat shmangëse konsiderohen si përpjekje për të kontrolluar ose për t'u mbrojtur nga efektet negative ose stimuj të cilët shkaktojnë ripërjetimin e ngjarjes. Ka raste kur sjellja shmangëse arrin deri në kufij ekstremë si në rastin kur viktma e përdhunimit refuzon të dalë nga shtëpia për vite me rradhë duke zhvilluar në këtë mënyrë shënja agorafobie.

7 Mpirja emocionale

Mpirja emocionale i referohet shkëputjes nga marrëdhëniet sociale, paftësisë për të përjetuar emocione, pakësimit të interesit për të marrë pjesë në aktivitete, dështimit në arritjen e kënaqësisë seksuale. Mpirja emocionale përbën një problem kompleks të shumëfishtë që mund të karakterizohet si një defiçit emocional. Defiçiti emocional shoqërohet me nivele të larta reagimi ndaj ngjarjeve negative. Në disa raste mund të kombinohet me frikë se mos humbet kontrolli, me frikë të përforcuar nga shpërthimi i nervozizmit ekstrem. Këto shpërthime janë më tipike për meshkujt sesa për femrat.Mpirja emocionale mund të konsiderohet si një nga pikat më të vështira të trajtimit dhe mund të vazhdojë të jetë e pranishme edhe pas zbutjes së simptomave të tjera.

8 Aleksitimi

Klienti është i paaftë për të identifikuar ose për të verbalizuar emocionet.

9 Perspektivë e zymtë mbi të ardhmen

Klienti ka pritshmëri negative për të ardhmen në mënyrë të veçantë në atë aspekt në të cilën ai është dëmtuar nga episodi traumatik. Për shembull një femër e përdhunuar mendon se asnjë herë nuk do të jetë në gjendje të krijojë marrëdhënie, të ketë familje dhe fëmijë.

10 Irritueshmëri ose shpërthim zemërimi

Irritimi në disa raste mund të lidhet me stimujt që i kujtojnë ngjarjen. Në raste të tjera klienti nuk është në lidhje të identifikojë shkaqet e zemërimit. Këto shpërthime hasen më shpesh tek meshkujt sesa tek femrat vuajtëse të ÇSPT. Megjithatë ato s'janë të pazakonta tek gratë dhe janë më frikësuese kur janë të palidhura me sjelljen e tyre pretraumatike

11 Vështirësi në përqëndrim

Klientët kanë ankesa në drejtim të përqëndrimit, ankesa këto që janë më të mëdha në periudhën menjëherë pas traumës.

12 Ndjenjë faji për ngjarjen

Klientët kanë ndjenja të shumta faji, ndjesi këto që shtohen më shumë në rastin kur klienti mendon se

ka patur mundësi ta shmangë traumën por nuk e ka bërë këtë. Për shembull shumë viktima të përdhunimit e shohin veten si përgjegjëse të asaj që u ka ndodhur. Të mbijetuarit e një aksidenti gjithashtu kanë ndjenja faji për ata që nuk kanë mbijetuar ose në lidhje me ato veprime që ata mund të kishin bërë për të shpëtuar të tjerët.

Reagimet fiziologjike shoqëruese:

Djersitje;

Zbehje;

Takikardi;

Presion i rritur i gjakut;

Dhimbje koke;

Ethe;

Të fikët;

Marrje mëndsh;

Ankth, stres;

Tension muskular;

Shqetësim;

Nivele të rritura të noradrenalinës dhe adrenalines;

Hipereksitim simpatik (sulm ose ikje).

Kriteret diagnostike për çrregullimin e stresit post-traumatik

Personi është ekspozuar ndaj një ngjarjeje traumatike në të cilin kanë qenë të pranishme të gjitha aspektet e mëposhtme:

13 Personi ka përjetuar, ka qënë dëshmitar ose është përballur me një ngjarje ose disa ngjarje që përfshijnë një prej episodeve të mëposhtme: vdekje ose kërcënim për vdekje, plagosje të rëndë ose kërcënim i integritetit fizik të vetes ose të të tjerëve.

14 Reagimi i personit përfshin frikë shumë të madhe, ndjesinë e të qënurit i pashpresë ose tmerr.
Shënim: Tek fëmijët kjo gjendje mund të shprehet me sjellje të çorganizuar ose të shqetësuara.

15 Ngjarja traumatike ripërjetohet në të paktën në një prej këtyre rrugëve:

16 Nëpërmjet kujtimeve pikëlluese të vazhdueshme dhe të bezdisshme të ngjarjes, duke përfshirë imazhe, mendime ose perceptime të saj.

Shënim: tek fëmijët, tema ose aspektet e traumës mund të shprehen nëpërmjet lojës përsëritëse.

17 Nëpërmjet ëndrrave pikëlluese të cilat i referohen ngjarjes

Shënim: fëmijët mund të shohin ëndrra të frikshme me përmbajtje të panjohur.

18 Nëpërmjet veprimeve ose ndjenjave sikur ngjarja po ndodh sërish (përfshirë një ndjenjë të

ripërjetimit të eksperiencës, iluzione, haluçinacione dhe episode flashback-ësh disociativë, të ngjashëm me ato që ndodhin në zgjim ose në dehje).

19 Nëpërmjet distresit psikologjik të fortë të shkaktuar nga ekspozimi ndaj stimujve të jashtëm ose të brendshëm që i ngjajnë ose simbolizojnë një aspekt të ngjarjes traumatike.

20 Nëpërmjet reagimit fiziologjik të shkaktuar nga ekspozimi ndaj stimujve të jashtëm ose të brendshëm që i ngjajnë ose simbolizojnë një aspekt të ngjarjes traumatike. Shmangie e qëndrueshme e stimujve të lidhur me traumën dhe bllokim i ndjeshmërisë së përgjithshme (jo e pranishme para traumës) e shfaqur të paktën në një nga tre format e mëposhtme:

21 Nëpërmjet përpjekjeve për të shmangur mendimet, ndjenjat ose bisedat e shoqëruara me traumën.

22 Nëpërmjet përpjekjeve për të shmangur aktivitetet, vendet ose njerëzit që nxisin rikujtimin e traumës.

23 Nëpërmjet paaftësisë për të kujtuar një aspekt të rëndësishëm të traumës.

24 Nëpërmjet uljes së dukshme të interesit për pjesëmarrjen në aktivitete.

25 Nëpërmjet ndjenjës së shkëputjejes dhe të qënurit i ndryshëm nga të tjerët.

26 Nëpërmjet paksimit të aftësisë për të dashur (paaftësi për të pasur ndjenja dashurie)

27 Nëpërmjet ndjenjës së zymtësisë, pasigurisë për të ardhmen (për shembull nuk pret të bëjë karierë, të martohet, të ketë fëmijë dhe një jetë normale).

28 Simptoma të qëndrueshme, nxitshmëri në rritje (jo e pranishme para traumës) e manifestuar në të paktën dy ose më shumë nga aspektet e mëposhtme:

1. Vështirësi në rënien në gjumë
2. Irritueshmëri ose shpërthime nervozizmi
3. Vështirësi në përqëndrim
4. Hipervigjilencë
5. Reagim i alarmuar i ekzagjeruar.

Çrregullimi shkakton distres të dukshëm ose dëmtim në fushën sociale ose të punës ose në fusha të tjera të rëndësishme të funksionimit.

Duhet specifikuar nëse stresi është:

Akut: Zgjatja e simptomave është më pak se tre muaj

Kronik: Zgjatja e simptomave është tre muaj ose më shumë.

Duhet specifikuar nëse stresi është:

Me fillim të vonuar: simptomat shfaqen të paktën 6 muaj pas veprimit të stresorëve.

Çrregullimet Shoqëruese

Çrregullimet shoqëruese të çrregullimin e stresit pas traumës janë:

Çrregullimi i depresionit madhor;

Çrregullimet e lidhura me përdorimin e substancës (alkool, drogë, barna);

Çrregullimi i panikut;

Agorafobia;

Çrregullimi obsesiv-kompulsiv;

Çrregullimi i ankthit të përgjithësuar;

Fobia sociale;

Fobia specifike;

Çrregullimi bipolar.

9.3.3 Disocimi

Në dekadën e fundit lidhjet mes disosacionit dhe traumës së rëndë janë bërë gjithmonë e më shumë të vlerësuara. Disocimi është përkufizuar si një "*proçes në vazhdim në të cilin një informacion i caktuar (si ndjenja, kujtime, dhe ndjesi fizike) mbahet veç nga tjetri me të cilin do të ishte lidhur normalisht*". Funksionalisht, disocimi mund të shihet si mbrojtës ashtu edhe përshtatës, duke qënë se, në disa rrethana ai lejonin personin të shmangi procesimin apo pranimin e informacionit që është i patolerueshëm dhe i papranueshëm.

VeT ka një tendencë për të "*humbur kujtesën*" e momenteve më të dhimbshme të përvojës së trafikimit dhe gjithashtu të kenë një sens të ngatërruar apo të ndërruar të kohës kur ngjarjet ndodhën. Çdo ripërmbledhje e këtyre kujtimeve të dhimbshme zakonisht ndiqet nga një emocion intensive distresi.

Megjithëse disosacioni është një përgjigje instiktive për të shpëtuar veten nga nga kujtimet e padëshiruara, kjo përgjigje vjen me një cmim më të lartë, duke përcaktuar me Crregullimin e Personalitetit të Shumfishtë, tani i referuar si Çrregullimi i Identitetit Disociativ.

9.3.4 Disocimi dhe Veprimet e Dëmtimit të Vetes

Disocimi shfaqet në shumë raste ekstreme dhe të vështira të sjelljeve impulsive, si vetë-dëmtimi, abuzim me substancat dhe bulimia.

Sapo janë dominuar nga menidime\kujtimet intruzive të traumës, individët fillojnë të organizojnë jetën e tyre përreth shmangies së patjes së imazheve të tilla mendore. Shmangia mund të marri forma të ndryshme: të qëndruarit larg cdo gjëje që mund t'iu kujojë traumën, marrja e alkoolit apo substancave qe mpijnë vetëdijshmërinë e gjëndjes vuajtëse emocionale, ose bërja e veprimeve të vetë-dëmtimit për të mbajtur përvoja të pakënaqshme nga vetëdija e ndërgjegjshme.

Sipas kësaj, kur VeT janë të ngarkuara me ndjenja zemërimi, trishtimi dhe mërzitjeje, dhe ato ndjehen të braktisura dhe pa shpresë për të luftuar situatën e tmerrshme në të cilën kanë ngecur, ato kalojnë në veprime vetë-dëmtimi - në shumicën e rasteve djegie me cigare dhe prerje me brisk - në mënyrë që të ndalojnë emocionet e papërballueshme. Ndonjëherë ato do t'i përdorin këto veprime gjithashtu si një provë apo kujtim i asaj që i'u është bërë atyre.

Kur pyeten për abuzimin e alkoolit apo drogërave, shumë VeT e kanë të vështirë të ndajnë përdorimin e detyruar nga dëshira e tyre për të konsumuar. Nëse në fillim ato janë detyruar nga pronari për të pirë sa më shumë alkool që të jetë e mundur, me kalimin e kohës dhe me një gjëndje në rritje dëshpërimi, ata hyjnë në një cikël vicioz në të cilin alkooli përdoret si një mënyrë për të çliruar distresin e tyre emocional.

Disa prej tyre fillojnë të pijnë sasi të mëdha alkooli kur e dinë që do të rrihen apo do të detyrohen të jenë dëshmitare ndëshkimesh nga pronari. Duke qënë se ky keqtrajtim vazhdon çdo ditë, ato janë të ekspozuara ndaj një cikli që mund të çojë në varësi ndaj alkoolit.

9.3.5 Kuptimi Mbi Çrregullimet E Humorit

Çrregullimet e humorit janë një nga çrregullimet më të përhapura për gratë dhe vajzat viktima të trafikimit. Simptomat e këtyre çrregullimeve mund të evidentohen edhe në popullatën normale: shumë prej nesh pohojnë se ndryshimet e humorit janë shqetësuese. Tiparet klinike të çrregullimeve të humorit variojnë nga depresisoni i thellë në mani. Çrregullimet e humorit shfaqen në format e mëposhtme:

<u>Çrregullimet unipolare</u>

1 çrregullimi depresiv madhor
2 çrregullimi distimik
3 çrregullimi depresiv i paklasifikuar gjetiu

<u>Çrregullimet bipolare</u>

1 çrregullimi bipolar I
2 çrregullimi bipolar II
3 çrregullimi ciklotimik
4 çrregullimi bipolar i paklasifikuar gjetiu

<u>Çrregullime të tjera humori</u>

1 çrregullimi humorit i shkaktuar nga gjendja e përgjithshme shëndetësore
2 çrregullimi humorit i shkaktuar nga përdorimi i subsancës (drogë, alkool)
3 çrregullimi humorit i paklasifikuar gjetiu.

Tiparet kyçe të këtyre çrregullimeve janë simptomat depresive të cilat prekin sferën afektive (të ndjenjave), sferën e të menduarit, sferën e sjelljes dhe atë fizike:

Ndryshimet më të dukshme në sferën afektive i referohen:

Humorit: Individët e përshkruajnë veten si depresivë, të trishtuar dhe të pashpresë. Humori i tyre vazhdon të jetë i ulur edhe në situata të këndshme në të cilat persona jo të prekur nga simptomat depresive do të ndiheshin mirë. Shpesh herë ata mund të justifikojnë humorin jo të mirë me dyshimet ose ankesat për sëmundje fizike.

Mungesës së interesit dhe gëzimit: Klientët humbasin interesin dhe entuziazmin për aktivitete të cilat i kanë pëlqyer në të kaluarën ose që i japin kënaqësi një numri të madh njerëzish. Klientët ankohen se nuk kanë motive për të jetuar, se gjithçka është pavlerë.

Ankthit: Klientët manifestojnë simptoma të pastra të ankthit. Ata ndihen ankthioz për gjërat më të vogla. Ankthin e tyre e shpjegojnë me parashikimin e ngjarjeve negative. Për shembull një nënë bëhet ankthioze nëse fëmijët kthehen më vonë se zakonisht nga shkolla duke e lidhur shkakun e kësaj vonese me një aksident që mund t'i ketë ndodhur fëmijëve të saj.
Vetvlerësimit të ulur dhe fajit: Klientët priren t'i shohin rezultatet personale me sy kritik dhe të ekzagjerojnë dështimet. Dështimin në një punë ata e shohin si dështim personal. Interpretimet që ata u bëjnë ngjarjeve të tanishme ose ngjarjeve të së shkuarës rrisin ndjenjën e fajit. Vetfajësimi mund të marrë përmasa delirante: për shembull një individ mund të mendojë se ai është përgjegjës për varfërinë në botë.

Ndryshimet më të dukshme në sferën e të menduarit i referohen:
Mendimeve negative: mendimet negative klasifikohen në tri kategori: a. në grupin e parë bëjnë pjesë mendimet negative që i referohen të tashmes. Çdo gjë ata priren ta shohin gri.b. në grupin e dytë përfshihen mendimet që i referohen të ardhmes. Klientët kanë pritshmëri negative për të ardhmen. Hidhërimi i tyre për shkak të këtyre parashikimeve është aq i madh saqë ata e shohin vdekjen si të vetmin shpëtim. Në këto kushte ata mund të bëjnë edhe plane për vetvrasje. c. në grupin e tretë bëjnë pjesë mendimet që i referohen së shkuarës. Ata priren të fokusohen më shumë në aspektet negative të së kaluarës pa qenë të aftë të kujtojnë ngjarje pozitive.
Mendimeve për vetvrasje: Këto mendime burojnë nga bindja se pengesa është e pakapërcyeshme, se të tjerët do të ishin më mirë nëse ata do të vrisnin veten. Klientët me risk të vogël për vetvrasje mund ta kenë këtë mendim për 2-3 minuta, me frekuencë 2 ose 3 herë në javë. Ndërsa ata me risk të lartë mund të kenë siguruar edhe mjetet me të cilat do të kryhet vetvrasja për shembull litar ose pistoletë.

Ndryshimet më të dukshme në sferën e sjelljes i referohen:
Tërheqjes nga jeta sociale: klientët reduktojnë ndjeshëm sasinë e kontakteve sociale.
Paksimit të dukshëm të dëshirës për t'u marrë me punë i cili shoqërohet me neglizhim të detyrave dhe rezultate të ulta.
Tentativave për vetvrasje.

Ndryshimet më të dukshme në sferën somatike i referohen:
a**. Axhitimit (shqetësimi) psikomotor** i cili manifestohet në paaftësi për të qëndruar ulur, fërkim të shpeshtë të duarve, fërkim të veshjeve ose objekteve të tjera.
b. **Prapambetjes psikomotore** e cila manifestohet në ngadalësim në të folur dhe në lëvizje. Klientët kërkojnë shumë kohë që t'i përgjegjen një pyetjeje. Volumi i zërit është i ulur dhe fjalori i varfër.
c. **Rënies së dëshirës** për të kryer marrëdhënie seksuale.
d. **Prishjes së gjumit:** Klientët i zë gjumi me vështirësi, gjumi mund të prishet herët në mëngjes ose gjatë natës. Ka raste kur nevojat e klientëve për gjumë shtohen. Problemet e pagjumësisë mund të jenë shkaqet kryesore të fillimit të trajtimit.
e. **Rënies ose shtimit në peshë për shkak të ndryshimit të oreksit:** Disa klientë refuzojnë të ngrënit ndërsa disa të tjerë e shohin mbingrënien si një lehtësim të përkohshëm nga ndjesitë negative.
f. **Ankesës së vazhdueshme për shqetësime somatike:** kapsllëk (vështirësi në defekim), ankesa për dhimbje në pjesë të ndryshme të trupit.

9.3.6 Çrregullimi i Personalitetit Kufitar

Individët me **Çrregullim Personaliteti Kufitar** (**ÇPK**) karakterizohen nga një lloj paqëndrueshmerie në fushën emocionale, sjellore, mendore dhe ndërpersonale.

Si të varur që janë nga të tjerët, këta persona kanë ndjesinë se do të jenë viktimë e të tjerëve dhe se do të braktisen. Perceptimi i një ndarje të mundëshme, ose humbja e strukturës së jashtme mund të çojë në ndryshime të thella të vetimazhit, ndjenjave, proceseve mendore dhe sjelljes. Këta individë janë tepër të ndjeshëm ndaj rrethanave mjedisore. Ata përjetojnë frikëra intensive braktisje dhe inat të papërshtatshëm edhe kur përballen me ndarje që zgjasin pak në kohë apo kur ka ndryshime në plane p.sh (dëshpërim i papritur kur terapisti përcakton mbylljen e seancës, panik apo inat kur dikush është me vonesë në takim). Ata besojnë se kjo "*braktisje*" vjen si pasojë e faktit se ata janë "*të këqinj*". Kjo frikë braktisje është e lidhur me paaftësinë për të qënë vetëm dhe nevojën për të patur njerëz të tjerë pranë. Përpjekjet e tyre për të shmangur braktisjen mund të përfshijnë veprime vetdëmtuese dhe vetvrasëse.

Përfundimet e historive afektive për ata janë me pasoja katastrofike. Ata idealizojnë të dashurit e tyre që në takimin e parë, dhe kërkojnë që të kalojnë orë të tëra me ta. Ata menjëherë mund të kalojnë nga njëri ekstrem në tjetrin duke u zhvendosur nga idealizmi në një nënvlerësim total për tjetrin, sepse mendojnë se personi tjetër nuk kujdeset mjaftueshëm për ta. Kjo zhvendosje shpesh reflekton zhgënjimin që ata kanë pësuar nga personi të cilin ata e kanë idealizuar, ose reflekton frikën nga një braktisje e mundshme që ata vetë e presin.

Individët me ÇPK, paraqesin zhvendosje dramatike në vetimazhin e tyre, që karakterizohet nga një zhvendosje e qëllimeve, vlerave, aspiratave. Tek ata vërehen ndryshime të papritura në planet për karierën, identitetin seksual, tipin e shokëve. Megjithëse ata zakonisht kanë një vetimazh që bazohet në të qënurit "i keq", individët me këtë çrregullim mund të kenë në një moment të caktuar ndjenja të "mosegzistences". Këto përjetime ndodhin kur individët ndjejnë mungesën e një marrëdhënie domethënëse.

Ata gjithashtu harxhojnë shumë, abuzojnë me substancat, përfshihen në marrëdhënie seksuale të shfrenuara, në lojra fati deri në ekstrem, vjedhje etj. Janë impulsivë dhe të pa parashikueshëm për veprimet që ndërmarrin.

Tentativat për vetvrasje janë ndoshta ndër shkaqet që këta individë paraqiten për ndihmë. Këto veprime vetshkatërruese zakonisht rrjedhin si pasojë e kërcënimeve për ndarje, refuzimeve etj. Vetdëmtimi mund të ndodhë gjatë eksperiencave disociative (të shkëputjes nga realiteti) dhe shpesh sjell çlirim duke riafirmuar aftësinë për tu ndjerë "i keq".

Individët kufitar karakterizohen nga episode intensive euforie, irritimi apo ankthi që zakonisht zgjasin pak orë, por ndodh që të zgjasin dhe me ditë.Ata shfaqin zemërim konstant dhe luftë fizike me veten. Individë të tillë kanë ndjenjën e mërzisë së vazhdueshme, por mund të shpërthejnë dhe të përjetojnë kriza emocionale të fuqishme si irritueshmëri të cilat shkaktohen si rrjedhim i anormalitetit në sistemin limbik (pjesë e trurit përgjegjëse për kontrollin e emocioneve).

Individët kufitarë kanë episode të përkohshme psikotike dhe disociative të cilat zakonisht zgjasin 1-2 ditë. Disa syresh mund të zhvillojnë simptoma psikotike (halucinacione, shtrembërime të imazhit të

trupit, ide të referencës etj) gjatë kohës së stresit.

9.4 TEKNIKAT E KËSHILLIMIT

Teknikat e shërbimeve të këshillimit konsistojnë në sesione terapie individuale ose grupi. Sesionet janë të skicuara për të ndihmuar viktimat që të komunikojnë dhe ndajnë përvojat e tyre, si një element thelbësor i shërimit psikologjik. Sesionet individuale janë përfituese për viktimat sespse ato vendosin një mekanizëm për njohjen dhe ndarjen e traumës, në një atmosferë private dhe "të sigurt". Empatia dhe përkujdesja I inkurajojnë viktimat që të bëhen më të hapura dhe të mësojnë se si të përballojnë përvojat e tmerrshme që sapo kanë kaluar. Sesionet në grup janë skicuar për të përmirësuar aftësitë e viktimave për të komunikuar dhe për t'iu ofruar atyre një forum për të parë ngjashmëritë në problemet e njëri-tjetrit, në mënyrat e të menduarit, etj.

9.4.1 Çfarë është këshillimi?

Është një qëndrim me anë të të cilit profesionistët ndihmojnë të tjerët të përmirësojnë mirëqënien e tyre, të lehtësojnë dhimbjen e tyre, të qetësojnë krizat dhe të rrisin aftësinë për të zgjidhur probleme dhe marrë vendime.

Këshillimi bën të mundur dhe lehtëson zhvillimin psikologjik duke ndihmuar të tjerët të zbulojnë dhe përdorin më mirë burimet dhe aftësitë e tyre ekzistuese për gjetjen e rrugëve të reja për të ndihmuar vetveten.

9.4.2 Rolet dhe Funksionet e Këshilluesit

Empatik me klientët

Të konfrontojë klientët me sjelljet e tyre mbrojtëse

Të ndihmojë klientët të shprehin ndjenjat dhe idetë e tyre

T'u mësojë klientëve parimet kryesore të vetë ndihmës

T'u mësojë klientëve aftësi dhe sjellje të reja

9.4.3 Faza fillestare / faza parapërgatitore e shërbimeve të këshillimit

Shumica e viktimave të këshilluara nuk janë të mësuara me marrjen e mbështetjeve apo asistimit të pakushtëzuar. Në shumë caste, vikimat shfaqin sjellje irrituese dhe refuzuese gjatë fazave të fillimit të asistimit. Ato nuk mund të besojnë që kjo asistencë jepet "pa një cmim", pra, pa ndonjë gjë të kërkuar në kthim. VeT janë mësuar me të qënit të paafta për të luftuar apo protestuar ndaj mënyrës se si ato janë të trajtuara dhe nga të qënit të ndëshkuara për mos respektimin e rregullave të trafikantit.

Zemërimi është një përgjigje normale kur një person është i keqtrajtuar, i abuzuar dhe tradhëtuaar, dhe ka humbur, si rezultat, një sens themelor të besimit tek të tjerët. Si pasojë, ndonjëherë VeT shfaqin një armiqësi të pakuptueshme ndaj njërëzve që duan t'i ndihmojnë, po ashtu ndaj rregullave dhe procedurave, si ato me të cilat përballen, për shembull, në strehëz. Pak kohë pasi VeT arrijnë në ambientin mikpritës (si strehëza), ku ato trajtohen me **respekt** dhe ju ofrohen shërbime të ndryshme ndihme, dëshira e tyre

për të marrë informacion dhe për të marrë pjesë në aktivitetet riintegruese rritet dukshëm. Duke qënë se pak nga to kanë patur ndonjëherë akses në mbështetje sociale apo psikologjike, është kritike të zbatohet një model gradual dhe i kujdesshëm kur fillohen sesionet e këshillimit.

Në këtë mënyrë, një skemë këshillimi efikase dhe e drejtuar sic duhet, gjatë fazave të hershme të programit të ndihmës, është kritike për hapjen e viktimës dhe pranimin e planeve afatmesme dhe afatgjata të trajtimit.

9.5 PUNA ME INDIVIDIN

Puna me individin përbën një nga fazat më të rëndësishme të proçesit të këshillimit.

Objektivat parësore të punës me individin, të cilat priten të kenë efekte pozitive në gjëndjen e klientit, janë:

1. Ndërhyrja në krizat e papritura,
2. Adresimi i simptomave të veçanta, dhe
3. Identifikimi i zgjidhjeve për një spektrum të limituar problemesh.

9.5.1 Ndërhyrja në Kriza

Ndërhyrja në Kriza nënkupton dhënien në mënyrë të menjëhershme, të përkohshme e ndihmës së parë emocionale për viktimat që kanë kaluar trauma psikologjike apo fizike.

Përkufizimi i krizave

Krizat janë rezultat i pengesave që hasin njerëzit gjatë realizimit të qëllimeve në jetën e tyre dhe që ata besojnë se nuk mund t'i kapërcejnë ato me anë të zgjidhjeve apo mënyrave tradicionale.

Krizat i referohen ndjenjave personale si frika, gjendja e shok-ut, dhimbja të cilat lindin kur individët nuk janë në gjëndje t'ju përgjigjen pengesave që hasin gjatë realizimit të qëllimeve të rëndësishme jetësore

Krizat janë një perceptim për një situatë apo ngjarje e cila konsiderohet si një vështirësi e patolerueshme dhe që i tejkalon burimet apo mekanizmat kooperues të personit.

Qëllimet e Këshillimit në Raste Krizash

1. Të ndihmojë personin të bashkëpunojë efektivisht me një situatë krize dhe t'i rikthehet nivelit të tij të mëparshëm të funksionimit
2. Të ulë ndjenjat negative
3. Të mësojë teknikat e manaxhimit të krizave
4. Funksionimi i Klientëve në Krizë

Afeksioni: Klienti dominohet nga emocione negative, ankth, depresion, zemërim.

Njohja: Klienti shfaq paaftësi për të menduar në mënyrë të njëtrajtshme dhe logjike, ide irracionale rreth vetes së tij/saj, rreth botës, rreth të tjerëve.

Sjellja: klienti është pasiv, vepron në mënyrë jo efektive, apo i largohet problemit.

Modeli Gjashtë Hapësh i Ndërhyrjes në Kriza

Përkufizmi i problemit: eksplorimi dhe përkufizimi i problemit nga këndvështrimi i klientit.

Sigurimi i sigurisë së klientit: vlerëso rrezikshmërinë, seriozitetin, qëndrueshmërinë e rrezikut ndaj sigurisë fizike dhe psikologjike të klientit.

Dhënia e ndihmës: shprehet (nëpërmjet fjalëve, zërit, gjuhës së trupit) një pranim i kujdesshëm, pozitiv dhe jo gjykues.

Ekzaminimi i alternativave: Të ndihmojë klientin të eksplorojë mundësitë për lehtësimin e rrezikut të menjëhershëm.

Hartimi i planit: Të ndihmojë klientin të zhvillojë një plan realist afat-shkurtër duke përdorur aftësitë bashkëpunuese të klientit si dhe burimet shoqërore, përcaktimi i hapave të veprimit të cilat klienti mund t'i kuptojë.

Mbajtja e një qëndrimi: Të ndihmojë klientin të marrë përsipër disa veprime pozitive, hapa të cilat klienti mund t'i realizojë me lehtësi.

9.5.2 Modelet e këshillimit individual

Modeli me person të qëndërzuar

Në përgjithësi, viktimat fillimisht shfaqin një ngurrim ndaj pranimit dhe diskutimit të problemeve të tyre të shkuara. Ato gjithashtu e kanë të vështirë ta ndajnë historinë e tyre me viktimat e tjera në strehëz.

Marrja e një përgjigjeje empatike dhe të pakushtëzuar nga këshilluesit, kur viktimat e trafikimit, ndajnë përvojat e dhimbshme të tyre, ndihmon në pakësimin e diskomfortit të tyre të brendshëm dhe perceptimeve të tyre negative për veten, që reflektohet më tej në mënyrën se si viktimat shfaqin situatën e tyre të tashme dhe pritshmëritë për të ardhmen.

Brenda këtij mjedisi terapeutik, viktimat e trafikimit, fillojnë të ndjehen më të lira (me dëshirë dhe të afta) për të hapur veten e tyre dhe të eksplorojnë besimet dhe ndjenjat e tyre, dhe njëherësh, të pranojnë problemet e dhe frustracionet e tyre dhe të fillojnë të shikojnë për mënyra për t'i adresuar (apo të paktën t'i përballojnë) ato.

Fokusimi në zgjidhje në terapinë e shkurtër

Kur pyeten për se çfarë "*duan apo presin*" gratë automatikisht thonë se "*ato nuk duan*"; vlerat e tyre janë të shtrembëruara në një mënyrë që ato nuk mund as të imagjinojnë zhvillime pozitive në jetën e tyre. Ato janë të prirura për të patur plane afat shkurtra ku është e qartë vetëm ajo "*çfarë duhet shmangur*".

Ndërkohë që në këshillim, viktimat ndihmohen që të ndërtojnë një sistem koherent dhe praktik për të arritur objektvat e tyre, pra, së pari për të identifikuar një qëllim, pastaj organizimi i një plani veprimi të bazuar, dhe përfundimisht për të njohur përfitimet e kësaj mënyre të menduari dhe të vepruari. Në këtë mënyrë, viktimat e trafikimit, fitojnë konfirmim\afirmim pozitiv për "*sjelljen me synim*" të saj dhe fiton një sens të ri të aftësive të saj. Terapia e shkurtër është një nga metodat e këshillimit që ka provuar të

qënit një mënyrë efektive në lehtësimin e këtij ndryshimi në mendim.
Parimet e terapisë së shkurtër, si fokusimi në zgjidhjet pozitive dhe përpunimi i qëllimeve, lehtëson aftësinë e viktimave, për të ndryshuar orientimin e tyre nga të qënit të fiksuara në problemet e tyre në të qënurit të hapura për zhvillime pozitive. Kjo i aftëson ato të riformulojnë gradualisht zgjedhjet dhe dëshirat e tyre. Njëherësh, ato zhvillojnë një perceptim të ndryshëm për problemet e tyre dhe fillojnë të gjejnë zgjidhje më realiste për to.

Megjithëse ky proçes nuk mund të ristrukturojë gjithë personalitetin e viktimës, ai mund t'a ndihmojë atë t'i shikojë problemet dhe vështirësitë e saj nga një perspektivë tjetër, të fitojë një ndjenjë përgjegjësie, dhe të aktivizojë modele të reja sjelljeje.

Histori terapeutike
Metafora dhe histori terapeutike janë gjithashtu teknika të përdorura për t'iu dhënë viktimave tw trafikimit,nxitje që të gjejnë perspektiva të reja dhe të fillojnë proçesin e tyre për zgjidhjen e problemeve. Disa nga viktimat janë ngurruese për të pranuar një ndryshim në jetën e tyre. Duke qënë se kjo teknikë nuk është e drejtuar për të influencuar në mënyrë direkte proçesin vendim-marrës të viktimës, ajo ndihmon për të pakësuar rezistencën e mekanizmave të tyre mbrojtës të brendshëm. Historitë ofrojnë një model me të cilat viktimat e trafikimit mund të identifikohen. Duke dëgjuar këto histori, viktimat mund të gjejnë një lidhje me problemet e tyre personale pa ndjerë asnjë kërcënim ndaj sistemit të tyre ekzistues të vlerave dhe besimeve.

Për shembull, nëse një vajzë dyshon në shanset për sukses në ndonjë përpjekje për të ndryshuar pozitivisht jetën e saj, kjo teknikë siguron një shembull, një histori "*Për Guximin për të Rrezikuar*", dhe një model për të ndryshuar pozitivisht perspektivën e saj për problemet. Historitë janë universale dhe të njohura që kanë efektin e shpejtimit të mekanizmave shërues të të pandërgjegjshmes.

Teknikat e relaksimit
Shumica e VeT ankohen nga simptoma si probleme me gjumin, gjëndje lodhjeje, dhimbje koke apo zemre. Teknikat e relaksimit janë të dobishme në terapinë për crregullimet e ankthit sepse u japin subjekteve një sens kontrolli mbi simptomat e tyre. Ato mund të mësojnë teknika relaksimi për të adresuar ankthin e tyre dhe që u lejon atyre të angazhohen në komponentët e tjerë të terapisë.

Duke përdorur teknikat e relaksimit, klientet mësojnë të clirojnë progresivisht muskulaturën e tyre duke u përqëndruar në procesin e frymëmarrjes. Ndërkohë që klientja qetësohet gradualisht, ajo bëhet e aftë për pakësimin e ankthit të saj dhe zëvëndësimin e tij me një gjëndje paqeje dhe qetësie.

Peveler dhe Johnston (1986) treguan se relaksimi rrit aftësinë e kujtesës së klientit për të pranuar informacion pozitiv dhe lehtëson zbulimin e përgjigjeve të ndryshme, alterantive ndaj ankthit të tij\saj.

Reflektimi i kuptimit dhe logoterapia
Logoterapistët kërkojnë për kuptimin që thekson sjelljet dhe veprimet. Dereflektimi dhe modifikimi i sjelljeve të theksuara janë teknika specifike që logoterapia përdor për të zbuluar kuptimin. Shumë

klientë "hipereflektojnë " (mendojnë shumë për diçka) për kuptimin negativ të ngjarjeve në jetën e tyre dhe mund të hanë shumë, të pijnë tej mase, ose të bien në depresion.

Në mënyrë konstante ato i atribuojnë një kuptim negativ jetës së tyre. Reflektimi direkt i kuptimit mund të shtyjë këta klientë të vazhdojnë këto mënyra negative të mendimeve dhe sjelljes. Në të kundërt, dereflektimi kërkon të ndihmojë klientin të zbulojnë "multitudën e vlerave që shtrihet përtej dobësive të tyre." Qëllimi është të ndihmojmë klientët të mendojnë gjëra të tjera përveç çështjeve negative dhe të gjejnë alternativa pozitive të kuptimit në të njëjtën ngjarje.

Reflektimi i kuptimit dhe proçesi i njohjes dhe sjelljes

Terapia konjitive-bihejvioriste (Beck, 1976,1991; Meichenbaum, 1977, 1991) është bërë një zonë e rëndësishme për praktikën e këshillimit. Teoricienët konjitivë-bihejvioristë flasin në thellësi për strukturat njohëse dhe dialogun e brendshëm. Ata janë të interesuar në sjellje të dukshme por gjithashtu duan të eksplorojnë proçesin e nënkuptuara (ose fjalimet e brendshme), që monitorojnë dhe udhëheqin sjellje akoma më të dukshme. Sjellja njohëse tipike drejton klientin në aktivitete specifike për të ndryshuar sekuencat e mendimeve dhe kuptimeve. Për më tej terapistët konjitivë-bihejvioristë, i shtojnë shprehi influencuese dhe strategji punës se tyre. Ata kërkojnë që klientët të lëvizin me shpejtësi në mënyra të reja të njohjes dhe kuptimit.

Terapia e njohjes dhe e sjelljes kalon në dy faza:
Faza e parë e trajtimit për reduktimin e simptomave fokusohet në identifikimin e problemeve, përcaktimin e prioriteteve, familjarizimin e klientit me terapinë e njohjes, stabilizimin e marrëdhënies bashkëpunuese, ilustrimin e lidhjes midis mendimit dhe emocionit, në etiketimin e gabimeve në të menduar dhe në progresimin sa më të shpejtë për zgjidhjen e problemit ku janë fokusuar. Terapia fillimisht përqëndrohet në simptomat e klientit duke i kushtuar vëmendje vështirësive në sjellje dhe problemeve në motivim. Kur klienti shfaq disa ndryshime të dukshme në këto fusha, theksi vihet në përmbajtjen dhe mënyrën e të menduarit të klientit.

Ndryshe nga faza e parë, **faza e dytë**, apo faza skemë-fokusuese thekson parandalimin e relapsit. Kur klienti ndihet më pak i depresuar, terapisti dhe klienti vazhdojnë me skemat thelbësore mbi veten dhe jetën, sepse ato shpesh nënvizojnë shumë nga problemet e klientit. Kur identifikohen skemat, ato nxjerrin në pah rregulla dhe formula me anë të të cilave zhvillohet të mësuarit individual për t'i "dhënë kuptim" botës. Më tej skemat vazhdojnë të përcaktojnë mënyrën se si ato i organizojnë perceptimet në mendime, vendosin synimet, vlerësojnë dhe modifikojnë sjelljen dhe mënyrën se si individët kuptojnë ngjarjet në jetën e tyre.

9.6 PUNA NË GRUP

Shpesh, klintët nuk janë mësuar të flasin për veten e tyre apo të përshkruajnë se si ato e perceptojnë veten e tyre, cfarë pëlqejnë tek vetja e tyre dhe tek bota që i rrethon. Edhe kur vendosin të hapen, klientët VT nuk janë të afta të artikulojnë përvojat e tyre jetësore në terma pozitivë. Konjicioni i tyre tenton të modifikohet dhe vetëvlerësimi dhe vetë-respektimi i tyre tentojnë të ulen.

Nëpërmjet sesioneve në grup, klientët kanë mundësinë të ndajnë përvojat e tyre personale me gratë e tjera; ato mund të flasin lirshëm për veten e tyre me njëréz që nuk do t'i gjykojnë dhe mund t'iu rrëfehen atyre në mënyrë të drejtpërdrejtë.

Shfaqja e përvojave të tyre personale në një mjedis të sigurt pakëson tensionin e tyre të brendshëm, frikën, dhe trishtimin. Shumë gra fillimisht ndjehen "*të papërshtatshme*"; ato fajësojnë veten për vuajtjen e tyre, dhe dyshojnë nëse jetët e tyre do të jenë ndonjëherë të suksesshme.

Gjatë sesioneve në grup, çdo klient merr mbështetje dhe afeksion nga pjesëmarrësit e tjerë. Kjo situatë në grup i aftëson ato të kontrollojnë më mirë ndjenjat e armiqësisë dhe ankthin. VeT gradualisht nuk ushtrojnë shumë presion mbi njëra-tjetrën dhe mbi veten e tyre dhe ato mund të fokusohen në objektivat dhe shpresat e tyre.

Në sesionet në grup, pjesëmarrësit propozojne tema diskutimi; temat më të shpeshta janë ato mbi shqetësimet e klienteve për të ardhmen e tyre, mbajtjen ekonomike dhe problemet familjare. Nëpërmjet diskutimeve në grup, klienttët marrin sugjerime nga pjesëmarrësit e tjerë, duke stimuluar kështu një model interaktiv dhe vetëstimulues.

Një teknikë tjetër e punës në grup është sigurimi i përfitimeve me informacion dhe shembuj të komunikimit dhe aftësitë për zgjidhjen e problemeve. Në këtë mënyrë, anëtarëve të grupit ju jepen disa "*mjete*" për të komunikuar dhe shprehur shqetësimet e tyre si psh: si të perifrazosh një fjali në mënyrë që të kuptohet më mirë apo si të ndryshosh një fjali në mënyrë që të theksojë mesazhet pozitive dhe jo ato negative, etj.

9.6.1 Përpilimi dhe mjedisi terapeutik

Grupet e përcaktohen për 12 sesione javore, 2-2 ½ orë. Kur përcaktohet orari, këshilluesit duhet të kenë parasysh pushimet dhe ndërprerje të tjera të mundshme që mund të prishin rregullsinë e takimeve.

Sesionet relativisht të gjata kërkojnë një mjedis të rehatshëm. Mobilimi sipas një stili të ngjashëm me dhomën e ndenjes është ideal për aq kohë sa anëtarët e grupit nuk duhet të ulen shumë pranë në divan. Një pjesë e mobiljeve duhet të jenë të levizshme sepse shpesh, luajtja e rolit kërkon modifikime në mobilim.

Dhoma e grupit duhet të pajiset me një *videoregjistrues dhe një tabelë të zezë*. Sesionet me regjistrim i lejojnë terapistët të rishikojnë aktivitetet e grupit me njëri-tjetrin, apo me një supervizor midis sesioneve. Kjo lejon vlerësimin e vazhdueshëm të trajtimit të tyre dhe i çliron ata nga marrja e shënimeve gjatë sesioneve. *Një tabelë e zezë me shkumës* është tepër e rëndësishme për regjistrimin e mendimeve dhe përgjigjeve racionale që dalin në pah *gjatë rikonstruktimit njohës.* Ato sigurojnë një pamje vizuale të nevojshme për anëtarët e grupit, vëmendja e të cilëve mund të kufizohet nga ankthi i lartë. *Këmbaleci dhe fshirësja* janë më të preferueshme se tabela e zezë, sepse e lejojnë grupin t'i referohet përsëri materialit të mëparshëm. Në çdo rast, ato duhet të jenë të lëvizshme në mënyrë që të vendosen kudo ku një klient i caktuar mund t'i referohet më lehtë gjatë ekspozimeve të simuluara.

9.6.2 Puna në Grup si Art, Besim dhe Shkencë

Udhëzime të Shkurtra

1 Bëni kohën të reflektojë mbi identitetin tuaj personal, qëndrimet dhe vlerat tuaja.
2 Kini një ide të qartë se kush janë rolet dhe funksionet e tuaja në grup, dhe komunikojuani ato anëtarëve të grupit.
3 Kini një ide të qartë se çfarë lloj grupi po ngrini.
4 Shmangni ndërmarrjen e projekteve që tejkalojnë objektivin e trajnimit dhe përvojës tuaj.
5 Jini të aftë t'u shprehni klientëve propozimet e grupit
6 Tregojuni anëtarëve të grupit se çfarë pritet nga ata.
7 Jepuni atyre rregullat bazë, që do të drejtojnë punën e grupit
8 Mbro të drejtën e anëtarëve për të vendosur se çfarë duan të ndajnë me grupin dhe në ç'lloj aktivitetesh do të marrin pjesë.
9 Tregojuni anëtarëve rreziqet psikologjike që vijnë nga pjesmarrja në grup.
10 Theksojuni anëtarëve rëndësinë që ka ruajtja e konfidencialitetit
11 Zhvilloni një rregull bazë për përdorimin e ushtrimeve të grupit, dhe jini në gjëndje ta transmetoni në mënyrë verbale atë.
12 Kur është e nevojshme jini të hapur me grupin për vlerat tuaja, mos ua impononi ato klientëve
13 Respektoni kapacitetin që kanë klientët të mendojnë për veten e tyre, sigurohuni që anëtarët t'i japin njëri-tjetrit të njëjtin respekt.
14 Inkurajoni pjesmarrësit të diskutojnë rreth eksperiencës së tyre në grup
15 Ndihmo anëtarët të zbatojnë në jetën e tyre të përditëshme atë çka ata po mësojnë në këtë process të grupit.
16 Paraprijuni frustrimeve dhe zhgënjimeve
17 Eksploroni konceptimet e gabuara rreth grupit
18 Jini të ndërgjegjshëm për rrezikun ekzistues të plotësimit të nevojave tuaja në kurriz të nevojave të anëtarëve
19 Lidhni praktikën me teorinë, dhe jini të hapur ndaj integrimit të qëndrimeve të shumëfishta në praktikat tuaja.
20 Instaloni besimin në këshillimin në grup
21 Mbani veten tuaj të informuar rreth kerkimeve të fundit shkencore në proçesin e grupit dhe përdoreni këtë informacion për të rritur efektivitetin e praktikës tuaj
22 Jini të vëmendshëm ndaj simptomave të dobësisë psikologjike që mund të shfaqen tek anëtarët e grupit.
23 Zhvilloni metoda të vlerësimit në mënyrë që të përcakoni efektivitetin e proçedurave që ju përdorni
24 Planifikoni sesione për ndjekje të mëtejshme (folloë-up) kështu anëtarët do të jenë në gjëndje të dallojnë se çfarë kanë bërë të tjerët në grupin e tyre.
25 Mësoni si nga eksperienca juaj vetjake ashtu edhe nga eksperiencat e të tjerëve.

10 KRIJIMI I NJË TË ARDHMEJE TË RE

■ *Shumë gra/vajza dhe fëmijë të trafikuar nëse do të kishin mundësi do të të ktheheshin në shtëpinë e tyre; në keto raste në themi se kemi të bëjmë me një* ***kthim vullnetar të asistuar.*** *Shumë të tjerë janë kthyer kunder dëshirës së tyre kjo në rastet kur janë arrestuar si emigrantë të palighshëm; në këto raste në flasim për një* ***kthim jovullnetar*** *apo* ***riatdhesim*** *nga policia e emigracionit.*

10.1 VËSHTIRËSITË

Sido që të jetë kthimi, vullnetar apo jo, gratë e trafikuara dhe fëmijët shpesh kanë nevojë për përkrahje kur ata rikthehen në familjet, komunitetin apo vendin e tyre. Rikthimi dhe riintegrimi përbëjnë një proçes kompleks, në të cilin të rikthyerit mund të ndeshen me probleme psikologjike, familjare, shëndësore, probleme ligjore dhe financiare. Shpesh për ta është e vështirë të kenë një kthim të lehtë brenda jetës familjare dhe komuniteteve të tyre, kjo ndodh për disa arsye:

1 Gratë/vajzat dhe fëmijët e trafikuar nuk kanë dokumente personale identifikimi të cilat u nevojiten për të udhëtuar në mënyrë të sigurt, të tilla si; pasaporta apo karta identiteti.

2 Pamundësi për të ndihmuar familjet e tyre apo për të paguar borxhet.

3 Mundësi të limituara për punë dhe pagat e ulta në vendin e tyre të origjinës.

4 Përshtatja me një stil tjetër jetese, duke jetuar në jashtë vendit, kanë tashmë një stil tjetër veshjeje dhe zotërojnë një liri më të madhe se ajo që kanë patur në shtepi.

5 Disa prej tyre mund të vuajnë nga ndonjë sëmundje e cila mund të jetë shkaktuar nga kushtet në të cilat ato punonin më parë (si rezultat i përdorimit të drogës/alkoolit) apo nga abuzimet fizike dhe seksuale. Sëmundja mund të komplikohet për shkak të pamundësisë për trajtim mjekësor në vendin e origjinës.

6 Të kthyerit mund të kenë frikë nga policia dhe zyrtarë të tjerë, veçanërisht nëse ata kanë eksperienca korruptimi dhe abuzimi gjatë periudhës së tyre të trafikimit.

7 Frikë nga disa lloj marrdhëniesh apo persekutimesh nga trafikantët, gjë që haset shpesh, veçanërisht nëse ato janë trafikuar nga njerëz të përfshirë në aktivitete të tjera kriminale (tregti të drogës dhe të armëve) apo kanë qenë vetë të pranishme në to.

Në këtë mënyrë personat e trafikuar që rikthehen mund të kenë probleme të ndryshme të që pengojnë proçesin e tyre të riintegrimit. Nëse këto probleme nuk gjejnë zgjidhje, dhe të kthyerit nuk janë ndihmuar, ka të ngjarë që ata të abuzohen dhe shfrytëzohen përsëri.

Çdo person i trafikuar karakterizohet nga një situatë e ndryshme dhe specifike, organizmat ndërkombëtare dhe kombëtare sigurojnë mbështetje dhe asistencë për të rikthyerit me qëllim rintegrimin e tyre në vend.

Punonjësit social mund të përfitojnë informacionin e nevojshëm përmes një planifikimi të kujdesshëm, duke marrë informacionin e duhur. Në vendin e destinacionit/ tranzitit nga vetë personi i cili dëshëron të kthehet, si dhe nga çdo institucion apo organizatë që ndihmon në përkujdesin ndaj tij/saj. Në vendin e tij të origjinës nga familja apo të afërmit e personit.

10.2 INTEGRIMI NË VENDIN E DESTINACIONIT

Integrimi në vendin e destinacionit mund të realizohet nëpërmjet disa mënyrave:

1 Dhënia e të drejtës së qëndrimit

2 Organizimi i klasave për të mësuar shkrim dhe këndim

3 Vlerësimi i aftësive dhe shkathtësive

4 Zhvillimi i një projekti profesional realist (duhen marrë parasysh se dëshirat e viktimës jo gjithmonë korespondojnë me aftësitë që ajo ka)

5 Programe trainimi

6 Integrimi në tregun e punës

10.3 RIKTHIMI VULLNETAR I ASISTUAR DHE RIINTEGRIMI NË VENDIN E ORIGJINËS

Organizatat Ndërkombëtare, OJF-të dhe Institucionet Qeveritare mund të bashkëpunojnë në një sërë programesh të cilat synojnë ndihmën ndaj viktimave të trafikimit, veçanërisht grave dhe fëmijëve, për rikthimin vullnetar dhe riintegrimin e tyre në vendin e origjinës, dhe realizimin e integrimit të tyre në bazë të nevojave individuale.

Viktimave në vendet e destinacionit dhe ato tranzite mund t'u ofrohet një asistencë përsa i përket shërbimeve të para-nisjes, transportit, dhe kthimimit, ndërkohë që në vendin e origjinës/kthimit viktimës vëmendja mund të përqëndrohet në aktivitetet për riintegrimin, përshtatjen në përputhje me realitetin lokal dhe nevojat individuale të viktimës.

Rikthimi vullnetar i asistuar përfshin shërbimet dhe aktivitetet e mëposhtëme:

1 Shërbimet e para-nisjes

2 Asistenca dhe shërbimet e transportit

3 Shërbimet pas mbërritjes dhe të riintegrimit

10.3.1 Shërbimet e para-nisjes:

Të rikthyerit kanë nevojë për asistencë për të marrë dokumentat e nevojshme për të udhëtuar dhe letra të tjera që kanë lidhje me të sa mire si dhe organizimi i transportit ajror,rrugor apo detar. Është e rëndësishme që klienti të shoqërohet nga përfaqësues të organizatës në të dyja anët e kufirit. Organizatat që asistojnë klientin si në vendin e origjinës dhe në vendin e destinacionit duhet të kordinojnë kthimin e klientit në vendin e tij, kjo është një domosdoshmëri për të siguruar një mbështetje të vazhdueshme dhe garantimin e sigurisë të klientit/es.

Është e rëndësishme që proçedurat e rikthimit të diskutohen dhe të qartësohen edhe me klientin/en, atij/asaj i duhet shpjeguar se kush do ta shoqërojë deri në kufi, kush do të jetë atje për ta asistuar dhe çfarë do të ndodh më tej. Gjithashtu atij/asaj i duhet dhënë një informacion i shkruar me të gjitha emrat dhe adresat e kontaktit, numrat e telefonit etj. Gjithashtu është i domosdoshëm informimi rreth situatës ligjore dhe ofrimi i asistencës ligjore falas.

Shërbime të tjera që parashikohen për viktimat në këtë fazë janë;

1 Pritja, shqyrtimi dhe pranimi i rasteve të referuara nga institucione partnere si OJF-të, organet e policisë, agjensitë partnere nga vendet e tjera, Organizatat Ndërkombëtare, etj.
2 Koordinimi me organet lokale të policisë për marrjen e masave mbrojtëse për viktimat e trafikimit.
3 Sigurimi i një strehëze të sigurt, qoftë kjo nëpërmjet bashkëpunimit me OJF-të apo atij me pushtetin lokal.
4 Sigurimi i ndihmës mjekësore, përfshirë shërbimin e përgjithshëm mjeksor, shërbimin psikiatrik, ekzaminimin gjinekologjik; plotësimi i nevojave të tjera mjekësore të rekomanduara, si dhe sigurimi i mbështetjes psiko-sociale për viktimat.
5 Sigurimi i këshillimit ligjor për viktimat si dhe shërbimeve të tjera të mbrojtjes shoqërore.
6 Intervistimi i viktimave me qëllim identifikimin e nevojave të tyre individuale dhe hartimi i paketave individuale të asistencës në bashkëpunim me organizatat e tjera partnere.
7 Dhënia e informacionit si dhe këshillim për viktimat në fazën e para-nisjes.
8 Organizimi i proçedurave të udhëtimit, përcaktimi i itinerarit, rezervimi dhe sigurimi i biletave.

10.3.2 Asistenca dhe Shërbimet e Transportit:

Verifikimi dhe/ose mbështetja për sigurimin e dokumenteve të domosdoshme për udhëtim në bashkëpunim me vendet e tranzitit apo të origjinës, për migrantët të cilët dëshërojnë të kthehen, duke përfshirë edhe asistencën për marrjen e vizave tranzite në rastet kur është e nevojshme.

1 Rezervimi dhe sigurimi i biletave.
2 Sigurimi i asistencës së nisjes në aeroport.
3 Pritja në aeroport dhe shoqërimi për akomodim.
4 Sigurimi i ndihmës mjekësore gjatë transportit për personat me nevoja të veçanta
5 Pritja në aeroport e viktimave të rikthyera të trafikimit
6 Asistenca për udhëtimin në destinacionin përfundimtar.

10.3.3 Shërbimet pas-mbërritjes dhe të riintegrimit

1 Referimi tek OJF ose agjensitë shtetërore që sigurojnë strehim, në rastet kur është e domosdoshme.
2 Sigurimi i ndihmës mjekësore dhe mbështetjes psiko-sociale.
3 Trajnim profesional dhe referimi tek shërbimet e punësimit
4 Sigurimi i mundësive për vet-punësim dhe mikrokredi për viktimat e rikthyera të trafikimit.
5 Dhënia e subvencioneve për punëdhënësit lokalë (rrogat shtesë dhe/ose blerja e pajisjeve profesionale)
6 Asistimi i proçesit të riintegrimit rast pas rasti nëpërmjet pushtetit lokal dhe OJF-ve partnere.
7 Monitorimi i proçesit të riintegrimit duke respektuar në të njëjtën kohë edhe dëshirën e klientit për privatësi.

8 Realizimi i vëzhgimeve ndërmjet punëdhënësve/ OJF-ve/ organizatave/ familjeve për të vlerësuar nivelin dhe cilësinë e riintegrimit të viktimës në një mjedis të ri pune/shoqëror.

10.4 STREHIMI

Sigurimi i strehimit ka për qëllim t'u ofrojë një hapësirë të mbrojtur viktimave të cilat janë marrë në mbrojtje. Ato monitorohen në një klimë besueshmërie dhe në të njëjtën kohë shoqërohen derisa të bëhën totalisht të pavarura.

Strehimi është gjithashtu edhe në varësi të situatës personale të viktimave (personi mund të ketë jetuar në rrugë; apo mund të ketë një vend qëndrimi; apo mund të ketë probleme që lidhen me sigurinë e jetës së tij.) Në rastet e trafikimit, zgjidhja ideale është ***monitorimi në një strehëzë të specializuar dhe të mbrojtur.***

10.4.1 Strehëzat

Një Strehëzë është një vend i sigurt pritjeje dhe që plotëson standartet dhe cilësitë e mëposhtëme:
Shërbim 24 orë në ditë

1 Ka personel aktiv gjatë gjithë kohës (të punësuar, vullnetarë)
2 Mundësi për të përballuar rastet emergjente
3 Gjeneron ndjenjën e sigurisë
4 Ofron mundësinë për të folur me dikë gjatë gjithë kohës
5 Ofron stabilitet për klienteët që ka nën kujdesje.

Adresë sekrete

Siguria e banorëve nuk është kurrë absolute. Në disa raste mund të jetë e domosdoshme për të zhvendosur strehëzën me qëllim ruajtjen e anonimitetit.

Rregulla shtëpie

Banorët duhet të respektojnë disa rregulla dhe masa sigurie:

Masat e sigurisë:

1 Jo të ftuar
2 Nuk lejohen telefonatat jashtë strehëzës
3 Banorët duhet të shoqërohen kur dalin jashtë gjatë ditëve të para të qëndrimit në strehëzë.

Rregullat e bashkëjetesës:

1 Ndjekja e mbledhjeve javore
2 Aktivitete në grupe
3 Ndarja e punëve të shtëpisë
4 Rëndësia e dhomave individuale (mundësitë për të strehuar gratë me fëmijët e tyre)

Strehëza është hapi i parë drejt autonomisë: Banorët e strehëzave janë të inkurajuar të marrin pjesë në aktivitete që organizohen jashtë qëndrave (kurse shkrimi dhe këndimi, aktivitete praktike, programe

trajnimi për punësimin, etj.) Shoqërimi i viktimave drejt strukturave ndërmjetëse duhet organizuar në të njëjtën kohë me promovimin e gjysmë-autonominë së tyre.

10.4.2 Familjet pritëse

Viktimat gjithashtu mund të qëndrojnë në familje pritëse. Kjo mund të jetë si gjatë fazës së parë të largimit apo edhe si një zgjidhje afat-gjatë.

Familjet pritëse zgjidhen mbi baza vullnetare. Ato angazhohen të strehojnë viktimën gjatë një periudhe kohore të përcaktuar në kontratë dhe konsultuar me organizatën. Në një periudhë kohore provë si viktima ashtu dhe familja pritëse mund të vendosin nëse do e vazhdojnë më tej apo do e përfundojnë marrveshjen e bërë.

Një OJF e specializuar mund të ofrojë mbështetje si për familjen ashtu edhe për viktimën gjatë qëndrimit të viktimës atje.

Aspektet pozitive

1 Mbështetje morale për viktimën, e cila ka nevojë për të vendosur marrëdhënie të reja të bazuara në besim dhe të përjetojë një shkallë të caktuar stabiliteti.

2 Ekperiencë pozitive e jetës në familje

3 Viktimat kanë një shans për të marrë përsëri përgjegjësitë e tyre

4 Një integrim më i shpejtë në shoqëri

5 Vendosja e qëllimeve të reja për jetën.

Aspektet negative

1 Në rastet kur viktima ka perjetuar dhunë në familje, duhet bërë kujdes që vendosja në familje të mos përjetohet si një nundësi shfrytëzimi.

2 Qëndrimet e gjata në familje rrezikojnë krijimin e lidhjeve të forta që më pas është e vështirë të thyhen.

3 Jeta private e viktimës kushtëzohet nga rregulla të caktuara të familjes.

10.4.3 Strehimet afatshkurtra dhe strukturat *"gjysmë–të pavarura"*

Strehimet afatshkurtra mund të përdoren si një zgjidhje e shpejtë në rastet kur personi marrë nën kujdesje ka arritur të ketë një nivel të caktuar pavarsie.

Strehime të tilla mund të përdoren gjithashtu si një zgjidhje e ndërmjetme, midis qëndrimit në një familje pritëse dhe pavarsisë totale.

Në këtë fazë, personi i marrë nën përkujdesje vazhdon të jetë i shoqëruar kur përmbush detyrat administrative rutinë të jetës së përditëshme (p.sh. të formulojë një kërkesë për asistencë financiare, apo vënia në dijeni e autoriteteve të pushtetit lokal për ndryshimin e adresës, etj.)

10.5 NDIHMA MJEKËSORE DHE MBËSHTETJA PSIKOLOGJIKE

10.5.1 Ndihma mjekësore

Është e rëndësishme që të kryhet një vizitë kontrolli për të parë gjëndjen e përgjithshme shëndetësore të viktimës, dhe nqs do të jetë e nevojshme të shënohen të gjitha të dhënat mbi dhunën që mund të jetë ushtruar mbi të. Bashkëpunimi ndërmjet organizatës, mjekut dhe viktimës është domosdoshmëri.

10.5.2 Mbështetja psikologjike

Është shumë e rëndeësishme që personi i rikthyer të mbështetet psikologjikisht dhe emocionalisht gjatë proçesit të rikthimit dhe ribashkimit me familjen e tyre. Me të mund të diskutohet sesi e imagjinon ai/ajo kthimin në shtëpi, cilat janë reagimet që pret nga komuniteti? Duke shprehur shpresat e tij/saj dhe lidhjet që do ti ndihmojnë atë të ndihet me i/e fortë për të perballuar të ardhmen. Ndihma dhe mbështetja nga të afërmit dhe familjaret do të jetë thelbësore. Punonjësi social duhet të bëjë një vlerësim me shkrim përpara se sa klienti/ja të kthehet në shtëpi.

Mbështetja psikologjike duhet të ofrohet vetëm me kërkesën e viktimës. Me qëllim që kjo mbështetje të bëhet efektive, është shumë e rëndësishme që të respektohen zgjedhjet e viktimës. Një mbështetje e tillë do të krijojë lehtësira për:

-Formulimin e diagnozës

-Viktima të pranojë të kaluarën e tij.

-Të aftësojë viktimën të imagjinojë një të ardhme për veten.

10.6 KËRKIMI I FAMILJEVE

Në vendin e origjinës disa organizata sigurojnë mbështetje për kërkimin e familjeve në vendin e origjinës të grave/vajzave dhe fëmijëve të trafikuar. Qëllimi i kërkimit të familjeve është për të:

1 Verifikuar faktin nëse familja ekziston dhe është vërtet e lidhur me klientin;

2 Për të konfirmuar që ata nuk u janë drejtuar personave të gabuar për ndihmë.

3 Marrë adresën e saktë të vendodhjes së familjes së viktimës.

10.6.1 Vlerësimi i familjes

Ribashkimi nuk nënkupton kthim në të njëjtën situatë si më parë. Viktima e trafikuar është në shumë mënyra jo e njëjta siç ka qenë më parë.Vlerëimi i familjes bëhet në mënyrë që të vlerësohet dhe të merret vendimi nëse familja dëshëron kryejë ribashkimin me viktimën si dhe për të vlerësuar nëse ajo përbën një strehë të sigurt për të. Vlerësimin i familjes kryhet gjithashtu në mënyrë që të përcaktohen nevojat e familjes si dhe shërbimet dhe ndërhyrjet e domosdoshme në të.

Informacioni i marrë nga familjet duhet të të lidhet me:

1. Vlerësimin e kujdesshem të arsyeve dhe motiveve që kanë shtyrë personin e trafikuar për të lënë familjen.

2 .Vlerësimin e situaës sociale dhe ekonomike e familjes; gadishmërinë e saj për të pranuar, strehuar, ushqyer dhe për t'u kujdesur për viktimën.

3. *Qëndrimin e prindërve dhe të afërmëve dhe përballja e tyre me një rikthhim të mundshëm. Sa janë ata të gatshëm ta pranojnë kthimin e viktimës, pavarsisht eksperiecave të saj*

Është e nevojshme gjithashtu që ky informacion që të ndahet edhe me vetë personat që duan të rikthehen. Në këtë mënyrë organizata duhet të jetë në gjëndje përcaktojë dhe verifikojë nëse ai/ajo do të rikthehet në familje dhe në të njëjtën kohë të sigurojë një këshillim dhe trajtim të përshtatshëm për të brenda standarteve të kërkuara.

FORMULAR PËR VLERËSIMIN E FAMILJEVE

Emri i klientit _____

Emri i intervistuesit _____

Data e intervistës _____

I.UDHËZIME

1. Shpjegojini familjes emrin e organizatës për të cilën punoni dhe punën që ju bëni.
2. Pyet familjen nëse ka ndonjë anëtar që nuk jeton aktualisht me ta.
3. N.q.s PO pyet për emrin, mbiemrin, moshën, datën e lindjes, dhe nivelin arsimor të tij/të saj

Emri	
Mbiemri	
Mosha	
Data e lindjes	
Niveli arsimor	

4. Ku beson familja se mund të jetë ai/ajo?
5. Ju mund t'i shpjegoni familjes që fëmija/anëtari e tyre ndodhet një një strehëzë për gratë/vajzat e trafikuara ku po merr të tërë kujdesin e nevojshëm për të.
6. Ju mund të shpjegoni gjithashtu se klienti juaj ka shprehur dëshirën që të kthehet në shtëpi.
7. Ju mund të shpjegoni që ju dëshironi të kontaktoni më shpesh me ta dhe t'i sillni lajme për klientin/en tuaj përpara se ai/ajo të kthehet në shtëpi.
8. Çfarë reagimesh pati dhënia e këtij informacioni tek anëtarët e familjes (vëzhgoni me kujdes dhe mbani më pas shënime për këto reagime)?

_____

_____

_____

_____

II. Rrjeta familjare

Emri	Mosha	Seksi	Lidhjet e klientit	Adresa e fundit	Vendi i punës	Komente

III. **JETA E FAMILJES GJATË KOHËS SË LARGIMIT TË KLIENTIT/ES.**

1. C'farë bënte klienti/tja përpara se të largohej nga shtëpia?

_____

_____

2. A ka patur klienti/ja rol të veçantë në familje?

_____

_____

3. A kishte dalë ndonjëherë më parë klienti/ja juaj jashtë shtetit?

PO

JO

4.Cilat janë arsyet që kanë shtyrë klientin/en tuaj jashtë shtetit?

_____

_____

5. A ka patur familja ndonjë anëtar tjetër të saj në vendin ku ndodhej klienti/ja juaj?

_____

_____

6. Nëse Po, çfarë pune bënte ai atje?

_____

_____

7.A kanë patur anëtarët e tjerë të familjes ndonjë problem me klientin/en tuaj?

PO

JO

8.Nëse Po, çfarë lloj problemi ka qenë ai?

_____

_____

9. Çfarë kanë bërë anëtarët e tjerë/prindërit për të zgjidhur këtë problem?

_____

_____

IV.NDARJET

10. Nëse klienti/ja juaj është trafikuar, ç'lidhje mund të ekzistojnë ndërmjet trafikuesit dhe familjes së tij/saj?

_____

_____

11. A ka patur familja ndonjë anëtar tjetër të saj trafkuar më parë? Nëse Po ku?

_____

_____

12. A ka ndonjë anëtar tjetër të familjes që ka emigruar vetëm?

_____

_____

V.SITUATA AKTUALE

13.Ka familja burime ushqimore të mjaftueshme ?

PO

JO

14.Cilat janë kushtet në të cilat jeton familja

Të mira
Jo të mira

Sepse
_____
_____

15. Cilat janë të ardhurat aktuale dhe burimet e familjes?
_____
_____

16.A janë këto aktivitete të mjaftueshme për një jetesë normale?
PO
JO

Sepse
_____
_____

17.A ka familja borxhe?
PO
Nëse Po, në emrin e kujt?
_____
_____
JO

18.A mund të krahasohet situata ekonomike e familjes me gjendjen e familjeve të tjera që jetojnë në të njëjtën zonë me të?
PO, kjo familje është më e varfër se të tjerat
JO, familja nuk është më e varfëe se të tjerat në atë zonë.

19.A është familja e kënaqur me kushtet e saj të jetesës?
PO
JO

Sepse
_____
_____

20. A ka shërbim të kujdesit shëndetësor pranë zonës së banimit?
PO
JO

21. A ka insitituciones arsimore pranë zonës së banimit?
PO
JO

22. A ka ndonjë projekt që zbatohet në këtë zonë?
PO
JO

Emri i organizatës _____
Adresa e organizatës _____
Aktivitetet e organizatës _____

23.A dëshiron familja që klienti/ja juaj të kthehet dhe të jetojë pranë saj?
PO
JO

Sepse
_____
_____

24.A është familja e kënaqur me atë çka i ofrohet klientit/es nga organizata juaj?
PO
JO

Sepse
_____
_____

25. A pret familja që klienti/juaj të kthehet me më shumë aftësi për të punuar, apo që ai/ajo të zërë vendin ku ka qenë më parë?
PO
JO

26. Çfarë pret familja nga klienti/ja juaj kur ai/ajo të kthehet pranë saj?

_____

_____

27. Vështirësi të tjera (shënoni më poshtë çdo lloj informacioni tjetër që keni mundur të zbuloni nga intervista juaj me familjen)

_____

_____

28.Përshkruani komunitetin ku jeton familja e klientit/es tuaj.

Informacion gjeografik mbi vendodhjen e tij

_____

29. Numri i popullsisë

_____

30. Struktura e lidershipit

_____

31. Burimet e domosdoshme (shkolla, qëndra shëndetësore, banka, organizata, etj.)

_____

32. Problemet me të cilat përballen njerëzit që jetojnë në atë zonë.

_____

33. Të tjera informacione që merrni nga komuniteti.

_____

10.6.2 Përgatitjet për ribashkimin me familjen

Në rastet kur është e domosdoshme, familja duhet të mbështetet dhe të përgatitet psikologjikisht dhe emocionalisht për proçesin e ribashkimit, për të realizuar këtë organizatat mbështetëse duhet të vlerësojnë veprimet e tyre si dhe të hartojnë një plan të detajuar ditor.

Nëse të dyja palët bien dakort, punonjësit socialë mund të drejtojnë dhe të organizojnë proçesin e ribashkimit duke patur të pranishëm edhe dëshmimtar të tjerë nga komuniteti, në këtë mënyrë familja është parë edhe nga anëtarët e tjerë të komunitetit që ka pranuar personin e kthyer.

Kjo fazë në proçesin e ribashkimit mund të jetë paksa e ndjeshme. Disa nga klientët dhe familjet e tyre nuk duan që kjo ngjarje të bëhet publike. Organizata që asiston në ribashkimin duhet të përpiqet të balancojë dhe inkurajojë të rikthyerit të qëndrojnë në shtëpi dhe të respektojnë dëshirat e tyre nëse ata nuk duan që ta bëjnë publike ribashkimin me familjen.

Vlerësimi i lidhjeve familjare disa kohë pas ribashkimit.

Familja mund të mos jete e ndërgjegjësuar për natyrën e punës që ka bërë më parë gruaja/vajza e rikthyer si dhe për problemet që ajo mund të shfaqë. Për këtë familja ka nevojë të qartësohet rreth disa çështjeve, të tilla si;

1. Dhënia e mundësisë që viktima të flasë rreth eksperiencës së saj vetëm në momentin kur ajo dëshiron, ata nuk duhet ta shtyjnë atë të flasë për gjera që ajo dëshiron t'i mbajë për vete, shpeshherë klienti e ka të vështirë të rrëfejë eksperiencat e dhimbshme të së kaluarës.
2. Inkurajimin e klientit që të marrë vetë vendimet për probleme të ndryshme që e shqetësojnë, dhe jo që të jetë gjithë kohës i mbrojtur nga të tjerët.
3. Anëtarët e familjes duhet të tregohen të duruar, besnik dhe mbështetës.
4. Inkurajimin e klientit për të përdorur shërbimet që mund t'i ofrohen, të tilla si; shërbimet e këshillimit, asistencën ligjore dhe ndihmën mjekësore, etj.

10.6.3 Hapat e propozuara për vazhdueshmerinë

Takimet me familjen dhe zhvillimi i një planit veprimi

Punonjësi social duhet të ndjekë ecurinë gjatë periudhës së qëndimit të viktimës në shtëpi, për këtë qëllim ai duhet të:

1 Ftojë të vajzën/gruan e rikthyer që të flasë rreth situatës së saj pas kthimit në vendlindje.
2 Të krahasojë rrethanat e shkuara të gjëndjes së viktimës me rrethanat aktuale.
3 Të vlersësojë problemet e hasura pas kthimit të viktimës në familje. (Vlerësimi i problemeve të tilla si; problemet me anëtarët e familjes; problemet me anëtarërët e komunitetit; problemet e shëndetit dhe problemet emocionale; problemet ekonomike; problemet e shtëpisë; problemet e shkollimit, etj.)
4 Mbikqyrë çdo vështirësi apo çështje tjetër ku është e nevojshme të ndërhyet.
5 Identifikojë së bashku me të rikthyerën planet për të ardhmen.
6 Diskutojë me të rikthyerën (ose me familjen e saj) për zgjidhjen e çdo problemi.

Zhvillimi i çdo plani veprimi duhet të përfshijë si dhënien e informacioni ashtu edhe veprimet konkrete që do të ndërrmerren. Është e rëndësishme që të vlerësohen nevojat prioritare të të rikthyerve. Është e nevojshme që viktima të marrë pjesë në gjetjen e zgjidhjeve të problemeve dhe në zbatimin e strategjive të identifikuara për zgjidhjen e tyre.

Punonjësi social:

1 Mund të sigurojë informacion në mënyrë të tillë që të ndihmojë viktimën në marrjen e vendimeve dhe veprimeve. Të informojë viktimën për mënyrën se si organizata mund ta ndihmojë atë. **(Duhen shmangur premtimet false)**
2 Mund të ndihmojë në krijimin e lidhjeve të të rikthyerve me burimet dhe projektet e realizueshme (psh. trajnimi i aftësive profesionale, realizimi i aktiviteteve të përgjithshme, etj). Punonjësi Social mund të diskutojë mundësitë që kanë rastet e referuara dhe familjet e tyre për të patur akses në këto shërbime.
3 Mund të organizojë takimet pasuese mes partnerëve të interesuar.
4 Mund të mbajë shënimet përkatëse.
5 Në fund të cdo muaji punonjësi social duhet të paraqesë një raport ecurie për çdo rast pranë organizatës.

REFERENCA

[1]Protokolli mbi parandalimin, pengimin dhe ndëshkimin e trafikut të personave, veçanërisht të grave dhe fëmijëve plotëson Konventën e Kombeve të Bashkuara Kunder Krimit Ndërkombëtar të Organizuar, (2000) fq 4-5,
Ky protokoll njihet ndryshe edhe me emrin Protokolli i Palermos tek http://*www.uncjin.org/Documents/Conventions/dcatoc/final_documents_2/convention_%20traff_eng.pdf*

[2] Protokolli mbi parandalimin, pengimin dhe ndëshkimin e trafikut të personave, veçanërisht të grave dhe fëmijëve plotëson Konventën e Kombeve të Bashkuara Kunder Krimit Ndërkombëtar të Organizuar, fq 4-5, tek *http://www.uncjin.org/Documents/Conventions/dcatoc/final_documents_2/convention_%20traff_eng.pdf*

[3] Konventën e Kombeve të Bashkuara Kunder Krimit Ndërkombëtar të Organizuar, Kombet e Bashkuara 2000.

[4] Ekberg,G, (2002) "Protokolli i Palermos", NIKK, Volumi.1, fq 40-41.

[5] Protocolli "Për parandalimin, pengimin dhe ndëshkimin e trafikut të personave, veçanërisht të grave e fëmijëve", nenshkruar në Palermo, Dhjetor 2001

[6] Ky përkufizim i marrë nga Aleanca Globale Kundër Trafikimit të Grave .GAATW si dhe nga dokumenti "Standartet e të Drejtave të Njeriut për Trajtimin e Personale të Trafikuar, Januar 1999"
Shih ; IOM, (2000) "Trafikimi i qënieve njerëzore dhe Roli i Shkollës në Parandalimin e tij- Manual për Nxënësit e Shkollave të Mesme"- Organizata Ndërkombëtare për Migracionin, IOM, Tiranë

[7] Ibidem

[8] Përkufizimi është marrë nga Konventa e Këshillit të Europës, "Për Veprimin Kundër Trafikut të Qënieve Njerëzore", miratuar në 3 Maj 2005, nga Komiteti i Ministrave i Këshillit të Europës.

[9] Ibid.

[10] Fakleabast, (2002) "Hartimi i Planit Kombëtar për të Gjitha Vendet Skandinave-një Fushatë Ndërgjegjësimi" Nëntor 2002.

[11]Deklarata e bërë në Konferencën Botërore të Vienës për të Drejtat e Njeriut, në vitin 1993.

[12]Kartuch, A.Knaus, K.Reiter (2000) "Lufta kundër trafikimit të grave për qëllime të prostitucionit të forcuar- Standartet Ndërkombëtare" Instituti për të Drejtat e Njeriut "Ludvig Boltzmann", Vienë, 2000, fq 10-11.

[13]Raymond, A., (2001) "*Udhëzuesi Protokollit të Kombeve të Bashkuara për Trafikimin, 2001"* Ky udhëzues është mbështetur nga Koalicioni i Organizatave

të Grave dhe Article Premier, CATW, Eurpean Women's Lobby, MAPP, AFEM.

[14]Protokolli"Për parandalimin, pengimin dhe ndëshkimin e trafikimit të personave, veçanërisht të grave e fëmijëve", nenshkruar në Palermo, Dhjetor 2001

[15]UNICEF, UNOHCR dhe OSBE/ODHIR, March 2005, "*Trafikimi i Qënieve Njerëzore në Europën Juglindore",* Barbara Limanowska

[16]Ibidem
[17]Shih : Mamonova.T (1994) "Women glostmost versus noglost–Stopping Russian Backlash," Begin dhe Garvey, Westport dhe Londër,

[18]UNICEF, UNOHCR dhe OSBE/ODHIR, March 2005, "*Trafikimi i Qënieve Njerëzore në Europën Juglindore",* Barbara Limanowska

[19]Në Deklaratën për Eliminimin e Dhunës ndaj Grave të OKB jepet përkufizimi i parë zyrtar për dhunën ndaj grave. Sipas këtij përkufizimi dhuna ndaj grave përfshin:
„...çdo akt dhune me bazë gjininë, që sjell si pasojë ose që mund të sjellë si pasojë dëmtimin fizik, seksual dhe psikologjik, ose që shkakton vuajtje tek gratë, duke përfshirë edhe kërcënimin për akte të tilla, detyrimin apo privimin arbitrar të lirisë, pavarsisht nëse këto ndodhin në publik apo në jetën private

[20]Adriana Baban, (2003) *"Dhuna ndaj Grave në Familje në Shqipëri*", UNICEF dhe ISOP, Tiranë 2003.

[21] Konventa Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Fëmijës (1989), Rezolutë nr.44/25 e Asamblesë së Përgjithsme të K.B, 20 Nëntor 1989, është ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë. Mund të gjendet gjuhën shqipe në www.unicef.org/albania

[22] Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Dhunes ndaj Grave, (CEDAW) Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme të K.B, Nr.34/180, 18 Dhjetor 1979, është ratifikuar nga Kuvendi i Shqiperise me Ligjin Nr.7767, date 09.11.1993

[23] UNICEF, Mars 2003 "Udhëzime Mbi Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve Viktima të Trafikimit në Evropën Juglindore"

[24]Keshilli i Vendimmarrjes së Punës për Luftën Kundër Trafikimit të Qënieve Njerëzore, është formuar në 19 korrik të 2002-shit.

[25] Shqipëria është një nga 46 vendet anëtarë të Këshillit të Europës. Shqipëria aderon në Këshillin e Europës që prej 13 Korrikut 1995.

[26] Konventa nderkombetare për ndalimin e trafikut të grave dhe fëmijëve, përfunduar në Gjenevë, në 1921 dhe Protokolli amendues i saj.
-Konventa për ndalimin e trafikut të grave në moshe madhore,perfunduar në Gjeneve në 1933 dhe protokolli amendues i saj
-Konventa për ndalimin e trafikut të personave dhe shfrytezimit të prostitucionit të të tjereve dhe protokolli final i saj në 1950.
-Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar, 2000.
-Protokoll kundër trafikimit të migranteve me rrugë tokësore, ajrore dhe detare

që plotëson Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar ndërkombetar.
-Protokolli "Mbi parandalimin, pengimin dhe ndeshkimin e trafikut të personave ,veçanërisht të grave dhe fëmijëve", që ploteson Konventen e Kombeve të Bashkuara kunder Krimit të organizuar nderkombetar
-Konventa mbi eleminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave, 1979

[27] Materiali eshte marre nga raporti "*Dhuna shteterore ne Shqiperi*", paraqitur nga Qendra per Nisma Ligjore Qytetare (ish - Qendra Avokatore per Grate) perpara Komitetit Kunder Tortures te OKB/se me 12 maj 2005 ne Gjeneve.

[28]Ligji nr. 8920, dt.11.7.2002

[29] Shih; OSBE (Janar 2005) *"Një vështrim i legjislacionit shiqptar në fushën e trafikimit të qënieve njerëzore*", Prezenca e OSBE-së në Tiranë, Zyra e Këshilltarit Ligjor.

[30] Ligji Nr.9205 "Mbi Drejtësinë e Bashkëpunëtorëve dhe Mbrojtjen e Dëshmimtarit", datë 15 Mars 2004.

[31] Shih; Këshilli i Ministrave, (2004) *"Strategjia KombëtareKundër Trafikimit të Fëmijëve dhe Mbrojtjes së Fëmijëve Viktima të Trafikimit"*, Tiranë. www.këshilliministrave.al

[32] Suela Kusi, (2001). "*Advokacia-Roli i Punonjësit Social"* Fountain House Tirana, Korrik 2001, Tiranë.

[33] Prof.Assoc.Dr. Milika Dhamo, Universiteti i Tiranës (2005). "*Çështjet etike të shërbimeve sociale ndaj të miturve dhe të rinjve*" 2005..

[34] Ibid

[35] Ky përkufizim është marrë nga "Nazionale programmes to Combat Trafficking in Human Beings (National Plan of Action) bacground paper"për vendet e Paktit të Stabilitetit të Europës Jug-Lindore, Vienë 2001, fq 1-2.

[36] Save the Children (2004) "Masat Kundër Trafikimit të Fëmijëve- Manual Njohëa për Ndërhyrje e Bra të Bazuara në të Drejtat e Fëmijëve, nga Përvojat Save The Children në Europën Juglindore"Tiranë 2004, fq 42.

[37] Mbi këto metoda është hartuar dhe po zbatohet një prej programeve më të rëndësishme të parandalimit të punës dhe keqtrajtimit të fëmijëve, Programi "Scream-Stop Punës së Fëmijëve" zbatuar nga ILO-IPEC dhe inicijuar me fonde të Qeverisë Italiane.

[38] Shkurtim i përdorur për të emëruar viktimat e trafikimit

[39] Pango, Ylli (2004) "*Psikoterapi,"* I3SP, Tirane 2004.

[40] A. Ivey, 198

[41] G. Eagen, 1982

BIBLIOGRAFI

Ekberg. G, (2002) "*Protokolli i Palermos*", NIKK, Volumi.1, 2002.

UNHCHR, (1999) *"Standartet e të Drejtave të Njeriut për Trajtimin e Personave të Trafikuar*", UNHCHR, Janar 1999, Gjenevë

IOM, (2000) "*Trafikimi i Qënieve Njerëzore dhe Roli i Shkollës në Parandalimin e tij- Manual për Nxënësit e Shkollave të Mesme"*- Organizata Ndërkombëtare për Migracionin, IOM, Tiranë 2000.

Fakleabast, (2002) *"Hartimi i Planit Kombëtar për të Gjitha Vendet Skandinave-një Fushatë Ndërgjegjësimi*," Nëntor 2002.

Kartuch, A. Knaus, K. Reiter (2000) *"Lufta kundër trafikimit të grave për qëllime të prostitucionit të forcuar- Standartet Ndërkombëtare,"* Instituti për Të Drejtat e Njeriut "Ludvig Boltzmann", Vienë, 2000,

Raymond, A., (2001) "*Udhëzuesi Protokollit të Kombeve të Bashkuara për Trafikimin, 2001"* Gjenevë, 2001

UNICEF, UNOHCR dhe OSBE/ODHIR, (2004), "*Trafikimi i Qënieve Njerëzore në Europën Juglindore",* Barbara Limanowska, 2004

UNICEF, UNOHCR dhe OSBE/ODHIR, (2005), "*Trafikimi i Qënieve Njerëzore në Europën Juglindore",* Barbara Limanowska, Mars 2005.

Mamonova T. (1999) "Women glostmost versus noglost– Stopping Russian Backlash " Begin dhe Garvey, Westport, Londër 1999.

Adriana Baban, (2003) *"Dhuna ndaj Grave në Familje në Shqipëri*", UNICEF dhe ISOP, Tiranë 2003.

UNICEF, (2003) "*Udhëzime Mbi Mbrojtjen E Të Drejtave Të Fëmijëve Viktima Të Trafikimit Në Evropën Juglindore," Mars 2003.*

OSBE (2005) *"Një vështrim i legjislacionit shiqptar në fushën e trafikimit të qënieve njerëzore*", Prezenca e OSBE-së në Tiranë, Zyra e Këshilltarit Ligjor, Janar 2005.

Këshilli i Ministrave, (2004) *"Strategjia Kombëtare Kundër Trafikimit të Fëmijëve dhe Mbrojtjes së Fëmijëve Viktima të Trafikimit"*, Qeveria Shqiptare, Tiranë 2004.

Suela Kusi, (2001). *"Advokacia-Roli i Punonjësve Socialë,"* Fountain House Tirana, Korrik 2001, Tiranë.

Prof. Assoc.Dr. Milika Dhamo, Universiteti i Tiranës (2005) *"Çështjet etike të shërbimeve sociale ndaj të miturve dhe të rinjve"*

Pango, Ylli (2004) "Psikoterapi," I3SP, Tirane 2004.

Save the Children (2004) *"Masat Kundër Trafikimit të Fëmijëve- Manual Njohëa për Ndërhyrje e Bra të Bazuara në të Drejtat e Fëmijëve, nga Përvojat Save The Children në Europën Juglindore"* Tiranë 2004,

Terre des Hommes, (2004) *"Zgjidhjet e gjetura në Shqipëri për shoqërimin e fëmijëve –viktima të trafikut"*, Tiranë, Nëntor 2004.

Terre des Hommes, (2003) *"Trafikimi i fëmijëve shqiptarë në Greqi"*- Fondacioni Terre des Hommes Lausanne, Pierre Philippe, Vincent Tournecuillert, Janar 2004.

UNIFEM, (2002) "*Trafikimi në persona: një prespektivë gjinore dhe e të drejtave të njeriut,"* Zyra Rajonale e UNIFEM në Azinë Lindore dhe Juglindore, 2002.

Konventa Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Fëmijës (1989), Rezolutë nr.44/25 e Asamblesë së Përgjithsme të K.B, 20 Nëntor 1989,

Organizata e Kombeve të Bashkuara *"Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Dhunes ndaj Grave"*, (CEDAW)

Protokolli "*Për parandalimin, pengimin dhe ndëshkimin e trafikut të personave, veçanërisht të grave e fëmijëve",* Palermo, Dhjetor 2001

Departamenti i Punës Sociale, Fakulteti i Shkencave Sociale Tiranë, Qëndra Shqiptare për Zhvillimin e Shëndetit Mendor, (2003), "*Kodi Etik i* Punonjësit

Social", Universiteti i Tiranës, Qershor 2003.

ILO (Zyra Ndërkombëtare e Punës) "*Konventa e ILO-s mbi format më të këqija të punës së fëmijëve, 1999 (Nr.182): Eleminimi i punëve të rrezikshme të fëmijëve hap pas hapi,*" Zyra e ILO-IPEC në Shqipëri.

Instituti i Studimeve Pedagogjike, (2004) "*Puna e fëmijëve- Manual trajnimi për mësuesit," Programi Ndërkombëtar për Eleminimin e Punës së Fëmijëve (ILO-IPEC)*, Tiranë 2004.

Joana Apap and Felicita Medved, (2003), *"Protection Schemes for Victims of Trafficking in Selected EU Member Countries, Candidate and Third Countries*" IOM, Madrid 2002.

OSBE – Zyra e Këshilltarit Ligjior ,(2005), *"Review of Albanian Legislation on Trafficking in Human Beings,"* Tiranë, Janar 2005.

Anelise Araujo-Forlot (2002) "*Prevention, Protection and assistance schemes to victims of trafficking: Policy and examples of IOM prevention and return and reintegration programmes,"* Conference- Deviation, violence and victimisation in CEE, Lubjanë, Shtator 2002.

OSCE-ODHIR, (1999) "*Trafficking in Human Beings: Implications for the OSCE,"* Bacground Paper 1999/3.

IOM (2004) *"Psychosocial Notebook: Psychosocial support tp groups of victims of human trafficking in transit situations," VOL.4, Shkurt 2004.*

IOM Kosovo Counter Trafficking Return and Reintegration Program (2003) *"Traficking in human beings: Unacceptable"* IOM-KOSOVO, Mars 2003.

Save the Children (UK), UN-IAP and IOM (2001) "*Training Manual for Combating Trafficking in Women and Children,"* Maynmar, Mars 2001.

UNICEF, (2005) "*Combating Child Trafficking," UNICEF & Inter-Parlamentary Union, 2005.*